




Plani i Menaxhimit për Liqenin e Ohrit Monument i Natyrës Për Periudhën 2022-2031



Tetor 2021

Projekti: "Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës ", i financuar nga Fondi Global për Mjedisin (GEF), dhe i zbatuar nga Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (UNEP), Zyra Rajonale e Vjenës dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Maqedonisë së Veriut si partneri dhe përfituesi kryesor.

Tabela e Përmbajtjes

| | | |
|----------|---|-----------|
| 1 | PËRMBLEDHJE | 5 |
| 2 | HYRJE | 14 |
| 3 | PËRSHKRIMI I ZONËS | 16 |
| 3.1 | INFORMACION I PËRGJITHSHËM | 16 |
| 3.1.1 | Vendodhja gjeografike dhe Korniza Administrative | 16 |
| 3.1.2 | Korniza Ligjore | 16 |
| 3.1.3 | Të drejtat e pronësisë | 17 |
| 3.2 | INFORMACIONI PËR MJEDISIN | 18 |
| 3.2.1 | Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia | 18 |
| 3.2.2 | Hidrologjia dhe Hidrografia | 18 |
| 3.2.3 | Climate | 19 |
| 3.2.4 | Tiparet Biogjeografike | 19 |
| 3.2.5 | Algat..... | 19 |
| 3.2.6 | Jo vertebrorët e Mëdhenj Bentikë | 20 |
| 3.2.7 | Rotiferet..... | 20 |
| 3.2.8 | Flora | 21 |
| 3.2.9 | Peshqit..... | 22 |
| 3.2.10 | Llojet Kryesore të Faunës dhe Florës..... | 29 |
| 3.2.11 | Brezat e kallamishteve (Habitati Kryesor)..... | 40 |
| 3.2.12 | Zonat e Rëndësishme të Biodiversitetit..... | 42 |
| 3.3 | KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE | 43 |
| 3.3.1 | Komunitetet dhe Popullsia Lokale..... | 43 |
| 3.3.2 | Përdorimi i Tokës..... | 44 |
| 3.3.3 | Infrastruktura dhe Zhvillimi | 47 |
| 3.3.4 | Trashëgimia kulturore | 50 |
| 3.3.5 | Turizmi..... | 51 |
| 3.3.6 | Arsimi | 52 |
| 3.4 | VLERAT E ZONËS | 53 |
| 3.4.1 | Deklaratat e përgjithshme..... | 53 |
| 3.4.2 | Endemizmi | 54 |
| 3.4.3 | Fauna dhe Flora | 54 |
| 3.5 | KËRCËNIMET NDAJ ZONËS | 66 |
| 3.5.1 | Vështrim i përgjithshëm i kërcënimeve në bazë të klasifikimit të Natura 2000..... | 68 |
| 3.5.2 | Vështrim i përgjithshëm: Trysnitë – Tiparet kryesore Natyrore – Masat e Ruajtjes..... | 70 |
| 3.6 | EFEKTSHMËRIA DHE EFIKASITETI I MENAXHIMIT DHE KAPACITETET MENAXHUESE | 75 |
| 4 | STRATEGJIA | 76 |
| 4.1 | VIZIONI PËR ZONËN E MBROJTUR | 76 |
| 4.2 | QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E MENAXHIMIT PËR ZONËN E MBROJTUR..... | 76 |
| 4.3 | KUFIJTË DHE ZONIMI I PROPOZUAR PËR ZONËN E MBROJTUR | 76 |
| 4.3.1 | Kufijtë e Jashtëm të Propozuar për Zonën e Mbrojtur..... | 76 |
| 4.3.2 | Zonimi i Propozuar i Zonës së Mbrojtur | 77 |
| 4.3.3 | Veprimtaritë e Lejuara dhe të Kufizuara..... | 81 |
| 4.3.4 | Kategorizimi i Zonës me Justifikimin | 82 |
| 4.4 | PROGRAMET E MENAXHIMIT | 82 |
| 4.4.1 | Programi 1 – Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore..... | 83 |
| 4.4.2 | Programi 2 – Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore..... | 85 |
| 4.4.3 | Programi 3 – Menaxhimi i trashëgimisë natyrore..... | 85 |
| 4.4.4 | Programi 4 – Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe rekreacionit..... | 87 |
| 4.4.5 | Programi 5 – Zhvillimi lokal | 88 |
| 4.4.6 | Programi 6 - Informimi, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe edukimi..... | 88 |
| 4.4.7 | Programi 7 – Menaxhimi, administrimi dhe financimi | 89 |
| 4.4.8 | Vështrim i Përgjithshëm i Programeve të Menaxhimit dhe Objektivave të Tyre..... | 91 |
| 5 | PLANI OPERATIV | 98 |
| 5.1 | PROGRAMI 1: PROGRAMI PËR RUAJTJEN DHE MONITORIMIN E TRASHËGIMISË NATYRORE | 98 |

| | | |
|----------|--|------------|
| 5.2 | PROGRAMI 2: PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE..... | 118 |
| 5.3 | PROGRAMI 3: MENAXHIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE..... | 122 |
| 5.4 | PROGRAMI 4: PROGRAMI PËR TURIZMIN E QËNDRUESHËM DHE REKREACIONIN..... | 127 |
| 5.5 | PROGRAMI 5: PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN LOKAL..... | 132 |
| 5.6 | PROGRAMI 6: PROGRAMI PËR INFORMIMIN, RITJEN E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK DHE EDUKIMIT..... | 134 |
| 5.7 | PROGRAMI 7: PROGRAMI PËR MENAXHIMIN, ADMINISTRIMIN DHE FINANCIMIN..... | 137 |
| 6 | MENAXHIMI DHE QEVERISJA..... | 141 |
| 6.1 | PLANI PËR MENAXHIMIN DHE QEVERSIJEN..... | 141 |
| 6.1.1 | <i>Struktura e menaxhimit.....</i> | 141 |
| 6.1.2 | <i>Mekanizmat dhe procedurat për konsultimin dhe pjesëmarrjen e palëve të përfshira.....</i> | 143 |
| 6.1.3 | <i>Administrimi i planit të menaxhimit.....</i> | 145 |
| 6.2 | PLANI PËR BURIMET NJERËZORE DHE TË TJERA..... | 146 |
| 6.2.1 | <i>Burimet njerëzore.....</i> | 146 |
| 6.2.2 | <i>Pajisjet dhe infrastruktura.....</i> | 154 |
| 6.2.3 | <i>Vlerësimi i kostove (plani i biznesit).....</i> | 154 |
| 6.2.4 | <i>Fondet dhe financimi.....</i> | 157 |
| 6.3 | PLANI VJETOR I PUNËS..... | 157 |
| 6.4 | PËRGATITJA E PLANIT TË ARDHSHËM TË MENAXHIMIT..... | 157 |
| 7 | SHTOJCAT..... | 158 |
| 7.1 | REFERENCAT..... | 158 |
| 7.2 | HARTAT..... | 161 |

Shkurtesat

| | |
|----------|---|
| KDB | Konventa për Diversitetin Biologjik |
| BE | Bashkimi European |
| GWP | Partneriteti Global për Ujrat |
| IHB Ohër | Instituti Hidrobiologjik i Ohrit |
| DH | Direktiva e BE-së për Habitatet |
| IUCN | Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës |
| METT | Mjeti i Menaxhimit për Gjurmimin e Efektshmërisë |
| MN | Monument i Natyrës |
| MMJPH | Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor |
| PM | plani i menaxhimit |
| MTL | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve |
| PK | park kombëtar |
| ZM | zonë e mbrojtur |
| NP | ndërmarrje publike |
| IP | institucion public |
| PONT | Trusti i Natyrës Prespa Ohër |
| NVM | ndërmarrje e vogël dhe e mesme |
| UNEP | Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin |
| UNESCO | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë |
| TB | Trashëgimia Botërore |

Citimi i sugjeruar:

Bogner, D., Arsov, S., Gjorgievski, G. & Klimoska, F. (2021): Plani i Menaxhimit për Liqenin e e Ohrit, Monument i Natyrës. IUCN ECARO Beograd. Projekti i GEF/UNE: “Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës”.

Falenderime

Falenderimet tona për kontributet konstruktive në lidhje me planin e menaxhimit shkojnë në emër të:

- PONT: Mirjam de Koning dhe Oliver Avramovski
- Shoqatës Turistike Biljana: Nikola Kiselinov
- Shoqërisë Ekologjike Maqedonase: Robertina Brajanoska, Metodija Veleviski, Dragan Arsovski, Bogoljub Sterjovski, Despina Kitanova, Danka Uzunova
- FRONT 21/42: Iskra Stojkovska, Anja Jovanova, Antonio Trajkovski, Tamara N.N.
- MBPEU: Igor Bojadzievski
- Ohrid SOS: Daniel Scarry, Nadezhda Apostolova, Dragana Velkovska, Sonja Dimoska
- Komunës së Ohrit: Konstantin Georgieski, Havza R.Kakel, Jasminka Trajkovska Momirovska, Liljana Jonoska, Tatjana Stojcevska, Suzana K.Mihajloska, Tihomir Durnev, Branko Arnaudovski, Biljana Angjeloska
- Komunës së Strugës: Ramis Merko, Vlatko Zupan, Mitko Korkutoski
- Komunës së Debërcës: Zoran Nogaceski, Daniel Risteski
- Ministrisë së Kulturës: Zoran Pavlov
- Institutit Hidrobiologjik të Ohrit: Zoran Spirkovski, Sasho Trajanovski, Elizabeta Sarafiloska, Orhideja Tasevska, Trajce Talevski
- Parkut Kombëtar të Galicicës: Andon Bojaxhii, Konstantin Zdravevski
- GWP: Dejan Panovski
- MAB (Njeriu dhe Biosfera): Arian Merolli
- MMJPH, Sektori i natyrës
- UNEP: Iskra Stojanova, Fjolla Halili, Evgenija Jordanovska-Neçkovski
- Frosina Klimoska për përkushtimin e temës së saj të Masterit ndaj menaxhimit të Liqenit të Ohrit dhe kontributit në përgatitjen e këtij plani të menaxhimit

Falenderime për punën e pakursyer në bashkërendimin e të gjithë veprimtarive:

- Kliment Nanev

1 Përmbledhje

Liqeni i Ohrit është një liqen ndërkuftar në Ballkanin Perëndimor të pozicionuar në zonën malore ndërmjet pjesës jugperëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë lindore. Në Maqedoninë e Veriut, liqeni ndodhet brenda kufijve administrativë të tre komunave: Ohrit, Strugës dhe Debërcës. Në lidhje me pronësinë mbi tokën, Liqeni i Ohrit është i regjistruar si një kadastrë e vetme e cila është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vlerat natyrore të zonës, të përmbledhura shkurtimisht, janë:

- Liqeni i Ohrit është një dukuri e mahnitshme natyrore, e cila siguron strehim për lloje të ndryshme endemike dhe relikte të ujërave të ëmbla të florës dhe faunës të cilat e kanë prejardhjen nga Periudha Terciare.
- Liqeni i Ohrit është një prej liqeneve të pakta të lashta në mbarë botën dhe një zonë e rëndësishme për biodiversitetin me një vlerë të lartë natyrore.
- Liqeni i Ohrit është një shembull kryesor i një liqeni me një magnitudë të taksonëve endemikë të shtrirjes së ngushtë të cilët janë nën trysinë antropogjene në rritje.

Për shkak të vlerave të tij të jashtëzakonshme, liqeni është mbrojtur në bazë të niveleve të ndryshme të tilla si ligji kombëtar në Maqedoninë e Veriut që prej vitit 1977 në kategorinë e “Monumentit të Natyrës”. Rajoni i Ohrit u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 1979 për shkak të vlerave të tij natyrore. Në vitin 2019 zona u zgjerua në Shqipëri. Një Plan për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit (2020 - 2029) u përgatit në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit. Liqeni i Ohrit ka një kufi të përbashkët me Parkun Kombëtar të Galiçicës. Më tej zona e Ohër-Prepës u shpall një rezervë e Biosferës në vitin 2014 dhe Liqeni i Ohrit mori statusin e zonës Ramsar në vitin 2021. Një studim për ri-valorizimin e Liqenit të Ohrit u përgatit në vitin 2021.

Veprimtaria u krye në kuadër të projektit për biodiversitetin GEF STAR5 “Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës” dhe zbatohet nga UNEP përmes MMJPH si partner dhe përfitues. IUCN-i u kontraktua nga UNEP si partner lokal për zhvillimin e studimit të Valorizimit për Liqenin e Ohrit si një bazë për procedurën e rishpalljes. Studimi u paraqit në tre komuna Ohër, Strugë dhe Debërcë pas përfshirjes së ngushtë në proces ku u nënshkrua një deklaratë e përbashkët nga të tre kryetarët e këtyre komunave.

Në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Liqeni i Ohrit duhet të rishpallet fillimisht si monument i natyrës. Kjo do të krijojë entitetin menaxhues. Më tej entiteti menaxhues organizon një debat publik për Planin e Menaxhimit së bashku me MMJPH dhe miraton Planin e Menaxhimit, me miratimin paraprak të MMJPH. Në pajtim me Ligjin për Mjedisin, është e nevojshme të kryhet një procedurë për vlerësimin strategjik të mjedisit dhe një procedurë për pjesëmarrjen në lidhje me Projekt Planin e Menaxhimit për Monumentin e Natyrës – Liqeni i Ohrit.

Liqeni ushqehet me ujë nga Liqeni i Prepës përmes shumë burimeve bregore dhe sublukuadrine. Gjithashtu, uji del nga Liqeni i Ohrit përmes degëve të shumta të lumenjve, pjesa më e madhe e të cilave janë rrëqe të vogla të cilat rrjedhin në mënyrë të përkohshme gjatë periudhave të shkrirjes së dëborës dhe shirave të rrëmbyeshëm. Ndërkohë që kushtet gjeologjike sigurojnë kryesisht kornizën për biodiversitetin e liqenit dhe evolucionin e tij, gjithashtu kushtet klimatike lokale janë të rëndësishme për faunën (p.sh. shpendët e

dimërimit) dhe florën. Klima në zona është mesdhetare me aspekte kontinentale dhe klima lokale ndikohet nga afërsia me Detin Adriatik, nga malet rrethuese, dhe nga kapaciteti termik i liqenit.

Liqeni i Ohrit është një liqen oligotrofik i cili ka ekzistuar për më shumë se 2 milionë vjet, dhe është streha e më shumë se 1,200 llojeve, shumë prej të cilave janë endemike. Ujërat e tij oligotrofike strehojnë mbi 200 lloje endemike bimësh dhe kafshësh me një zonë të vetme (unike për liqenin), duke përfshirë algat, krimbat e shtypur, kërmijtë, gaforret, peshqit, duke përfshirë dy lloje të troftës. Liqeni është gjithashtu i rëndësishëm për shumë lloje shpendësh.

Studimi për Valorizimin paraqet lloje të shumta kryesore që luajnë rol të rëndësishëm dhe funksione të ndryshme brenda proceseve ekologjike të Liqenit të Ohrit dhe që janë kryesore për të mundësuar masat efektive e të përpikta të ruajtjes.

| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Grupi taksonimik |
|--|-----------------------------|--------------------------------|-----------------------|------------------|
| <i>Salmo ohridanus</i> | Белвица | Ohrid belvica | Belushka | Peshqit |
| <i>Hyla arborea</i> | Лисна жаба / гаталинка | European tree frog | Bretkosa e drurëve | Amfibët |
| <i>Emys orbicularis</i> | Блатна желка | European Pond Turtle | Breshka e Kënetës | Zvarranikët |
| <i>Aythya ferina</i> | Црвеноглава норка | Common Pochard | Kryekuqe e mjeme | Shpendët |
| <i>Phalacrocorax pygmeus (Microcarbo pygmaeus)</i> | Мал корморан | Pygmy Cormorant | Karabullaku i vogël | Shpendët |
| <i>Netta rufina</i> | Цвеноклуна потопница превез | Red-crested pochard | Zhytkryekuqja e madhe | Shpendët |
| <i>Fulica atra</i> | Лиска | Common Coot | Bajza | Shpendët |
| <i>Mergus merganser</i> | Голем северен потопник | Goosander | Zhytraku i madh | Shpendët |
| <i>Lutra lutra</i> | Видра | Eurasian otter | Lundërza | Shpendët |
| <i>Brachytron pratense</i> | | Hairy Hawker / Hairy dragonfly | | Insektet |
| <i>Pisidium edlaueri</i> | | | | Bivalvia |
| <i>Gocea ohridana</i> | Охридски воден полжав | | | Gastropoda |
| <i>Angelica palustris</i> | Барска Ангелика | Marsh Angelica | | Bimët |
| Llojet kryesore të Liqenit të Ohrit | | | | |

Një pjesë tjetër e rëndësishme e faunës së Liqenit të Ohrit janë sfungjerët e ujërave të ëmbla (p.sh.) *Ochridaspongia rotunda*, të cilët duke iu nënshtruar studimeve taksonikime specifike dhe shteruese në të kaluarën, meritojnë vëmendje në të ardhmen. Studimi paraqet brezat me kallamishte si habitatet kryesore në Liqenin e Ohrit, meqenëse ato ofrojnë strehim ndaj shumë llojeve, ndërkohë që në të njëjtën kohë shërbejnë si treguesë për rritjen e eutrofikimit. Për më tej, me rëndësi është të theksohet se nëntë zonat në Liqenin e Ohrit janë identifikuar si zona të rëndësishme të biodiversitetit në studimet e mëparshme. Studimi për Valorizimin identifikon 136 lloje të faunës dhe florës përkatëse për mbrojtje që gjenden në listat e Kuqe të IUCN-it, listat e kuqe të Maqedonisë, listën e llojeve të mbrojtura (në mënyrë të rreptë) në Maqedoninë e Veriut, në Shtojcën II të Direktivës së BE-së për Habitatet ose të Shtojcës 1 të Direktivës së BE-së për Shpendët.

Përcaktimi i kushteve socio-ekonomike, në bazë të regjistrimit kombëtar të fundit në vitin 2002 rreth 124000 banorë u regjistruan në 3 komuna përreth liqenit. Peshkimi është një traditë e vjetër dhe ditët e sotme rregullohet përmes koncesioneve. Megjithatë, aktualisht, liqeni nuk ka një koncesionar të peshkimit.

Ujërat e ndotura të prodhuara nga tre komunat mbledhet kryesisht përmes një sistemi kryesor të kolektorëve, të zhvilluar rreth 35 vjet më parë për të mbrojtur trupin ujqor nga ndotja dhe eurotrifikimi. Ky kolektor menaxhohet nga një ndërmarrje publike dhe gjatë 2 viteve të fundit janë arritur përmirësime të rëndësishme të infrastrukturës së tij. Megjithatë, gjatë sezonit turistik kapaciteti i sistemit nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar vëllimet e ujërave të ndotura të prodhuara.

Turizmi është një sektor i rëndësishëm ekonomik për komunitetet rreth liqenit, me një numër prej 1.000.000 vizitorësh që akomodohen në vit. Përveç përfitimeve ekonomike, turizmi gjithashtu ka ndikime negative dhe shton trysnitë në mjedis përmes prodhimit të ujit të ndotur dhe mbetjeve të përgjithshme. Ndërtimet e parregulluara, përdorimi intensiv i plazheve dhe lëvizja e mjeteve lundruese kanë gjithashtu ndikime të dukshme në mjedis.

Trysni të shumta antropogjenike shkaktojnë ndikim negativ në Liqenin e Ohrit:

- Mungesë e menaxhimit të zonës së mbrojtur që prej vitit 1977
- Turizmi
- Peshkimi i parregulluar
- Ndotja nga ujërat e zeza që shkarkohen nga degët e lumenjve
- Pesticidet dhe plehërat kimikë nga bujqësia në jug të liqenit
- Menaxhimi i ujit për prodhimin e energjisë elektrike
- Introdiktimi (futja) e llojeve jo autoktone
- Degradimi i habitateve përmes përdorimit të plazheve
- Përdorimi i kanalit Studençishko si një mol (marina) për ankorimin e varkave


Ndikimet negative ndaj biodiversitetit të Liqenit të Ohrit janë:

- Mungesa e monitorimit sistematik
- Masat e ruajtjes janë pothuajse jo ekzistente
- Eutrofikimi i shkaktuar nga shkarkimi i ujërave të përdorur të patrajtuar
- Fauna, flora dhe habitatet shqetësohen përmes varkave dhe përdorimit të plazheve
- Ndotja nga nafta, benzina, ujërat e ndotura dhe kimikate të tjera nga varkat dhe mjetet lundruese
- Ndërtimi në zonat bregore ndikon habitatet dhe llojet
- Peshkimi i paligjshëm dhe i parregulluar ndikon faunën e peshqve
- Degët e Liqenit të Ohrit transportojnë lëndë ushqyese antropogjene, ngarkesa sedimentesh dhe ndotës të tjerë dhe për rrjedhojë përbëjnë një kërcënim ndaj Liqenit oligotrofik të Ohrit
- Humbja e habitateve, degradimi dhe fragmentimi (copëzimi) përmes veprimtarive të ndryshme të njeriut përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit kanë pasoja të drejtpërdrejta ndaj faunës dhe florës
- Bujqësia në pellgun jugperëndimor të Ohrit rezulton në rrjedhjen e plehërave kimikë dhe pesticideve të transportuara në liqen të cilat shkaktojnë drejtpërdrejt eutrofikim dhe ndotje
- Eutrofikimi me fosfor nga Liqeni i Prespës që vjen nga lidhja e nëndheshme hidraulike karstike shkakton eutrofikimin e Liqenit të Ohrit
- Llojet jo autoktone përbëjnë një kërcënim ndaj ekosistemit të lashtë të komuniteteve të ekosistemit duke zëvendësuar llojet autoktone

- Luhatjet e nivelit të ujit për shkak të menaxhimit të papërshtatshëm të pendëve hidroelektrike në Lumin e Drinit të Zi ndikon në biodiversitetin e liqenit

Studimi i Valorizimit siguron një justifikim të hollësishëm për arsyen për të cilën liqeni duhet të mbrohet si Kategori III – Monument i Natyrës në bazë të Udhëzimeve të IUCN-it:

- Vlerësimi i objektivave kryesore të IUCN-it tregon se Liqeni i Ohrit është një tipar i veçantë natyror, i formuar nga procese të lashta gjeologjike, të cilat kanë krijuar monumentin unik të natyrës. Për më tepër, njohja e vlerës së saj të lartë nga vizitorët tregon se Kategoria III – Monument i Natyrës është e përshtatshme.
- Një analizë e hollësishme krahasuese e përputhjes me objektivat për ruajtjen të IUCN-it si dhe tiparet dalluese për Kategoritë II, III, VI çon në përfundimin final se Kategoria III e IUCN-it – Monument i Natyrës është kategoria më e mirë e përputhjes me kategorinë e mbrojtjes, meqenëse objektivat e tij kryesore janë:
 - Të mbrojnë tipare të veçanta të jashtëzakonshme natyrore dhe biodiversitetin dhe habitatet përkatëse
 - Të mbrojnë sitet e veçanta natyrore me vlera shpirtërore dhe/ose kulturore ku këto kanë gjithashtu vlera të biodiversitetit
- Për më tepër, për shkak se Liqeni i Ohrit është një tipar i i dukshëm natyror dhe ekologjia përkatëse e tij, më shumë se sa në një ekosistem i gjerë, është një tipar gjeologjik natyror.



Për të siguruar dhe promovuar mbrojtjen e vlerave natyrore të liqenit, katër zona janë hartuar: zona e mbrojtjes së rreptë, menaxhimi aktiv, zhvillimi i qëndrueshëm dhe rripi mbrojtës prej 9

50m përreth kufijve të liqenit. Një përshkrim narrativ i kufijve dhe zonave ofrohet në kreun 4.3.

Lista e kufizimeve të veprimtarive për secilën zonë:

| Veprimtaritë | Zona e Mbrojtjes së rreptë | Zona e Menaxhimit aktiv | Zona e zhvillimit të qëndrueshëm | Zona e jashtme, rripi mbrojtës |
|---|----------------------------|-------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
| Veprimtaritë e hulumtimit shkencor | PO | PO | PO | PO |
| Veprimtaritë mjedisore/të natyrës së egër nga personat e autorizuar | PO | PO | PO | PO |
| Vrojtimi i shpendëve dhe kafshëve të tjera të natyrës së egër; në zonën e mbrojtjes së rreptë (strikte) vetëm me roje pylli ose udhërrëfyes të trajnuar dhe të certifikuar | PO | PO | PO | PO |
| Veprimtaritë edukative në zonat e rregulluara posaçërisht për atë qëllim vetëm me roje pylli ose udhërrëfyes të trajnuar dhe të certifikuar | PO | PO | PO | PO |
| Manipulimi i llojeve dhe habitateve nga persona të autorizuar në mënyrë që të përmirësohet statusi i tyre i ruajtjes, me miratimin nga MMJPF | PO | PO | PO | PO |
| Notimi dhe zhytja në zonë | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – lundrimi | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – “kajce” me motorrë elektrikë (kalimi deri në fund të vitit 2026) | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – katamarranët me kapacitet maksimal të pasagjerëve prej 12 personash vetëm me motorrë elektrikë (kalimi deri në fund të vitit 2026), Kufiri i shpejtësisë për t’u përcaktuar | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – varkat turistike për pasagjerët (përfshirë: varkat elektrike për pasagjerët mund të futen në zonën e menaxhimit aktiv me lejen nga subjekti i menaxhimit) | JO | JO | PO | N/A |
| Varkat – varka me motorrë me kufij shpejtësie prej 15 nje | JO | JO | PO | N/A |
| Motorrët e ujit dhe pajisjet e tyre | JO | JO | JO | N/A |
| Heqja e kallamishëve (përveç rasteve të lejeve paraprake nga MMJPH) | JO | JO | JO | JO |
| Shtimi i veprimtarive ndërgjegjësuese | | | PO | PO |
| Peshkimi rekreativ | JO | PO | PO | N/A |
| Peshkimi për qëllime kryesisht ekonomike në pajtim me rregulloret (koncesioni) | JO | PO | PO | N/A |
| Gjuetia | JO | JO | JO | JO |
| Mbledhja e bimëve ose kafshëve (përveç peshkut) | JO | JO | JO | PO |
| Ndezja e zjarreve në terrene të hapura | JO | JO | JO | PO |
| Bujqësia dhe kopshtaria tradicionale | N/A | N/A | N/A | PO |
| Kullotja e bagëtive | N/A | N/A | N/A | PO |
| Ndërtimi duke përdorur beton, gurë, metale ose dru | JO | JO | JO | PO |
| Degradimi ose shkatërrimi i habitateve natyrore | JO | JO | JO | JO |
| Rrjedhja e ujërave të zeza të patrajtuara nga zonat e banuara | JO | JO | JO | JO |
| Introduktimi (futja) i llojeve të bimëve dhe kafshëve jo-autoktone | JO | JO | JO | JO |
| Djegia e bimësisë natyrore | JO | JO | JO | JO |
| Futja e lëndëve të dëmshme që mund të shkaktojnë ndryshime kimike, fizike, biologjike, mikrobiologjike dhe të tjera në ujë ose në natyrën e egër | JO | JO | JO | JO |
| Nxjerrja e rërës ose e zhavorrit | JO | JO | JO | JO |
| Shkarkimi i mbetjeve të ngurta | JO | JO | JO | JO |

Plani i menaxhimit paraqet një vizion për menaxhimin e ardhshëm të Liqenit të Ohrit i cili shpreh rëndësinë për mbrojtjen e vlerave natyrore. Në të njëjtën kohë plani i menaxhimit propozon përfshirjen e komuniteteve lokale që përcaktojnë potencialin për zhvillimin e qëndrueshëm turistik për të sjellë zhvillimin e qëndrueshëm në rajon. Në bazë të vizionit përshkruhen qëllime të shumta:

- Vlerat natyrore të jashtëzakonshme të Liqenit të Ohrit Monument i Natyrës valorizohen, mbrohen, ruhen dhe monitorohen vazhdimisht.
- Proceset natyrore dhe funksionet ekologjike të zonës së mbrojtur ndodhin në mënyrë të pashqetësuar.
Kushtet e favorshme të ruajtjes së habitateve dhe llojeve mirëmbahen duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e natyrës, zonimin dhe mbrojtjen e regjimit në zonën e mbrojtur të Liqenit të Ohrit.
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore është në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e natyrës, peshkatarinë dhe bujqësinë. Koncepti i shërbimeve të ekosistemit në Liqenin e Ohrit është zhvilluar dhe ofron përdorim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të ekosistemit, që shihen si një mundësi për zhvillimin ekonomik të popullsisë lokale.
- Mbrojtja, valorizimi dhe promovimi i vlerave kulturore ndaj interesit në rritje të vizitorëve në zonën e mbrojtur dhe rajonin e Ohrit.
- Vlerat natyrore të rëndësisë kombëtare, evropiane dhe globale mbrohen dhe promovohen ndaj komuniteteve dhe vizitorëve.
- Bashkëpunimi me ZM e Liqenit të Ohrit forcohet, duke kontribuar ndaj promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm lokal.
- Infrastruktura e vizitorëve së bashku me mekanizmat e krijuara të komunikimit për informacionin e rregullt dhe sigurimin e një platforme edukative çojnë në një sjellje të përgjegjshme për mbrojtjen e natyrës.
- Krijimi i një Organi Menaxhues të administratës së motivuar, efikase dhe profesionale i cili do të planifikojë, praktikojë dhe zbatojë praktika të shëndosha për Liqenin e Ohrit.

Pjesët qendrore të planit të menaxhimit janë 7 programe me nënprogramet, që rezultojnë në veprimtari të hollësishme që do të zbatohen me anë të një plani operativ 5-vjeçar. 7 programet dhe nën programet janë:

1. Ruajtja dhe Monitorimi i Trashëgimisë Natyrore
 - i. Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore të Liqenit të Ohrit
 - ii. Monitorimi i trashëgimisë natyrore
 - iii. Monitorimi i peizazhit
 - iv. Monitorimi i cilësisë së monitorimit
 - v. Rijetësimi i habitateve dhe ekosistemeve të rëndësishme
2. Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore
 - i. Mbështetja e praktikave të qëndrueshme të peshkatarisë
 - ii. Inkurajimi i praktikave të qëndrueshme ekologjike bujqësore
 - iii. Kompensimet për shërbimet e ekosistemit
3. Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore
 - i. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore
 - ii. Menaxhimi i trashëgimisë së qëndrueshme kulturore
 - iii. Promovimi i trashëgimisë kulturore
4. Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm
 - i. Vlerësimi dhe mbështetja e vendodhjeve turistike për zhvillimin e eko-turizmit të qëndrueshëm në Liqenin e Ohrit dhe zonat përreth tij
 - ii. Zhvillimi i infrastrukturës së eko-turizmit dhe vendosjes së markës


- iii. Sistemi për kontrollin dhe monitorimin e vizitorëve në Liqenin e Ohrit dhe zonat përreth tij
5. Zhvillimi Lokal
 - i. Pjesëmarrja e komuniteteve në menaxhimin e Liqenit të Ohrit
 - ii. Rritja e përfitimeve ekonomike për komunitetin lokal
6. Informimi, Rritja e Ndërgjegjësimit dhe Edukimi
 - i. Krijimi i një sistemi për informacionin real dhe të saktë të publikut
 - ii. Marrëdhëniet me publikun dhe forcimi i ndërgjegjësimit publik për Liqenin e Ohrit
 - iii. Infrastruktra për informimin dhe edukimin e turistëve dhe popullsisë
7. Qeverisja, Menaxhimi, Organizimi i Punës dhe Financimi
 - i. Forcimi institucional i Liqenit të Ohrit
 - ii. Sigurimi i kornizës ligjore dhe të planifikimit që nevojitet për qeverisjen
 - iii. Menaxhimi efikas dhe i efektshëm i Liqenit të Ohrit
 - iv. Financimi

Mekanizma të shumta për konsultimin me palët e përfshira paraqiten në planin e menaxhimit i cili synon të forcojë mbështetjen nga palët e interesuara në të ardhmen. Disa avantazhe të rëndësishme të përfshirjes publike janë për monitorimin dhe hulumtimin, evidentimin e veprimtarive kontrastive, aksesimin e njohurive komunitare ose vendimmarrjes së përmirësuar nga Ndërmarrja Publike. Shembujt për mekanizma të tilla janë platforma të rregullta për shkëmbime dhe bashkëpunime të rregullta, udhëtime studimore, konferenca dhe panaire dhe ngjarje të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar ose bashkëpunimi kufitar me organizatat në Shqipëri.

Studimi për Valorizimin në mbështetje të rishpalljes së Liqenit të Ohrit propozon krijimin e një ndërmarrjeje publike (NP) për menaxhimin e zonës së mbrojtur të Liqenit të Ohrit Monument i Natyrës. Ndërmarrja publike krijohet në mënyrë që të kryehen veprimtaritë e interesit publik. Këto përcaktohen si veprimtaritë të cilat janë parakushte të domosdoshme për jetën dhe punën e qytetarëve, për vënien në funksion të entiteteve ligjore si dhe për organet shtetërore.

Struktura e Ndërmarrjes Publike duhet të hartohet me:

- Bordin ekzekutiv (Këshilli i vendimmarrjes): komunat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës, MMJPH, MTL (Autoriteti Portual i Ohrit)
- Bordi i palëve të përfshira (bordi këshillues): Shtetasit, OJQ-të, Komitetet, PK i Galiçicës, dhe palët e tjera përkatëse
- Bordi shkencor (bordi këshillues): IHB Ohër, Muzetë në Strugë dhe Ohër, Universiteti i Shkupit dhe OJQ-të me njohuritë përkatëse teknike dhe shkencore
- Drejtori dhe stafi profesional i Ndërmarrjes Publike (rreth 15 anëtarë teknikë dhe të stafit administrativ dhe 6 roje të liqenit)



Në lidhje me këtë strukturë të propozuar u përgatit një buxhet:

| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|----------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Shpenzimet Operative / Fikse EUR | | | | | |
| Nëntotali i Burimeve Njerëzore | 311.170 | 311.170 | 311.170 | 311.170 | 311.170 |
| Nëntotali i Zyrës dhe Mirëmbajtjes | 81.055 | 70.222 | 70.222 | 72.722 | 70.222 |
| Nëntotali i Investimeve | 95.000 | 37.500 | 6.000 | 10.000 | - |
| Nëntotali i shpenzimeve operative | 487.225 | 418.892 | 387.392 | 393.892 | 381.392 |
| Shpenzimet për projektet EUR | | | | | |
| Studimet dhe projektet e zgjedhura | 490.000 | 700.000 | 1.055.000 | 725.000 | 1.125.000 |
| Kostot totale EUR | 977.225 | 1.118.892 | 1.442.392 | 1.118.892 | 1.506.392 |

Burime të shumta të financimit për veprimet e parkut kombëtar duhet të konsiderohen dhe angazhohen për financimin e veprimeve të zonës së mbrojtur dhe projekteve përkatëse:

- Fondet kombëtare (qeveria)
- Bashkitë
- PONT
- Kompensimet turistike
- IPA- BE
- Programi i BE-së për bashkëpunimin kufitar
- GIZ
- UNDP, përmes zbatimit të projekteve të ndryshme të donatorëve
- UNEP, përmes zbatimit të projekteve të ndryshme të donatorëve
- Bashkëpunimi zviceran
- Donatorë të tjerë ndërkombëtarë
- Sponsorizimi i sektorit privat

2 Hyrje

Liqeni i Ohrit është një liqen ndërkufitar në Ballkanin Perëndimor i ndodhur në zonën malore ndërmjet pjesës jugperëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë lindore. Në Maqedoninë e Veriut, liqeni ndodhet brenda kufijve administrativë të tre komunave: Ohrit, Strugës dhe Debërcës.

Vlerat natyrore të zonës, të përshkruara shkurtimisht, janë:

- Liqeni i Ohrit është një dukuri e mrekullueshme natyrore, që siguron strehim për lloje të panumërta endemike dhe relikte të ujërave të ëmbla të florës dhe faunës që e kanë prejardhjen që nga Periudha Terциare.
- Liqeni i Ohrit është një nga ato pak liqene të lashta mbarëbotërore dhe një rajon i biodiversitetit me vlerë të lartë natyrore përkatëse.
- Liqeni i Ohrit është shembulli kryesor i një liqeni me një mori taksonësh endemikë të shtrirjes së ngushtë të cilët janë nën trysinë antropogjene në rritje.

Liqeni i Ohrit është një nga liqenet më të thellë dhe më të vjetër në Europë, me një sistem unik ujqor të rëndësisë botërore. Ai është një liqen oligotrofik, i cili ka ekzistuar për më shumë se 2 milionë vjet, dhe është streha e mbi 1,200 llojeve, shumë prej të cilave janë endemike. Ujërat e tij strehojnë mbi 200 lloje bimësh dhe kafshësh unike endemike të zonës (unike për liqenin), ku përfshihen algat, krimbat e shtypur, kërmijtë, gaforret, peshqit, duke përfshirë dy lloje të troftës. Liqeni është gjithashtu i rëndësishëm për llojet e shpendëve.

Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme të liqenit, pjesa maqedonase është mbrojtur në bazë të ligjit kombëtar që prej vitit 1977 si zonë e mbrojtur e kategorisë “Monument i Natyrës”. Gjithashtu, për shkak të vlerave të tij natyrore dhe kulturore, Rajoni i Ohrit është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Ndërmjet Liqeneve të Ohrit dhe të Prespës shtrihet Parku Kombëtar i Galiçicës. E gjithë zona e Ohër-Prepës u shpall Rezervat Ndërkufitar i Biosferës në vitin 2014 dhe u përcaktua si zonë Ramsar në vitin 2021. Liqeni i Ohrit është propozuar gjithashtu si zonë e rrjetit Natura 2000 dhe zonë Emerald.

Në bazë të Direktivës së BE-së të Kornizës për Ujrat, kohët e fundit është përgatitur një plan menaxhimi për pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit.

Liqeni i Ohrit është një ndër **atraksionet turistike më të rëndësishme në Maqedoninë e Veriut**. Komunitatet e Ohrit dhe të Strugës sigurojnë 35 % të të gjithë objekteve akomoduese në vend. Gjatë sezonit turistik 2018 (muaji maj deri në muajin shtator) janë regjistruar rreth 1,000,000 qëndrime gjatë natës. Për më tepër, pushime të panumërta të kryera nga turistët vendas në pronat private të Ohrit nuk janë përfshirë në statistikat për turizmin.

Peshqit dhe peshkimi kanë luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në rajonin e Liqenit të Ohrit. Regjistrimet historike të mënyrës së jetesës në vendbanimet e lashta tregojnë praninë e madhe të peshqve në ato kohë. Në kohët moderne peshkimi mbetet ende një sferë e rëndësishme, pavarësisht se rezervat e peshqve i nënshtrohen trysnive të shumta, duke përfshirë ndotjen dhe degradimin e habitateve, peshkimin e paqëndrueshëm dhe llojet invasive. Për më shumë se një vit nuk ka pasur asnjë koncension aktiv për peshkatarinë, pra asnjë kontroll aktiv mbi të.

Trysni të dhe kërcënimet për habitatet dhe llojet si dhe për cilësinë e ujit e kanë prejardhjen nga:

- Mungesa e menaxhimit aktiv të zonave të mbrojtura;
- Ndikimi i njeriut përmes turizmit i cili shkakton pasoja të panumërta negative;
- Përdorimi i varkave;
- Përdorimi i plazheve i cili ndikon në habitatet përgjatë vijës bregore;
- Peshkimi i paqëndrueshëm dhe i pakontrolluar;
- Ndotja nga ujërat e zeza të vendbanimeve (pavarësisht përmirësimeve të sistemit të kolektorëve në vitin 2019) që ka shkakuar eutrofikimin;
- Ndotja nga transportimi i plehrave kimike dhe bujqësore, mbetjet e ngurta, të transportuara nga degët lumore të cilat shkaktojnë eutrofikimin;
- Varkat në kanalën Studençishko;
- Pendët (digat) hidroelektrike;
- Ndërtimet buzë bregut ose pranë tij;
- Mbetjet e ngurta;
- Ndryshimet klimatike;
- Ndotja nga industria;
- Llojet e introduktuara (të futura).

Studimi për valorizimin paraqet më shumë se 90 lloje dhe habitate të kërcënuara.

Për sa më lart, MMJPH ka ndërmarrë një procedurë të rishpalljes së Liqenit të Ohrit. Kjo procedurë u mundësua përmes projektit të financuar nga Qendra Globale për Mjedisin: “Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës”, i zbatuar nga Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara, në partneritet me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si përfituesi kryesor.

IUCN u angazhua për të mbështetur përgatitjen e studimit për valorizimin dhe planin e menaxhimit. Studimi për valorizimin u krye në muajin shtator të vitit 2021 në të trija komunat të cilat ndajnë së bashku Liqenin e Ohrit: Ohri, Struga dhe Debërca, dhe u ra dakord që Ohri do të niste rishpalljen zyrtare duke paraqitur studimin në MMJPH. Gjatë përgatitjes së studimit për valorizimin u konsultuan shumë aktorë të përfshirë, në takime personale dhe diskutime publike online në dhjetor të vitit 2020.

Krijimi i një organi menaxhues për Liqenin e Ohrit është thelbësor. Ky plan i menaxhimit është përgatitur në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe do të shërbejë si një dokument pune për këtë entitet.

3 Përshkrimi i Zonës

3.1 Informacion i Përgjithshëm

3.1.1 Vendodhja gjeografike dhe Korniza Administrative

Liqeni i Ohrit është një liqen ndërkufitar në Ballkanin Perëndimor i pozicionuar në një zonë malore ndërmjet pjesës jugperëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë lindore. Në Maqedoninë e Veriut, liqeni ndodhet brenda kufijve administrativë të tre komunave: Ohrit, Strugës dhe Debërcës. Qytetet kryesore pranë liqenit janë Ohri dhe Struga (në Maqedoninë e Veriut) dhe Pogradeci (në Shqipëri).

Liqeni ndahet nga Liqeni i Prespës (i cili gjendet në një reliev më të ngritur) me anë të Malit karstik të Galiçicës në pjesën e tij lindore. Uji rrjedh nëntokë nga Liqeni i Prespës përmes karstit dhe ushqen burimet e ndodhura në brigjet e Liqenit të Ohrit. Uji largohet nëpërmjet Lumit Drin i cili shfaqet në bregun verior të liqenit në Strugë dhe rrjedh në drejtim të veriut të Shqipërisë duke u derdhur në Detin Adriatik.

Faktet gjeografike:

| | |
|---------------------|-------------------------------|
| Gjerësia (veri) | 41°10'25" deri 40°54'05" |
| Gjatësia (lindje) | 20° 37' 42" deri 20° 48' 33" |
| Lartësia | 693 metra mbi nivelin e detit |
| Sipërfaqja e zonës | 348.8 km ² |
| Vëllimi | 55.5 km ³ |
| Thellësia maksimale | 289 m |
| Thellësia mesatare | 155 m |

3.1.2 Korniza Ligjore

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16, 63/16 dhe 113/18), kur rishpallet një zonë e mbrojtur, duhet të përgatitet një studim për ri-valorizimin për të siguruar një vlerësim të saktë të situatës aktuale si bazë për rishpalljen.

Përmbajtja e një studimi të tillë përkufizohet në Rregulloren e përmbajtjes së studimit për valorizimin ose rivlerësimin e një zone të mbrojtur (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 26/12).

Ligje të mëtejshme kombëtare janë: Ligji për Ujërat; Ligji për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit; Ligji për Lundrimin e Brendshëm; Ligji për Mbrojtjen e Liqeneve të Ohrit, Prespës dhe Dorjanit; Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe Ujëmbledhësin e Liqenit të Ohrit; Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë; Ligji për Koncesione dhe Partneritet Publik-Privat; Ligji për Planifikimin Urban; Ligji për Ndërtimin; Ligji për Autokampe; Ligji për Zona Zhvillimore Turistike; dhe Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Rajoni i Ohrit u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 1979 për njohjen e vlerave të tij natyrore. Në vitin 1980 nominimi u zgjerua duke shtuar kriteret për vlerat kulturore dhe zona u regjistrua nën emrin "Rajoni i Ohrit me aspektet e tij kulturore dhe historike dhe

mjedisin e tij natyror.” Në vitin 2019 zona u zgjerua në Shqipëri. Në pajtim me Ligjin për Menaxhimin me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 75/10) dhe përmes konsultimit publik u përgatit Plani për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Ohrit (2020 - 2029).

Liqeni i Ohrit ka një kufi të përbashkët me Parkun Kombëtar të Galiçicës. Rreth dy të tretat e parkut përfshihen brenda kufijve të Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit, të regjistruara në listën e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore Kulturore dhe Natyrore.

Zona e Ohër-Prepës u shpall Rezervat i Biosferës më 11 qershor 2014 në seancën e Komisionit Ndërkombëtar të UNESCO-s të mbajtur në Jçnkçping, Suedi, arsyet të cilat janë përshkruar me hollësi në Rezervatin Ndërkufitar të Biosferës 'Pellgu Ujëmbledhës i Ohër-Prepës'; Formulari i Nominimit i muajit shtator 2013):

Pellgu i Lumit Drin i nënshtrohet Memorandumit të Mirëkuptimit (Tiranë, 25 nëntor 2011) nga Ministrat përgjegjës për ujërat dhe mjedisin në vendet përmes të cilave kalon Drini, përkatësisht Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Greqi, Kosovë dhe Mal i Zi. Në vitin 2020 u miratua një Plan Menaxhimi i Pellgut Ujëmbledhës për nën-pellgun e Drinit.

Në vitin 2020 u përgatit një studim për Valorizimin e Ligatinës Studençishko. Pas analizimit të vlerave dhe kërcënimeve, studimi propozon kufijtë për zonën dhe rekomandon që zona të mbrohet si Kategori IV – Park Natyror.

Në vitin 2017 Liqeni i Ohrit u propozua të nominohet si zonë e rrjetit Natura 2000 në pajtim me Direktivën për Shpendët në bazë të Projektit IPA të BE-së: "Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Natura 2000 në Maqedoni në nivelin qendror dhe lokal" 2016-2017. Propozimi u bazua në statusin e saj si një Zonë e Rëndësishme për Shpendët.

Liqeni i Ohrit është në listën e zonave kandidate për t'u nominuar zyrtarisht Emerald (burimi: Konventa për ruajtjen e Natyrës së Egër Europiane dhe Habiteteve Natyrore, takimi i 39-të i Komitetit të Përhershëm, Strasburg, 3 – 6 dhjetor 2019). Ai mori statusin e zonës Ramsar më 15 shkurt 2021 dhe Dokumenti për Informacionin e Ramsarit u botua më 7 maj 2021 (<https://rsis.ramsar.org/ris/2449>).

Plani Lokal Mjedisor i Veprimit i Komunës së Ohrit ofron informacione për liqenin dhe mjedisin e tij jetësor. Ai përshkruan vlerat natyrore të liqenit në lidhje me biodiversitetin dhe endemizmin, si edhe përshkruan trysnitë ndaj ekosistemit, kryesisht nga veprimtaritë në lidhje me zhvillimin e turizmit, dhe thekson ndotjen nga ujërat e zeza të vendbanimeve. Për më tepër, ai parashtron shqetësimet për mungesën e miratimit të dokumenteve të shumta të domosdoshme e të ngutshme për planifikimin dhe parashtron rekomandime të shumta për përmirësimin e statusit mjedisor, duke përfshirë "Ripërtëritjen e Sistemit të Mbrojtjes së Liqenit të Ohrit" me qëllim mbrojtjen e biodiversitetit të liqenit.

3.1.3 Të drejtat e pronësisë

Liqeni i Ohrit është regjistruar si një parcelë e vetme kadastrale me numër 1/1, Kadastra e Komunës Ohridsko, Ohridsko Ezero, me numër 1 të dokumentit të pronës. Parcela është regjistruar në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka një sipërfaqe prej 247,912,620 m², me përdorimin e tokës të dhënë si "liqen natyror".

AGENCY FOR REAL ESTATE CADASTRE

0 item(s) Welcome, Login

PROPERTY CERTIFICATE

1. Searching

Parcels Property Certificate

Cad. department: OHRID

Cad. municipality: OHRIDSKO EZERO

Parcel: 1/1

Property certificate

Scale = 1 : 125,000
7453477.63, 4720568.4

Faqja e Web-it e Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive me parcelën 1/1

3.2 Informacioni për Mjedisin

3.2.1 Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia

Pellgu i Ohrit ka një strukturë grabene e cila pozicionohet në vargmalet Dinaride në kufi të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Ai karakterizohet nga pellgu dhe konteksti gjeologjik me vargmale, së bashku me pellgjet gjysëm-grabene të Korçës, Ersekës dhe Dibrës së Madhe.

3.2.2 Hidrologjia dhe Hidrografia

Në bazë të vëzhgimeve të kryera për izotopet është provuar se Liqeni i Ohrit ushqehet nga Liqeni i Prespës, i cili ndodhet në reliev më të ngritur mbi 150m, përmes rrjedhës nëntokësore me formacione karstike të Maleve të Galiçicës. Uji rrjedh nga Liqeni i Prespës nën tokë dhe depërton duke u futur në Liqenin e Ohrit përmes shumë burimeve karstike nënujore përgjatë bregut të tij lindor. (Burimi: Eftimi R., Skende P. & Zoto J. (2002): An isotope study of the connection of Ohrid and Prespa lakes. GEOLOGICA BALCANICA.)

Përveç ujërave nëntokësore karstike në Malet e Galiçicës, akuiferet më të rëndësishme të ujërave nëntokësore janë në veri të Strugës në pellgun përgjatë lumit Drini i Zi dhe në verilindje të Ohrit në pellgun përgjatë Koselskës (Jovanovski M. (2009): Hydrogeological Survey on Groundwater in Macedonia. GTZ project; Lake Ohrid Watershed Management Plan 2020).

Akuifere të shumta që gjenden në gëlqerorët e Galiçicës kalojnë përmes burimeve dhe derdhen në Liqenin e Ohrit. Në bazë të llogaritjeve 49% e prurjeve nga burimet në liqen vjen nga burimet nënujore dhe 51% nga burimet sipërfaqësore.

Burimet më të rëndësishme janë ato të Shën Naumit (5-10 m³/sek), Tushemishtit (2.5 m³/sek), Biljaninit (1-2 m³/sek) dhe Bej Bunarit (40-100 l/s). (Lake Ohrid Watershed Management Plan 2020).

Uji rrjedh në Liqenin e Ohrit përmes degëve të shumta, pjesa më e madhe e të cilave janë rrëqe të vogla që vërshojnë vetëm përkohësisht gjatë shkrirjes së dëborës dhe shirave të rrëmbyeshëm. Degët kryesore të liqenit janë lumenjtë e Sateskës, Koselskës dhe Shushicës në Maqedoninë e Veriut, si dhe lumenjtë e Çërravës dhe Vërdovës në Shqipëri (Plani i Menaxhimit të Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit 2020).

3.2.3 Climate

Në përgjithësi, kushtet lokale të klimës në zonën e Liqenit të Ohrit janë mesdhetare me ndikime kontinentale. Klima lokale ndikohet nga afërsia me Detin Adriatik, nga malet përreth, dhe nga kapaciteti termik i liqenit.

Temperatura mesatare vjetore e regjistruar në rajonin e Ohrit është 11.5°C; temperaturat mesatare variojnë nga 21°C gjatë verës deri 1.8°C gjatë dimrit (Fig 2.3). Temperatura e liqenit varion nga 6°C (ujë pelagjik, nën thellësinë 150m, gjatë të gjithë vitit) deri 24–27°C në sipërfaqe gjatë verës.

Morfologjia e ujëmbledhësit gjithashtu ndikon në regjimin e erës, me erëra veriore që mbizotërojnë gjatë dimrit dhe erëra jugore dhe jug-lindore gjatë verës. Shpejtësia mesatare e erës në rajonin e Liqenit të Ohrit është relativisht e ulët, 1.8m/s.

3.2.4 Tiparet Biogeografike

Në bazë të rajoneve biogeografike të Bashkimit Evropian, zona i përket rajonit alpin. Në Evropë, rajoni alpin është i pranishëm në shumë vargmale alpine. Këto zona ndajnë tipare të veçanta të tilla si një klimë relativisht e ftohtë dhe e ashpër, relieve të larta dhe topografi të ndërlikuar. Si të tilla, ato ofrojnë habitate shumë të veçanta të cilat shpesh mbështesin biodiversitetin e pasur. Rajoni alpin përfshin Malet e Alpeve, Apenineve, Pirenejve, Skandinaveve, Karpateve, të Ballkanit dhe Rodopit.

3.2.5 Algat

Botime të panumërta nga Zlatko Levkov dhe autorë të tjerë mbi diatomet (njëqelizorët) e Liqenit të Ohrit dokumentojnë karakterin e jashtëzakonshëm të liqenit në lidhje me grupin taksonimik. Rreth 800 taksonë raportohen për Liqenin e Ohrit nga të cilët 117 (14%) konsiderohen endemikë për liqenin dhe 15 (1.9%) lloje relikte ose të njohur vetëm nga depozitimet e fosilizuara në Rumani.

Cvetkoska A., Pavlov A., Jovanovska E., Tofilovska S., Blanco S., Ector L., Wagner-Cremer F. & Levkov Z. (2018): Spatial patterns of diatom diversity and community structure in ancient Lake Ohrid, autorët analizuan modelet e strukturës së bashkësisë dhe diversitetit tek diatomet (njëqelizorët) në Liqenin e lashta të Ohrit dhe dolën në përfundimin se diatomët (njëqelizorët) në pjesët veriore të liqenit ndikohen ndjeshëm nga përqendrimi i fosforit, duke pasqyruar eutrofikimin e vazhdueshëm për shkak të rritjes së ngarkesës së lëndëve ushqyese antropogjene.

Blazencic (2004) përshkruan 24 lloje taksonimikë karofitikë (charophyta) të regjistruar në Liqenin e Ohrit. Liqeni është locus clasicus për *Chara ohridana* endemike dhe një nga vendndodhjet më të pasura me karofita (charophyta) në Gadishulin e Ballkanit. Së bashku me Liqenin e Shkodrës në Malin e Zi dhe liqenet Bacinska në Kroaci, Liqeni i Ohrit është një nga tre qendrat më të rëndësishme të diversitetit të karofita (charophyta) në Ballkan.

3.2.6 Jo vertebrorët e Mëdhenj Bentikë

Jovertebrorët e mëdhenj bentikë janë kafshë të vogla të cilat jetojnë në gurë, drurë të kalbur, sedimente dhe bimë ujore në fundin e përrenjve, lumenjve dhe liqeneve. Ato janë mjaft të mëdhenj për të parë me sy hapur (makro) dhe nuk kanë shtyllë kurrizore (jovertebrorë). Shembujt përfshijnë krimbat e shtypur, krimbat e ujit dhe të dheut, shushunjat, midhjet, kërmijtë, krustacët dhe insektet, duke përfshirë larvat. Jovertebrorët e mëdhenj janë një pjesë e rëndësishme e zinxhirit ushqimor ujor. Ata ushqehen me gjethe, alga dhe bakterie dhe, në këmbim janë ushqim për peshqit, amfibët, shpendët, dhe vertebrorët dhe jovertebrorët e tjerë.

Fauna bentike e Liqenit të Ohrit karakterizohet nga nivele të larta të biodiversitetit dhe endemizmit. (Trajanovski et al. (2019). 586 lloje të jovertebrorëve të mëdhenj bentikë janë regjistruar në Liqenin e Ohrit. Këto bashkësi bentike njihen për enemizmin e tyre të lartë, për shembull 86% e 72 llojeve të njohura të gastropodave janë endemike. Tetë nga llojet jovertebrorë të mëdhenj gjenden në Shtojcën II të Direktivës së BE-së për Habitatet, tetë gjenden në Shtojcën IV dhe një në Shtojcën V (*Dytiscus latissimus*). Në bazë të Listës së Kuqe IUCN-së për Llojet e Kërcënuara, 28 lloje janë vlerësuar si të Cënueshme (VU), 17 si të Rrezikuara (EN), dhe 10 si të Rrezikuara në Mënyrë Kritike (CE).

Bashkësitë e jovertebrorëve të mëdhenj bentikë përfshihen zakonisht në vlerësimet e trupave ujorë në bazë të Direktivës së BE-së për Kornizën e Ujërave, meqenëse ata janë tregues të mirë të cilësisë së ujit. Ata ndikohen nga kushtet fizike, kimike dhe biologjike. Ato mund të tregojnë ndikimet e ndotjes afatshkurtër dhe afatgjatë, meqenëse nuk i shpëtojnë dot asaj, dhe mund të ndihmojnë për shpjegimin e ndikimeve kumulative të ndotjes.

3.2.7 Rotiferet

Rotiferet janë një komponent i rëndësishëm i bashkësive litorale dhe limnetike të jovertebrorëve dhe një përbërës i pandashëm i rrjetave të ushqimit në ujë. Ato janë organizma të vegjël simetrikë në të dyja anët dhe jashtëzakonisht të shumëllojshëm. Rotiferët përfshijnë dy grupe kryesore: Monogononta dhe Bdelloidea. Monogononta shfaqen në pothuajse të gjitha llojet e habitateve të ujërave të ëmbla dhe formojnë një element relativisht të shumëllojshëm të faunës së ekosistemeve të ujërave të ëmbla.

Përmes një studimi të rotifereve monogonont të Liqenit të Ohrit doli në pah prania e 73 llojeve. 61 lloje u regjistruan në zonën litorale dhe 12 lloje në zonën pelagjike. Numri i lartë i





Ilojeve në habitatet litorale është për shkak të kushteve të shumëllojshme të kësaj zone. Disa nga këto lloje janë ndër rotiferet më të zakonshëm, karakteristike e habitateve në fjalë. Përbërja taksonimike e pasur me rotifere në Liqenin e Ohrit si i tërë është për shkak të llojshmërisë së madhe të habitateve ku ato gjenden. (Burimi: Tasevska O., Guseska D. & Kostoski G. (2019): A Checklist of Monogonont Rotifers (Rotifera: Monogononta) of Lake Ohrid, Republic of Macedonia. Acta Zoologica Bulgarica.)





3.2.8 Flora





Talevska & Talevski (2015) përshkruajnë 32 lloje makrofite përgjatë brigjeve të Liqenit të Ohrit: *Phragmites australis*, *Typha latifolia*, *Typha angustifolia*, *Shoenoplectus lacustris*, *Polygonum amphibium*, *Nuphar lutea*, *Potamogeton perfoliatus*, *Potamogeton pectinatus*, *Potamogeton crispus*, *Potamogeton lucens*, *Potamogeton gramineus*, *Potamogeton pusillus*, *Potamogeton nitens*, *Potamogeton acutifolius*, *Zannichellia palustris*, *Myriophyllum spicatum*, *Ceratophyllum demersum*, *Ceratophyllum submersum*, *Vallisneria spiralis*, *Elodea canadensis*, *Ranunculus trichophyllus*, *Najas marina*, *Najas minor*, *Chara tomentosa*, *Chara aspera*, *Chara gymnophylla*, *Chara globularis*, *Chara imperfecta*, *Chara ohridana*, *Nitella opaca* dhe *Nitellopsis obtusa*. Në veçanti myshku i ujit *Fontinalis antipyretica* gjendet në lokalitete.





3.2.9 Peshqit






 Lista e peshqve të Liqenit të Ohrit (fotot nga www.fishbase.se)





| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | I ngrenshëm | Foto |
|---|---------------------------|------------------------|------------------------------|------------------------------|---|---------|-------------|---|
| <i>Alburnoides ohridanus</i> (Karaman, 1928) | Охридска гомнушка, шљунец | Ohrid spirlin | Barkëgjera/ spirlini i Ohrit | Po | Jo | Po | Jo |  |
| <i>Alburnus scoranza</i> (Heckel et Kner, 1858) | Охридска плашица | Bleak | Gjuca | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Alosa falax</i> La Capede, 1803 | Харинга, лојка | Twait shad | Kubla | Jo | Po | Jo | Jo |  |
| <i>Anguilla anguilla</i> (Linnaeus, 1758) | Јагула | European eel | Ngjala | Po | Jo | Jo | Po |  |





| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | Ingrënshtëm | Foto |
|--|---------------------------|------------------------|-----------------------|------------------------------|---|---------|--------------------|---|
| <i>Barbatula sturanyi</i> (Steindachner, 1892) | Охридска вретенушка | Stone loach | Tufëza | Jo | Jo | Po | Jo |  |
| <i>Barbus rebeli</i> (Köller, 1925) | Охридска мрена | Western Balkan Barbel | Mrena e Fanit | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Carassius gibelio</i> Bloch, 1782 | Сребрен карас | Prussian carp | Karasi prusian | Jo | Po | Jo | Po |  |
| <i>Chondrostoma ohridanus</i> Karaman, 1924 | Охридски скобуст | Ohrid nase | Njila/skobusi i Ohrit | Po | Jo | Jo | Po, i kushtueshtëm |  |

| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | Ingrënshtëm | Foto |
|---|---------------------------|------------------------|-----------------------|------------------------------|---|---------|-------------|--|
| <i>Cobitis ohridana</i> Karaman, 1928 | Охридска штипалка | Spined loach | Mrena e egër e Ohrit | Po | Jo | Jo | Jo |  |
| <i>Cyprinus carpio</i> Linnaeus, 1758 | Крап | Common carp | Krap | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Eudontomyzon stankokaramani</i> Karaman, 1974 | Караманова змиорка | Drin brook lamprey | Kavalli i Drinit | Po | Jo | Jo | Jo |  |
| <i>Gambusia holbrooki</i> Girard, 1859 | Гамбузија | Eastern mosquitofish | Barkaleci pikalosh | Jo | Po | Jo | Jo |  |

| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | Ingrënshtëm | Foto |
|---|---------------------------|------------------------|---|------------------------------|---|---------|-------------|---|
| <i>Gobio ohridanus</i> Karaman, 1924 | Охридска кркушка , мренец | Ohrid gudgeon | Mrena e Ohrit | Po | Jo | Jo | Jo |  |
| <i>Lepomis gibbosus</i> Linnaeus, 1758 | Сончарка, сунчица | Pumpkinseed | Peshk diell/Sharoku diellor/sharoku laraman | Jo | Po | Jo | Jo |  |
| <i>Oncorhynchus mykiss</i> Walbaum, 1792 | Мавровска пастармка | Rainbow trout | Toftë ylberi | Jo | Po | Jo | Po |  |
| <i>Pachychilon pictum</i> (Heckel et Kner, 1858) | Моранец | Albanian roach | Skorti i zi | Po | Jo | Jo | Po |  |

| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | Ingrënshtëm | Foto |
|---|---------------------------|------------------------|-----------------------|------------------------------|---|---------|-------------|---|
| <i>Pelasgus minutus</i> Karaman, 1924 | Охридско мало грунче | Ohrid minnow | Grunci i Ohrit | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Phoxinus lumaireul</i> Schinz, 1840 | Пиор | Minnow | Cigani Italian | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Pseudorasbora parva</i> Temmini & Schlegel, 1846 | Писа? | Stone moroko | Notaku | Jo | Po | Jo | Jo |  |
| <i>Rhodeus amarus</i> (Bloch, 1782) | Платиче, плоска, пласкун | European bitterling | Idhtaku | Jo | Po | Jo | Jo |  |
| <i>Rutilus ohridanus</i> (Karaman, 1924) | Охридски грунец | Ohrid roach | Skorta e Ohrit | Po | Jo | Jo | Po |  |

| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | Ingrënshëm | Foto |
|--|-----------------------------|------------------------|-----------------------|------------------------------|---|---------|------------|--|
| <i>Salmo aphelios</i> Kottelat, 1997 | Летна пастрмка, летница | Summer Trout, Letnica | Jekna/Korani i verës | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Salmo balcanicus</i> Karaman, 1928 | Струшка пастрмка, крешеница | Struga Trout, Kresnica | Korani i Ballkanit | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Salmo letnica</i> Karaman, 1924 | Охридска пастрмка | Ohrid Trout | Korani | Po | Jo | Po | Po |  |
| <i>Salmo lumi</i> Poljakov, Filip & Basho 1958 | Охридска поточна пастрмка | Lumi Trout | Koran Lumi | Po | Jo | Jo | Po |  |

| Emri Latin | Emri në gjuhën maqedonase | Emri në gjuhën angleze | Emri në gjuhën shqipe | Autokton për Liqenin e Ohrit | I introduktuar (i futur) në Liqenin e Ohrit | Endemik | Ingrënshtëm | Foto |
|--|---------------------------------|------------------------|------------------------|------------------------------|---|---------|------------------------|---|
| <i>Salmo ohridanus</i> Steindachner 1892 | Белвица | Belvica | Belushka | Po | Jo | Po | Po |  |
| <i>Scardinius knezevici</i> (Bianco & Kottelat, 2005) | Охридска писа | Skadar Rudd | Bravica/Dranga/Gërmuqi | Po | Jo | Jo | Po, por jo i preferuar |  |
| <i>Squalius squalus</i> Bonaparte, 1837 | Клен | Italian chub | Kleni/Blyshi/Mlyshi | Po | Jo | Jo | Po |  |
| <i>Telestes montenegrinus</i> (Vuković, 1965) | Микс од моранец и грунец, писа3 | ray-finned fish | Skorti me vizë | Po | Jo | Jo | Po |  |

3.2.10 Llojet Kryesore të Faunës dhe Florës

Studimi për Valorizimin paraqet një sërë llojesh kryesore të cilat luajnë funksione të rëndësishme dhe të ndryshme brenda proceseve ekologjike të Liqenit të Ohrit. Meqenëse kryejnë funksione të ndryshme të tilla si llojet lajmëtare, llojet simbol, llojet endemike dhe llojet mbrojtëse, ato janë kryesore për të mundësuar masat e efektshme dhe të përpikta të ruajtjes.

Llojet Mbrojtëse përkufizohen si llojet ruajtja e të cilave do të ofrojë mbrojtje për një numër të madh të llojeve natyrore që shfaqen së bashku. Ky koncept është propozuar si një mjet për qëllime të ndryshme në planifikimin e ruajtjes. Ndër llojet e sugjeruara si mbrojtëse, shumica janë gjitarë dhe shpendë të mëdhenj, por gjithashtu po merren parasysh edhe jovertebrorët.

Llojet simbol janë lloje të njohura karizmatike të cilat shërbejnë si simbole për të nxitur ndërgjegjësimin dhe veprimin për ruajtjen në nivele të ndryshme.

Llojet lajmëtare janë llojet e ndjeshme ndaj ndryshimit të mjedisit, të cilat për rrjedhojë mund të ofrojnë një masë shëndetësore për ekosistemin.

Llojet endemike janë autoktone dhe kufizohen në një territor të caktuar gjeografik. Llojet endemike lokale, ato që kanë shtrirje shumë të kufizuara natyrore, janë veçanërisht të cënueshme ndaj zhdukjes nëse habitatit i tyre natyror eliminohet ose shqetësohet ndjeshëm.

Llojet e identifikuar kryesore luajnë së bashku një rol të madh dhe kritik në mbështetjen e integritetit të bashkësisë së tyre ekologjike ose në rritjen e ndërgjegjësimin dhe veprimit për ruajtjen e Liqenit të Ohrit.

3.2.10.1 Peshqit

| Lloji kryesor (Peshqit): <i>Salmo ohridanus</i> | |
|---|---|
| Emri shkencor | <i>Salmo ohridanus</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Белвица |
| Emri në gjuhën angleze | Ohrid belvica |
| Emri në gjuhën shqipe | Belushka |
| Ekosistemet | Ujërat e ëmbla (=Ujërat e brendshme) |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-së | E cënueshme (2006) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> Hibridizimi i qëllimshëm me <i>Salmo letnica</i> në fermat e peshkut gjatë 50 viteve të fundit. Ndikimet afatgjata të këtij hibridizimi janë të paqarta (Rakaj dhe Flloko 1995). I nënshtrohet peshkimit pa kriter por ende në sasi të mëdha; Ndotja e ujit për shkak të bujqësisë dhe turizmit; Shqetësimi i zonave të shumimit nga ndikimi i njeriut. |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe minimizimi i ndotjes së ujit dhe eutrofikimit; Regullorja për peshkimin; Krijimi i zonave të mbrojtjes në zonat e shumimit; Minimizimi i shqetësimeve në zonat e shumimit; |

| | |
|---------------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i popullatave. |
| Funksioni mbrojtës dhe simbolik | <p>Masat e përmirësuar të ruajtjes duke përfshirë zonat e thella dhe ato bregore të shumimit, do të arrinin të shpëtonin 4 lloje të troftës dhe mbi 24 lloje të peshqve duke përfshirë edhe ngjalën e rrezikuar në mënyrë kritike (<i>Anguilla anguilla</i>).</p> <p>Meqenëse është një lloj i njohur, i ndjeshëm ndaj peshkimit pa kriter dhe endemik për Liqenin e Ohrit, ai mund të shërbejë si një lloj simbolik për të nxitur ndërgjegjësimin për ruajtjen.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | Renditet si lloj i mbrojtjes së rreptë në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | <p>www.iucnredlist.org</p> <p>www.fishbase.se</p> <p>РИБОЛОВНА ОСНОВА ЗА РИБОЛОВНА ВОДА „ОХРИДСКО ЕЗЕРО“ ЗА ПЕРИОД 2017-2022 ГОДИНА.</p> |

3.2.10.2 Amfibët

| Lloji kryesor (Amfibët): <i>Hyla arborea</i> | |
|--|---|
| Emri shkencor | <i>Hyla arborea</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Лисна жаба / гаталинка |
| Emri në gjuhën angleze | European tree frog |
| Emri në gjuhën shqipe | Bretkosa e drurëve |
| Vlerësimi i Listës së kuqe të IUCN-së | Gati i Tanguar (Pothuaj i Kërcënuar) (2019) (NT) Lista e Kuqe e Maqedonisë së Veriut (NT – Gati i Tanguar) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Humbja e habitateve të përshtatshme • Modifikimi dhe fragmentimi i habitateve • Tharja e ligatinave • Ndryshimet në nivelet e ujit • Kërcënimet nga kërpudhat <i>Batrachochytrium dendrobatidis</i> dhe <i>Batrachochytrium salamandrivorans</i> u kuptuan kohët e fundit në Gadishullin e Ballkanit. |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtje dhe restaurim i habitateve të përshtatshme • Përmirësim i cilësisë së ujit dhe minimizim i ndotjes së ujit dhe eutrofikimit • Monitorimi i popullatave |
| Funksioni mbrojtës dhe simbolik | <p>Në përgjithësi gjendet në përrrenj, lumenj dhe ligatina. Meqenëse kërcënohet nga fragmentimi i habitateve, ndryshimet në nivelin e ujit dhe nga shtimi i kërpudhave ai shërben si një lajmëtar i mirë për modifikimet e habitateve.</p> <p>Gjatë ciklit jetësor ky lloj kërkon habitate të ndryshme dhe kërkon një qasje të peizazhit të gjerë për ruajtjen e cila cilëson funksionin e tij si mbrojtës.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | Renditet në Shtojcën IV të Direktivës së BE-së për Habitatet |

| | |
|------------|---|
| | Renditet si një lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | www.iucnredlist.org http://redlist.moep.gov.mk/ Sterijovski, B. 2015. Conservation and protection status of amphibians in Macedonia. Pelagic Publishing. Exeter, UK. |

3.2.10.3 Zvarranikët

| Lloji kryesor (Zvarranikët): <i>Emys orbicularis</i> | |
|--|--|
| Emri shkencor | <i>Emys orbicularis</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Блатна желка |
| Emri në gjuhën angleze | European Pond Turtle |
| Emri në gjuhën shqipe | Breshka e kënetave |
| Ekosistemet | Tokësor / Ujërat e ëmbla (ujërat e brendshme) |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-së | I Cënueshëm (2019) Lista e Kuqe e Maqedonisë së Veriut (VU – I Cënueshëm) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Humbja e habitateve për shkak të zgjerimit dhe shtimit të prodhimit bujqësor, rregullores për lumenjtë dhe zhvillimit pranë brigjeve • Agro-kimikateve dhe ndikimeve të tjera të ndotjes; • Urbanizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës turistike; • Koleksionimit për tregti kafshësh shtëpiake; • Introdiktimit (futjes) të llojeve të huaja (p.sh., <i>Trachemys scripta</i> në Europë; pak individë janë vëzhguar në Shkup dhe Katlanovo); • Mortaliteti në rruga |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja dhe menaxhimi i habitateve të përshtatshme; • Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe minimizimi i ndotjes së ujit dhe eutrofikimit; • Monitorimi i popullatave; • Kontrolli i konkurrencës nga llojet ekzotike të breshkave |
| Funksioni lajmëtar dhe mbrojtës | <p>I ndjeshëm ndaj zhvillimit të vijës bregore, zgjerimit bujqësor dhe i kërcënuar nga shtimi i llojeve të huaja ai vepron si një lajmëtar efektiv i cili thekson modifikimet e habitateve dhe propagandimin e llojeve invazive.</p> <p>Gjatë ciklit jetik ky lloj kërkon habitate të ndryshme dhe qasje të peizazheve të gjera për ruajtjen që klasifikojnë funksionin e tij si mbrojtës.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | Renditet në Shtojcën I dhe II të Konventës së Bernës; Renditet në Shtojcën II dhe IV të Direktivës së BE-së për Habitatet; Renditet si një lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | www.iucnredlist.org http://redlist.moep.gov.mk/ |

| | |
|--|---|
| | https://www.emys-home.de/english-european-pond-turtle.htm |
|--|---|

3.2.10.4 Shpendët

| Lloji kryesor (Shpendët): <i>Aythya ferina</i> | |
|---|---|
| Emri shkencor | <i>Aythya ferina</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Црвеноглава норка |
| Emri në gjuhën angleze | Common Pochard |
| Emri në gjuhën shqipe | Kryekuqe e mjeme |
| Ekosistemet | Tokësor, ujëra të ëmbla (=Ujëra të brendshme), ujëra të kripura |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | I Cënueshëm (VU) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Rekreacioni ujqor • Zhurma nga zhvillimi urbanistik • Shkatërrimi i habitateve së zonat e dimërimit • Shqetësimi nga gjuetia |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtje ligjore dhe menaxhim i llojeve dhe habitateve të tyre përmes legjislacionit kombëtar; • Parandalim i mortalitetit dhe shqetësimit të shkaktuar nga gjuetia, peshkimi, dhe veprimtari të tjera të njeriut; • Edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit; • Monitorimi i popullatave. |
| Funksioni mbrojtës dhe simbolik | <p>Meqenëse është i përhapur anekënd liqenit dhe folezon në brezin e kallamishteve dhe bimësinë e dendur buzë brigjeve të lumenjve, masat e ruajtjes që reduktojnë shqetësimet, rregulloret për regjimet e peshkimit dhe rekreacionit ujqor, parandalimi i mortalitetit nga gjuetia dhe ruajtja e brezit me kallamishte, do të sillnin përfitime të mëdha për taksonët e cënueshëm të ndjeshëm ndaj të njëjtave kërcënime. Veçanërisht, masat e ruajtjes do të sillnin përfitime për të gjitha llojet që përdorin Liqenin e Ohrit si zonën e tyre të Shumimit dhe mbi 25 lloje shpendësh dimërues (<i>Census of wintering water birds in Ohrid Lake region- 2020</i>).</p> <p>Me pendët që i mbuojnë të gjithë trupin dhe dimorfizmin e dukshëm gjinor, ai mund të shërbejë si një simbol për përpjekjet e edukimit mjedisor duke rritur ndërgjegjësimin kundrejt iniciativave të ruajtjes.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | Shtojca II e Direktivës së BE-së për Shpendët Renditet si një lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | www.iucnredlist.org |

| Lloji kryesor (Shpendët): <i>Phalacrocorax pygmeus</i> | |
|---|---|
| Emri shkencor | <i>Phalacrocorax pygmeus</i> (<i>Microcarbo pygmaeus</i>) |

| | |
|---------------------------------------|---|
| Emri në gjuhën maqedonase | Мал корморан |
| Emri në gjuhën angleze | Pygmy Cormorant |
| Emri në gjuhën shqipe | Karabullaku i vogël |
| Ekosistemet | Tokësore, Ujërat e ëmbla (=Ujëra të brendshme), ujëra të kripura |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | Të Paktën Shqetësues (LC) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Shqetësimi nga veprimtaritë e njeriut (varkat) • Degradimi i ligatinave • Ndryshimet në regjimet hidrologjike • Persekutimi nga industria e akuakulturës • Shkatërrimi i habitateve dhe persekutimi në shtrirjen e tij të dimërimit • Kapja e paqëllimshme në sektorin e peshkimit • Ndotja me anë të pesticideve e shkaktuar nga prurjet e tokave bujqësore |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Minimizimi i shqetësimeve nga njeriu • Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe minimizimi i ndotjes së ujit dhe eutrofikimi • Monitorimi i popullatave • Zbutja e masave për gjuetinë e paqëllimshme kur shihet e arsyeshme |
| Funksioni mbrojtës dhe lajmëtar | <p>Në Liqenin e Ohrit lloji kërkon zona të pashqetësuara në afërsi të bregut me vende për folezim dhe tharje të puçlave të ngjashme për shumë lloje shpendësh me të njëjtat nevoja. Sigurimi i zonave të pashqetësuara në zonën e mbrojtur rreptësisht do të sjellë përfitime të shumta për shumë lloje të tjera me të njëjtat kërkesa për habitate.</p> <p>Me një dietë të përqendruar kryesisht tek peshku, ai ndikon ndjeshëm në kaskadën trofike dhe industrinë e akuakulturës, dhe kërcënohet nga veprimtaritë e njeriut dhe peshkimi pa kriter, për rrjedhojë shërben si një lajmëtar i efektivitetit të peshkimit dhe rregulloreve për peshkimin dhe rekreacionin ujqor.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | <p>Shtojca II e Direktivës së BE-së për Shpendët</p> <p>Renditur si një lloj i mbrojtur rreptësisht në Maqedoninë e Veriut</p> |
| Referencat | <p>www.iucnredlist.org</p> <p>http://datazone.birdlife.org/site/factsheet/lake-ohrid-iba-north-macedonia/details</p> |

Lloji kryesor (Shpendët): *Netta rufina*

Emri shkencor *Netta rufina*

| | |
|---------------------------------------|--|
| Emri në gjuhën maqedonase | Црвеноклуна потопница превез |
| Emri në gjuhën angleze | Red-crested pochard |
| Emri në gjuhën shqipe | Zhytkryekuqja e madhe |
| Ekosistemet | Tokësor, Ujërat e ëmbla (=ujërat e brendshme) |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | Të Paktën Shqetësues (LC) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Degradimi i habitateve dhe humbja e habitateve • Shqetësimi • Gjuetia • Përkeqësimi i cilësisë së ujit në ligatina |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Regullimi i peshkimit • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Monitorimi i popullatave • Hulumtimet për dinamikën e popullatave dhe zgjedhjen e habitateve |
| Funksioni mbrojtës | Meqenëse përvetëson pjesë të liqenit të rrethuara nga kallamishte dhe ligatina të mbuluara, i ndjeshëm ndaj humbjes së habitatit dhe cilësisë së papërshtatshme të ujit, ai shërben si një lajmëtar i mirë i ndryshimit mjedisor. Rregulloret për gjuetinë dhe përpjekjet për ruajtjen që përqendrohen në brezin me kallamishte dhe mbrojtjen e ligatinave do t'u sjellin mjaft dobi këtyre llojeve si dhe një game të gjerë të taksonëve bashkekzistues. |
| Statusi i mbrojtjes | Shtojca II e Direktivës së BE-së Renditet si një lloj i mbrojtur rreptësisht në Maqedoninë e Veriut |
| Referencat | <p>www.iucnredlist.org</p> <p>https://animaldiversity.org/accounts/Netta_rufina/</p> <p>Defos du Rau P. & Perennou C. (2007): Management Plan for Red-Crested Pochard (<i>Netta rufina</i>) 2007-2009. European Commission.</p> <p>Schneider-Jacoby M. & Vasić V.F. (1989): The Red-crested Pochard <i>Netta rufina</i> breeding and wintering in Yugoslavia. Wildfowl 40.</p> |

| Lloji kryesor (Shpendët): <i>Fulica atra</i> | |
|--|---|
| Emri shkencor | <i>Fulica atra</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Лиска |
| Emri në gjuhën angleze | Common Coot |
| Emri në gjuhën shqipe | Bajza |
| Ekosistemet | Tokësor, Ujëra të ëmbla (=ujërat e brendshme), të kripura |

| | |
|---------------------------------------|--|
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | Gati i Tanguar (NT) (Pothuaj i Kërcënuar) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Shqetësimi • Ndotja • Degradimi i habitateve • Gjuetia |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Regullorja e gjuetisë • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Monitorimi i popullatave • Hulumtimi për dinamikat e popullatave dhe zgjedhjen e habitateve |
| Funksioni mbrojtës dhe lajmëtar | Meqenëse okupon një gamë të gjerë të habitateve dhe grupohet në numra të mëdhenj, pavarësisht se mbetet i ndjeshëm ndaj degradimit të habitateve, ky lloj shërben jo vetëm si lajmëtar për shëndetin e ekosistemit por edhe si lloj mbrojtës për një gamë të gjerë llojesh të tjera. |
| Statusi i mbrojtjes | Shtojca II e Direktivës së BE-së për Shpendët Renditet si lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut |
| Referencat | http://datazone.birdlife.org/site/factsheet/lake-ohrid-iba-north-macedonia/details |

| Lloji kryesor (Shpendët): <i>Mergus merganser</i> | |
|--|---|
| Emri shkencor | <i>Mergus merganser</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Голем северен потопник |
| Emri në gjuhën angleze | Goosander |
| Emri në gjuhën shqipe | Zhytraku i madh |
| Ekosistemet | Tokësore / Ujëra të Ëmbla (ujëra të brendshme) / Detare |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | Të Paktën Shqetësues (LC) (2018) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Shqetësimi nga veprimtaritë e njeriut në tokë dhe në ujë • Gjuetia • Kapja në rrjetat e peshkimit të ujërave të ëmbla |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Mbrojtje dhe menaxhim i habitateve të përshtatshme • Regullorja e gjuetisë • Monitorimi i popullatës |
| Funksioni simbol dhe lajmëtar | <p>Me pendët e tij të dallueshme, dimorfizmin e qartë gjinor dhe zakonet e shumimit në tokë, popullata e izoluar që jeton në Liqenin e Ohrit mund të shërbejë si një lloj simbol efektiv .</p> <p>Meqenëse është i ndjeshëm si ndaj gjuetisë së pa rregulluar ashtu edhe peshkimit pa kriter, ai do të ofronte një masë të mirë për efektivitetin e regjimeve dhe rregulloreve të përmirësuara të gjuetisë dhe peshkimit.</p> |

| | |
|---------------------|--|
| Statusi i Mbrojtjes | Shtojca II e Direktivës së BE-së për Shpendët |
| Referencat | www.iucnredlist.org Catsadorakis G., Avramoski O., Bojadzi A. & Nikolaou H. (2016): The status of an isolated population of Goosander Mergus merganser in the Balkans. Wildfowl. |

3.2.10.5 Gjitarët

| Lloji kryesor (Gjitarët): <i>Lutra lutra</i> | |
|--|---|
| Emri shkencor | <i>Lutra lutra</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Видра |
| Emri në gjuhën angleze | Eurasian otter |
| Emri në gjuhën shqipe | Lundërza |
| Ekosistemet | Tokësore / Ujërat e Ëmbla (ujërat e brendshme)/ ujëra të kripura |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | Gati i Tanguar (2007) (NT) (Pothuaj i Kërcënuar) Lista e Kuqe e Maqedonisë së Veriut (VU – i Cënueshëm) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> Gjuetia e paligjshme është një problem në shumë pjesë të harkut të shtrirjes së tyre. Në vende të shumta europiane trysnia politike veçanërisht e peshkatarëve ka rezultuar në dhënien e licencave për vrasjen e lundërzave; Ndryshimet e kryera nga njeriu në habitatet ujore: shndërrimi i lumenjve në kanale lundruese, tharja e ligatinave, veprimtaritë e akuakulturës dhe ndikimet përkatëse të shkaktuara nga njerëzit në sistemet ujore; Ndotja është një kërcënim kryesor për lundërzat: pesticidet dhe plehrat kimike nga bujqësia, ujërat e zeza dhe zhiva e metaleve të rënda; Rrjetat e peshkimit |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> Minimizimi i shqetësimeve nga njerëzit Krijimi i lidhshmërisë së habitateve (krijimi i shtigjeve poshtë strukturave të urave për t'u dhënë lundërzave mundësinë të kalojnë) Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe minimizimi i ndotjes së ujit dhe eutrofikimi Ndalimi i rrjetave të peshkimit në habitatet natyrore të këtij lloji Monitorimi i popullatave |
| Funksioni mbrojtës, simbol dhe lajmëtar | Meqenëse jetojnë në zona bregore, masat e ruajtjes të cilat synojnë ruajtjen e territoreve ekologjike të këtij lloji do të rezultojnë në kushte të përmirësuara për shumë lloje bashkekzistuese. Meqenëse shfaq tolerancë të ulët ndaj faktorëve të ndotjes, ky lloj shërben si një lajmëtar i mirë i cilësisë së ujit. |

| | |
|---------------------|--|
| | <p>Si një lloj i njohur dhe karizmatik si nga niveli kombëtar ashtu edhe ai ndërkombëtar, ai luan një rol simbolik në nxitjen e sensibilizimit dhe mbështetjes kundrejt masave të dedikuara të ruajtjes.</p> <p>Brenda shtrirjes së tij të madhe ai kërkon zona të gjera me habitate të pashqetësuar dhe është veçanërisht i ndjeshëm ndaj zhvillimit infrastrukturor.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | <p>Lundërza i përket mbrojtjes së rreptë në bazë të legjislacionit dhe konventave. Ajo renditet në Shtojcën I të CITES, Shtojcën II të Konventës së Bernës, dhe Shtojcave II dhe IV të Direktivave të BE-së për Habitatet dhe Llojet.</p> <p>Renditet si lloj i mbrojtur rreptësisht në Maqedoninë e Veriut.</p> |
| Referencat | <p>www.iucnredlist.org</p> <p>https://www.wasser-otter-mensch.de/</p> |

3.2.10.6 Insektet

| Lloji kryesor (Insektet): <i>Brachytron pratense</i> | |
|--|--|
| Emri shkencor | <i>Brachytron pratense</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | |
| Emri në gjuhën angleze | Hairy Hawker / Hairy dragonfly |
| Emri në gjuhën shqipe | |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | <p>Të Paktën Shqetësues (LC) në Europë</p> <p>Të Paktën Shqetësues në bazë të Listës së Kuqe të pilivesave të Mesdheut</p> |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Eutrofikimi • Degradimi dhe shkatërrimi i bimësisë ujore dhe buzë lumore • Humbja e habitateve të përshtatshme • Modifikimi dhe fragmentimi i habitateve • Tharja e ligatinave • Ndryshimet e niveleve ujore • Menaxhim i pamjaftueshëm i ujërave |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Mbrojtja dhe menaxhimi i habitateve të përshtatshme • Monitorimi i popullatës • Monitorimi i habitateve |
| Funksioni mbrojtës dhe lajmëtar | <p>Megenëse okupon bimësinë anës brigjeve, përpjekjet për ruajtjen kundrejt mbrojtjes së brezit me kallamishte do t'i sjellin dobi një game të gjerë të llojeve bashkekzistuese. Mbi 30 lloje të pilivesave të pranishme në liqen dhe përreth tij do të kishin përfitim nga masat efektive në zbatim të ruajtjes së këtij lloji kryesor.</p> <p>Për më tepër, ky lloj shërben si një lamëtar i mirë për strukturën e zonës së kallamishteve dhe për procesin e eutrofikimit.</p> |

| | |
|---------------------|---|
| Statusi i mbrojtjes | |
| Referencat | https://www.iucnredlist.org |

3.2.10.7 Bivalvia

| Lloji kryesor (Bivalvia): <i>Pisidium edlaueri</i> | |
|---|--|
| Emri shkencor | <i>Pisidium edlaueri</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | |
| Emri në gjuhën angleze | |
| Emri në gjuhën shqipe | |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | I rrezikuar (2009) (EN) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e ngarkesës së sedimenteve (për shkak të ndërtimit të vendbanimeve të reja, shpyllëzimit dhe erozionit të zonave fqinje) ndikon për këtë molusk të vogël dhe për aftësinë e tij për të filtruar ujin; • Eutrofikimi i liqenit për shkak të ndotjes bujqësore rezulton në rritjen e makrofiteve, të cilat mbulojnë shtresën e butë dhe zvogëlojnë praninë e oksigjenit brenda shtresës (anoksik). |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe minimizimi i ndotjes së ujit dhe eutrofikimit • Monitorimi i popullatës |
| Funksioni lajmëtar dhe mbrojtës | Endemik për Liqenin e Ohrit dhe zë një sipërfaqe të veçantë duke përjetuar rënien e cilësisë së habitatit, ky lloj shërben si një lajmëtar i mirë për eutrofikimin dhe rritjen e makrofiteve. Masat e ruajtjes që synojnë përmirësimin e pranisë së oksigjenit në ujëra të thella do të jenë gjithashtu në dobi të llojeve të tjera bentike që jetojnë në të njëjtën zonë. |
| Statusi i mbrojtjes | Renditet si një lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | <p>https://www.iucnredlist.org/</p> <p>Kuiper J.G.J. (1960). Zoological results of a collecting journey to Yugoslavia, 1954. 6: Die Pisidien des Ochridsees, Mazedonien, nebst Bemerkungen über die Verbreitung der Pisidien in der Balkanhalbinsel und den Donauländern. Beaufortia. 88(7): 219-231. http://www.repository.naturalis.nl/document/548696</p> <p>Schultheiß, R., Albrecht, C., Bçßneck, U. et al. (2008): The neglected side of speciation in ancient lakes: phylogeography of an inconspicuous mollusc taxon in lakes Ohrid and Prespa. Hydrobiologia 615, 141–156 (2008). https://doi.org/10.1007/s10750-008-9553-3</p> |

3.2.10.8 Gastropoda

| Lloji kryesor (Gastropoda): <i>Gocea ohridana</i> | |
|---|--|
| Emri shkencor | <i>Gocea ohridana</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Охридски воден полжав |
| Emri në gjuhën angleze | |
| Emri në gjuhën shqipe | |
| Ekosistemet | Tokësor / Ujërat e ëmbla (ujërat e brendshme) |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | I Rrezikuar në Mënyrë Kritike (2010) (CR) |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesa e sedimenteve, ndikon këtë gastropod të vogël, duke zbehur aftësinë e tij për të filtruar ujin. • Ndotja nga ujërat e zeza të qyteteve të mëdha pranë liqenit po kontaminon ujin e liqenit. • Bujqësia pranë Liqenit të Prespës po kontaminon ujërat e tij, të cilat më tej futen në Liqenin e Ohrit, duke shkarkuar aty ngarkesë të madhe të lëndëve ushqyese. |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe minimizimi i ndotjes dhe eutrofikimit të ujit • Monitorimi i popullatës • Monitorimi i cilësisë së ujit |
| Funksioni mbrojtësdhe lajmëtar | <p>Meqenëse okupon një zonë mjaft të kufizuar të liqenit brenda një pjese të ndjeshme të zonës litorale, masat e veçanta të ruajtjes që adresojnë ndotjen e ujit dhe grumbullimin e llumit do të sjellin dobi edhe për taksonët e tjerë bashkëekzistues. Masat të cilat adresojnë këto lloje të kërcënimeve do të jenë gjithashtu të dobishme edhe për më shumë se 40 lloje butakësh.</p> <p>I ndjeshëm ndaj erozionit bregor dhe trajtimit të pamjaftueshëm të ujërave të ndotura, ai shërben si një lajmëtar i mirë i cilësisë së ujit dhe degradimit të bregut.</p> |
| Statusi i mbrojtjes | Renditet si një lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | <p>www.iucnredlist.org</p> <p>http://www.animalbase.uni-goettingen.de/</p> <p>Smiljkov S., Budzakoska-Gjoreska B., Sapkarev J. & Trajanovski S. (2007): Dominant Species of the Gastropod Fauna from the Littoral Region in Lake Ohrid of R. Macedonia. Contributions, Sec. Biol. Med. Sci., MASA, XXVIII.</p> |

3.2.10.9 Sfungjerët

Sfungjerët janë kafshë shumëqelizore, trupat e të cilëve përmbajnë pore dhe kanale përmes të cilave qarkullon uji. Sfungjerëve u mungon sistemi qendror nervor, aparati i tjetjes dhe i

qarkullimit të gjakut. Në vend të tyre, pjesa më e madhe mbështeten në kalimin e vazhdueshëm të ujit nëpër trupin e tyre për të marrë ushqim dhe oksigjen, dhe për të shkarkuar mbetjet.

Talevski et al. (2020) e përshkruan sfungjerin e ujërave të ëmbla *Ochridaspongia rotunda* i cili, së bashku me *O. interlithonis* and *Spongilla stancovichii*, përbën faunën unike porifere të Liqenit të lashtë të Ohrit.

Njohuritë dhe literatura për sfungjerët në Liqenin e Ohrit janë të pakëta. Për rrjedhojë, rekomandohet fuqimisht të kryhen studime të veçanta, të përpilohen inventarë dhe të kryhen monitorime, dhe nëse është e nevojshme të zbatohen masa të veçanta për ruajtjen e tyre.

3.2.10.10 Bimët

| Lloji kryesor (Apiaceae): <i>Angelica palustris</i> | |
|---|--|
| Emri shkencor | <i>Angelica palustris</i> |
| Emri në gjuhën maqedonase | Барска Ангелика |
| Emri në gjuhën angleze | Marsh Angelica |
| Emri në gjuhën shqipe | |
| Ekosistemet | Kullota, Ligatina (të brendshme) |
| Vlerësimi i Listës së Kuqe të IUCN-it | I rrezikuar në Mënyrë Kritike (CR) – Lista e Kuqe e Maqedonisë së Veriut |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes • Mbrojtja dhe menaxhimi i habitateve të përshtatshme • Monitorimi i habitateve • Monitorimi i popullatës |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtje e rreptë përmes zonimit |
| Funksioni mbrojtës | Meqenëse kufizohet në një zonë pranë burimeve të lumit Drini i Zi në lokalitetin e Shën Naumit dhe meqenëse është i ndjeshëm ndaj veprimtarive të njeriut të tilla si urbanizimi dhe ndryshimi i rrjedhave ujore, ky lloj shërben si një lajmëtar lokalizues i shëndetit të habitateve të veçanta. |
| Statusi i mbrojtjes | Renditet në Shtojcën II të Direktivës së BE-së për Habitatet Renditet si një lloj i mbrojtur në Maqedoninë e Veriut. |
| Referencat | http://redlist.moepp.gov.mk/marsh-angelica/ |

3.2.11 Brezat e kallamishteve (Habitati Kryesor)

| Habitati kryesor: <i>Brezat e kallamishteve</i> | |
|---|----------------|
| Emri në gjuhën maqedonase | Појас на трска |
| Emri në gjuhën angleze | Reed belt |


| | |
|-----------------------|---|
| Emri në gjuhën shqipe | Brezat me kallamishte |
| Ekosistemet | Ujërat e ëmbla |
| | Brezat me kallamishte janë habitate të rëndësishëm për shumë grupe taksonomike, duke përfshirë shpendët të cilët i përdorin ato për foljezim, ushqim, cicërrima, fjetje, ndërrim të puplave, fshehje ose pushim (Ostendorp W. (1993): Schilf als Lebensraum). |
| Vlerësimi | <p>Brezat e kallamishteve në Liqenin e Ohrit kanë pësuar shkatërrime të vazhdueshme në dekadat e fundit. Arsyet përfshijnë veprimtaritë turistike (përdorimi i plazheve) dhe ndërtimin, djegjen dhe shndërrimin në tokë bujqësore.</p> <p>Talevska & Talevski (2012) analizuan situatën e brezave të kallamishteve në vitin 2011 dhe e krahasuan atë me një studim të vitit 1986. Autorët treguan se numri total i komplekseve të kallamishteve në vitin 2011 ishte më i vogël se (80) në vitin 1985 (105). Në të njëjtën kohë, analiza del në përfundimin se sipërfaqja totale e brezit të kallamishteve është rritur me 2.8 ha, deri në 77.15 ha në vitin 2011.</p> |
| Kërcënimet | <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet në nivelin e ujit • Ndërtimet • Shqetësimet nga përdorimi i plazheve nga njerëzit • Tharja dhe shndërrimi në tokë bujqësore • Hedhja e mbetjeve • Djegia |
| Masat e ruajtjes | <ul style="list-style-type: none"> • Zonimi dhe mbrojtja e rreptë • Monitorimi |
| Statusi i mbrojtjes | <p>Direktiva e BE-së për Habitatet Shtojca I: 3140 Ujërat minerale oligomezotrofike me bimësi bentike të Chara spp.</p> <p>Direktiva e BE-së për Habitatet Shtojca I: 7230 kënetat alkaline</p> |
| Referencat | <p>Arge Naturschutz (2014): Lebensraum Schilf. Land Salzburg, Abteilung 13 – Naturschutz.</p> <p>Holsten B., Schoenberg W. & Jensen K. (2011): Schutz und Entwicklung aquatischer Schilfröhrichte. Ein Leitfaden für die Praxis. Landesamt für Landwirtschaft, Umwelt und ländliche Räume des Landes Schleswig-Holstein.</p> <p>Ostendorp W. (1993): Schilf als Lebensraum.</p> <p>Plan for the management of the reed belt in Lake Ohrid (2019). Financed by EU and UNDP.</p> <p>Talevska M. (2008): Distribution of Some Representatives of Emergent Vegetation in Lake Ohrid. BALWOIS.</p> <p>Talevska M. (2009): Преглед На Акватичните Васкуларни Макрофити Вдолж Северозападниот и Северниот Литорал од Охридското Езеро.</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>Talevska M. & Talevski T. (2012): Registration of the reed belt as a basis for further monitoring of the situation in Lake Ohrid, and in order to determine the strategy for its protection.</p> <p>Talevska M. & Talevski T. (2015): Qualitative Composition of Macrophyte Vegetation and Cyprinid Fauna from Lake Ohrid. Bulgarian Journal of Agricultural Science, 21.</p> <p>Talevska M., Petrovic D., Milosevic D., Talevski T., Maric D. & Talevska A. (2009): Biodiversity of Macrophyte Vegetation from Lake Prespa, Lake Ohrid and Lake Skadar, Biotechnology & Biotechnological Equipment, 23.</p> |
|--|---|

3.2.12 Zonat e Rëndësishme të Biodiversitetit

Nëntë territore në Liqenin e Ohrit janë identifikuar si zona të rëndësishme të biodiversitetit (burimi: Plani i Menaxhimit të UNESCO-s i vitit 2020):

1. Manastiri i Shën Mërisë, Kalishtë: Burimet sublakustrine;
2. Kalishtë: Habitat i vetëm me zambakun e verdhë të ujit (*Nuphar lutea*) në Liqenin e Ohrit;
3. Podmolje: zona më e madhe me kallamishte (kryesisht *Phragmites australis*) në Liqenin e Ohrit; habitat natyror i llojeve të kërcënuara të shpendëve dhe zona e shumimit të krapit;
4. Mazija: Habitat natyror i rijetëzuar i zambakut të verdhë të ujit (*Nuphar lutea*), zona e shumimit të krapit, habitat dhe vend për folezim të shpendëve;
5. Ligatina Studençishko: Bimësia makrofite dhe zona e shumimit të peshqve;
6. Veli-Dabi: Burimet sublakustrine, zonat e kultivimit të troftës, biodiversiteti i lartë i florës bentike;
7. Velja-Pes: burimet sublakustrine, zonat e kultivimit të troftës, biodiversiteti i lartë i florës bentike ;
8. Sveti Zaum (Shën Zaum): Burimet bregore dhe sublakustrine, zonat e kultivimit të troftës, biodiversiteti i lartë i faunës bentike
9. Sveti Naum (Shën Naumi): burime me kapacitet të lartë në Liqenin e Ohrit, zonat e kultivimit të troftës, biodiversiteti i lartë i faunës bentike



3.3 Karakteristikat Socio-ekonomike

3.3.1 Komunitetet dhe Popullsia Lokale


Bazuar në Ligjin për Organizimin Territorial të Vetadministrimit Lokal në Republikën e Maqedonisë (2004), bregu i Liqenit të Ohrit ndahet nga komunat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës.

Komuna e Ohrit ka shtrirje territoriale prej 203km² dhe përmban 29 vendbanime. Ajo ka një vijë bregore me shtrirje 35km, duke mbuluar pjesën më të madhe të bregut lindor të Liqenit të Ohrit.

Komuna e Strugës ka shtrirje territoriale prej 483km² dhe 51 vendbanime. Ajo mbulon pjesën më të madhe të vijës bregore në veri dhe veri-perëndim të liqenit, me një shtrirje prej 15.5km.

Komuna e Debërcës ka shtrirje territoriale prej 424km² me 30 vendbanime dhe mbulon një pjesë të vogël të vijës bregore veriore të liqenit, me një shtrirje prej 1.3km.

Në bazë të regjistrit kombëtar të vitit 2002, këto komuna përmbajnë një numër të përgjithshëm prej 124631 banorësh, 6.16% e popullsisë së përgjithshme të vendit. Meqenëse janë qendra ekonomike dhe turistike, pjesa më e madhe e banorëve janë përqendruar kryesisht në Komunën e Ohrit ose në atë të Strugës. Struktura e popullsisë në këto komuna është e ndryshme në lidhje me gjininë, moshën, përkatësinë etnike, formimin arsimor, shkollimin, dhe profesionin.



Në bazë të regjistrimit kombëtar të vitit 2002, shumica e banorëve në Ohër janë maqedonas, të ndjekur nga një numër i lartë i pakicave shqiptare dhe turke. Në Strugë, shumica e banorëve janë shqiptarë, të ndjekur nga pakica maqedonase dhe turke. Debërca nga ana tjetër, banohet tërësisht nga maqedonas.


Lindshmëria dhe vdekshmëria ka qënë e vazhdueshme gjatë 15 viteve të fundit. Shkalla e lindjeve në këto tre komuna është ulur gjatë tre viteve të fundit, ndërsa shkalla e vdekjeve është rritur. Gjatë dekadave të fundit, në Komunitat e Ohrit dhe Debërcës, shkalla e vdekjeve ka tejkaluar gradualisht shkallën e lindjeve. Meqenëse këto komuna kanë në përbërje migrimin dhe plakjen e popullsisë, gjatë dy dekadave të para të shekullit 21 vërehet një prirje në uljen e popullsisë.

Regjistrimi kombëtar i vitit 2002 është i fundit i kryer në Republikën e Maqedonisë, për rrjedhojë të gjithë të dhënat në lidhje me popullsinë janë aktualisht të papërditësuara. Regjistrimi i ardhshëm pritet të kryhet në shtator të vitit 2021.

3.3.2 Përdorimi i Tokës

3.3.2.1 Vështrim i përgjithshëm

Paraqitja e Hollësishme nga FAO e Mbulimit me Tokë për Maqedoninë e Veriut (2019) u analizua duke përdorur GIS në mënyrë që të vlerësohet përdorimi i tokës pranë liqenit. Përdorimi i tokës brenda 1km të vijës bregore është si vijon:



| Klasa e përdorimit të tokës | Kategoria e përdorimit të tokës | Sipërfaqja (ha) |
|-----------------------------|---|-----------------|
| Urbane / infrastrukturore | Zonat urbane | 345.3 |
| Urbane / infrastrukturore | Vendbanimet rurale | 699.5 |
| Urbane / infrastrukturore | Njësitë industriale ose tregtare | 3.6 |
| Urbane / infrastrukturore | Rrugët | 4.2 |
| Urbane / infrastrukturore | Aeroporti | 12.3 |
| Bujqësore | Kulturat që nuk ujiten | 889.1 |
| Bujqësore | Kultura bujqësore që ujiten vazhdimisht | 243.3 |
| Bujqësore | Drurët frutorë | 137.7 |
| Bujqësore | Bimësi bujqësore/natyrore e përzier | 867.6 |
| Pyjore dhe të tjera | Drurë halorë | 1540.4 |
| Pyjore dhe të tjera | Drurë të përzierë | 95.6 |
| Pyjore dhe të tjera | Barishtore – natyrore | 109.6 |
| Pyjore dhe të tjera | Toka pyjore | 128.3 |
| Pyjore dhe të tjera | Drurë të shpërndarë | 323.6 |
| Vija bregore | Plazhe | 13.4 |
| Vija bregore | Toka të zhveshura | 7 |
| Vija bregore | Ligatina | 56.6 |
| Vija bregore | Lumenj | 0.8 |

3.3.2.2 Bujqësia dhe Pylltaria

Në tre komonat, sipërfaqja e përgjithshme bujqësore në vitin 2019 (SPB) ishte 64,288 hektarë, nga të cilët 27,301 ishin toka të mbjella (toka të punueshme) ndërsa 36,985 hektarë ishin kullota, duke mbizotëruar kryesisht në Komonat e Ohrit dhe Strugës. Shumica e këtyre janë në zona malore, që në këtë rast përfshijnë Parkun Kombëtar të Galiçicës.

Kopshtet dhe fushat së bashku përbëjnë llojin mbizotërues të sipërfaqes bujqësore, ndërsa pemët frutore dhe vreshtat së bashku përbëjnë afërsisht 6% të sipërfaqes së mbjellë, në bazë të të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore brenda këtyre komunave është e pozicionuar në një distancë të konsiderueshme nga bregu i liqenit. Komuna e Debërcës në veçanti, ka akses ndaj një pjese të vogël të bregut të liqenit.

| Viti | Sipërfaqe Bujqësore | | Tokë e kultivuar | | Tokë e punueshme dhe kopshte | | Pemë frutore | | Vreshta | | Livadhe | | Kullota | |
|----------------|---------------------|-------|------------------|-------|------------------------------|-------|--------------|------|---------|------|---------|------|---------|-------|
| | 2014 | 2019 | 2014 | 2019 | 2014 | 2019 | 2014 | 2019 | 2014 | 2019 | 2014 | 2019 | 2014 | 2019 |
| Debërca | 13281 | 13287 | 10521 | 10527 | 9362 | 9368 | 272 | 272 | 137 | 138 | 750 | 749 | 2760 | 2760 |
| Ohri | 27847 | 27890 | 6483 | 6556 | 5850 | 5873 | 291 | 331 | 232 | 225 | 110 | 127 | 21364 | 21334 |
| Struga | 23114 | 23111 | 10221 | 10218 | 8254 | 8248 | 484 | 487 | 103 | 103 | 1380 | 1380 | 12891 | 12891 |
| Totali | 64242 | 64288 | 27225 | 27301 | 23466 | 23489 | 1047 | 1090 | 472 | 466 | 2240 | 2256 | 37015 | 36985 |

3.3.2.3 Peshkimi

Rajonet e peshkimit në Liqenin e Ohrit janë pjesë e legjislacionit që përcakton karakteristikat kryesore hidrografike, klimatike, fizike dhe biologjike, karakteristikat dhe vetitë kimike, biomasën planktonike, si dhe ihtiomasën (peshqit) e Liqenit të Ohrit. Ai gjithashtu përbën kuadrin ligjor për peshkimin ekonomik dhe rekreativ, duke përfshirë:

- Llojet që mund të peshkohen;
- Sezoni e hapjes çdo vit kur lejohet peshkimi ekonomik dhe rekreativ;
- madhësinë e individëve që mund të peshkohen ligjërisht;
- metodat e lejuara të peshkimit.

Shembull i rregulloreve në rajonet e peshkimit:

| Lloji i peshkut | Sezoni i lejuar i peshkimit |
|--|--|
| Korani | Nga 1 Prill deri më 31 Tetor |
| Belushka | Nga 1 Prill deri më 19 Dhjetor |
| Krapi | Nga 20 Qershor deri më 19 Maj të vitit tjetër |
| Mrena e Fanit | Nga 20 Qershor deri më 19 Maj të vitit tjetër |
| Mlyshi/Kleni (<i>Squalius squalus</i>) | Nga 1 Qershor deri më 30 Prill të vitit tjetër |
| Bravica/Dranga/Gërmuqi (<i>Scardinius knezevici</i>) | Nga 1 Qershor deri më 30 Prill të vitit tjetër |
| Njila (<i>Chondostroma nasus</i>) | Nga 16 Maj deri më 14 Prill të vitit tjetër |

Të drejtat dhe detyrimet koncesionare në lidhje me peshkimin dhe akuakulturën rregullohen me anë të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 07/08, 67/10, 47/11, 53/11, 95/12, 164/13). Ligji përcakton rregullat dhe detyrimet për peshkimin ekonomik dhe rekreativ në vend. Nenet 25 deri 33 përcaktojnë rregullat në bazë të të cilave peshkataria dhe rajonet e peshkimit ofrohen në bazë koncesioni për peshkimin ekonomik dhe rekreativ. Ai lejon që entitetet e brendshme dhe të huaja ligjore t'i nënshtrohen

tenderimit për të drejtat koncesionare për të menaxhuar peshkimin në zonat e përcaktuara të peshkimit.

Koncesionari ka të drejtën të kryejë peshkimin dhe shfrytëzimin e zonës ashtu siç përcaktohet brenda ‘rajoneve të peshkimit’ (РИБОЛОВНА ОСНОВА ЗА РИБОЛОВНА ВОДА „ОХРИДСКО ЕЗЕРО“ ЗА ПЕРИОД 2017-2022 ГОДИНА – Rajonet e Peshkimit për Peshkatarinë e Liqenit të Ohrit për Periudhën 2017-2022) të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në bazë të Nenit 16 të Ligjit për Peshkatarinë dhe Akuakulturën Agriculture.

Koncesionari është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e madhësive të gjuetisë së peshkut për arsye ekonomike dhe rekreative dhe raportimin e tyre ndaj ministrisë përkatëse. Për më tepër, koncesionari mund të nxjerrë licensat e peshkimit rekreativ dhe është i detyruar të mbikëqyrë peshkimin rekreativ dhe të mbledhë të dhënat për kapjen e peshkut nga të gjitha licensat. Përveç shfrytëzimit ekonomik, koncesionari është i detyruar të mirëmbajë fondin e peshkimit dhe statusin e liqenit brenda kufijve për shfrytëzimin, dhe të krijojë në mënyrë periodike rezerva të tjera.

Rajonet aktuale të peshkimit për Liqenin e Ohrit u përcaktuan në vitin 2017 (“Gazeta Zyrtare e RM” Nr. 55/17) dhe u ndryshuan në vitin 2018 (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 80/18).

Liqeni i Ohrit nuk ka aktualisht një koncesionar. Koncesioni i fundit iu dha “Letnica – Belvica Milorad DOOEL uvoz izvov Struga” në gusht të vitit 2019. Megjithatë, përmes një vendimi të qeverisë (44-370/1 of 21.01.2020) kontrata për të drejtat koncesionare u ndërpre për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale. Si rrjedhojë, asnjë lloj peshkimi ekonomik apo rekreativ, nuk lejohet në rajonet e peshkimit të Liqenit të Ohrit derisa të lidhet një kontratë e re koncesionare. I vetmi përjashtim është peshkimi ekonomik i ngjalës i cili kryhet ndërmjet ‘HEC Globoçica’ dhe ‘Divljak Struga’.

Më 2 dhjetor të vitit 2020, Marrëveshja për Menaxhimin e Përbashkët të Peshkatarisë së Qëndrueshme në Liqenet e Ohrit dhe të Prespës u nënshkruan ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Maqedonisë së Veriut. Me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të dyja palët angazhohen për përdorimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e rezervave të peshkut, si dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm dhe kontrabandës. Marrëveshja parashikon krijimin e një komiteti të përbashkët për peshkimin në Liqenet e Ohrit dhe Prespës. Ky komitet do të zhvillojë bashkëpunimin kufitar në sektorin e peshkatarisë dhe do të përgatisë rekomandimet për të drejtuar harmonizimin e rregulloreve të menaxhimit të peshkatarisë.

3.3.3 Infrastruktura dhe Zhvillimi

Ministria e Transportit & Lidhjeve dhe Komunitet e Ohrit, Strugës dhe Debërcës mbikëqyrin menaxhimin e rrugëve, hekurudhave, energjisë, ujit dhe infrastrukturën e telekomunikacionit.

3.3.3.1 Infrastruktura e transportit

Në lidhje me infrastrukturën, transporti rrugor është forma më e rëndësishme e transportit në Maqedoninë e Veriut. Liqeni i Ohrit është i arritshëm përmes rrjetit publik rrugor, pavarësisht se nuk ka rrugë automobilistike apo autostrada për në liqen ose në asnjë prej komunave në bregun e tij.

Komunat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës lidhen me pjesën tjetërtë vendit përmes rrugëve A-2, R-1301, R-2240, R-2241, R-1201 dhe R-29273. Komuna e Ohrit gjithashtu është qendra e një prej dy aeroporteve ndërkombëtare të vendit.

Ndërtimi i një autostrade të re rajonale prej 57 km ndërmjet qyteteve të Kërçovës dhe Ohrit filloi në vitin 2013. Projekti ka hasur probleme të mëdha dhe aktualisht është duke përparuar. Kjo rrugë supozohet të përmirësohet lidhshmërinë ndërmjet Ohrit dhe Kërçovës, dhe pjesës tjetër të vendit.

Brenda kufijve të trashëgimisë 'natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit', ndërtimi i infrastrukturës së mëposhtme është planifikuar:

- Linja hekurudhore Kërçovë – Lin (kufiri me Republikën e Shqipërisë);
- Autostrada A2, segmenti Trebenishtë-Strugë;
- Sistemin Kombëtar të gazsjellësit, segmenti Ohër- Strugë.

Pavarësisht se infrastruktura është e rëndësishme së madhe për rajonin, ajo ka potencialin, në varësi të mënyrës në të cilën ajo ndërtohet dhe mirëmbahet, të ketë ndikime negative për vlerat universale.

3.3.3.2 Energjia elektrike

AD Elektrani na Makedonija gjeneron energjinë elektrike duke shfrytëzuar ndryshimin e lartësive të Liqenit të Ohrit (minimumi 693.10 m, maksimumi 693.75 m), përmes kontrollit të daljes nga shtrati të Lumit Drini i Zi.

Një lidhje ndërmjet dy linjave ajrore të transmisionit, SS Bitola 2 – kufiri maqedonas –shqiptar (400 kV) dhe SS Ohrid (400/110 kV), është në proces e sipër, duke përfshirë ndërtimin e planifikuar të një nënstacioni të ri 400/110 kV në rajonin Ohër-Strugë e cila do të zgjidhë problemet në pjesën jug-perëndimore të rrjetit. Për këtë qëllim, është përfunduar një plan veprimi mjedisor dhe social dhe një vlerësim për ndikimin në mjedis të projektit, duke përfshirë shpendët dhe lakuriqët e natës.

3.3.3.3 Furnizimi me ujë

Liqeni i Ohrit përfshin terren të thepisur malor si dhe dy liqenet të cilat përbëjnë Liqenin e Prespës, të pozicionuar rreth 150 m më lart se Liqeni i Ohrit. Për shkak të peizazhit karstik, uji nga Liqeni i Prespës kontribuon ndjeshëm në burime të shumta përgjatë brigjeve të Liqenit të Ohrit. Sipërfaqja efektive e ujëmbledhësit të Liqenit të Ohrit shtrihet në atë të Liqenit të Prespës dhe mund të tejkalojë 2,000 km².

Degët e Liqenit të Ohrit janë kryesisht rrëke dhe lumenj sezonalë të cilët rrjedhin gjatë periudhave të rreshjeve të dendura dhe shkrirjes së dëborës.

Liqeni ka një dalje, Lumin Drini i Zi i cili derdhet në Detin Adriatik. Kjo dalje kontrollohet artificialisht, dhe në rrjedhën e tij të poshtme gjenden mjaft penda dhe stacione hidrocentralesh. Uji nga liqeni dhe degët e tij përdoret për ujitje dhe furnizim me ujë të pijshëm.

3.3.3.4 Ujërat e zeza dhe kanalizimet

Pjesa më e rëndësishme e infrastrukturës së Liqenit të Ohrit është sistemi kryesor i kolektorëve, krijuar për të mbrojtur trupat ujorë nga ndotja dhe eutrofikimi. Ai mbedh ujërat

e ndotur nga komunat fqinje dhe i trajton ato përmes sistemit të kanalizimeve dhe impjanteve të trajtimit. Ujërat e ndotura të grumbulluara përmes 18 stacioneve të pompimit dhe kolektorëve kryesorë prej 41km transportohen në impjantet e trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Vranishtë, ku trajtohen mekanikisht dhe biologjikisht. Në vitet e fundit, kushtet teknologjike të objekteve dhe pajisjeve kanë arritur në një pikë kritike. Megjithatë, në vitet 2018 dhe 2019, janë realizuar ndërhyrje të rëndësishme për të riparuar pajisjet në stacionet e pompimit dhe në stacionin e Vranishtës, në të cilin janë të ndaluara ndërprerjet e punës së sistemit.

Pavarësisht se më parë sistemi i kolektorëve i takonte Ndërrmarjes Publike “Proakva”, në nëntor të vitit 2019 ai i kaloi një subjekti të ri juridik (ndërrmarrje publike) “NP e Sistemit të Kolektorëve – Shkup”.

Sistemi i kolektorëve balancon kolektorin kryesor (linjën e tubave), stacionet e pompimit dhe një stacion urbanistik të trajtimit të ujërave të ndotura. Kolektori kryesor merr ujën nga sistemi i kanalizimeve të rajonit dhe e pompon atë në impjantin e trajtimit në Vranishtë, përgjatë një distance prej 41km. Në segmentet me rrjedhje gravitacionale, tubat kanë diametër prej 300 deri në 1200 mm. Në segmentet me rrjedhje me presion, diametri i tubave është nga 150 deri në 200mm.

Në anën lindore të kolektorit të dytë, stacionet e pompimit janë si vijon: SP Krusha, SP Eleshec, SP Metropol, SP Granit, SP Orce Nikolov, SP Ohër 1, SP Ohër 2, SP Daljan, SP Podmolje, SP Sateskë. Kolektori perëndimor përbëhet: SP Elen Kamen, SP Kalishtë, SP Zona e Shërbimit. SP Struga 3 dhe SP Vranishtë janë të pozicionuara në kolektorin kryesor.

35% e ujërave të zeza të prodhuara në komunat e Ohrit dhe të Strugës nuk trajtohen, me mbulimin e sistemit për zonat rurale kryesisht të ulët. Ujërat e zeza të patrajtuara zakonisht shkarkohen në liqen.

3.3.3.5 Mbetjet e ngurta

Zhvillimi në rritje i vijës bregore, duke përfshirë objekte të ndërtuara në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme, ka rritur trysnitë e njeriut në rajon, veçanërisht në liqen. Kjo lidhet me sasi të rritje të ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta, ku të dyja nuk mbledhen dhe trajtohen siç duhet.

Pikat e grumbullimit (landfillet), të tilla si Bukovo/Koselska ose Tushemishti, nuk përmbushin standardet moderne të mjedisit. Shkarkimet e parregulluara dhe të paligjshme të mbetjeve shfaqen gjithashtu në shumë vende. Mbetje të tilla si gomat dhe pajisjet elektro-shtëpiake hidhen në liqen, të grumbulluara me vite aty dhe duke dëmtuar mjedisin.

Shkarkimi dhe trajtimi i duhur i mbetjeve të ngurta është një prioritet i lartë. Duhet të ndërmerren fushata për rritjen e ndërgjegjësimit për të informuar banorët lokalë për çështjet e mbetjeve të ngurta dhe shkarkimin e duhur të tyre. Kjo duhet të shoqërohet me anë të monitorimit të vazhdueshëm dhe zbatimit të ligjeve përkatëse (duke përfshirë edhe gjoba) nga inspektorati mjedisor.

3.3.3.6 Infrastruktura Sociale

Infrastruktura sociale mund të përkufizohet si qendrat ose objektet të cilat mbështesin shërbimet sociale. Llojet e infrastrukturës sociale përfshijnë kujdesin shëndetësor (spitalet),

arsimin (shkollat dhe universitetet), mjetet dhe transportin publik (hekurudhat dhe rrugët) etj.

Komuna e Ohrit ka gjashtë organizata të shëndetit publik: një qendër shëndetësore, një spital të përgjithshëm, një qendër mjekësore parandaluese, një spital të ortopedisë dhe traumës, një spital fëmijësh, dhe një institut për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve kardiovaskulare. Komuna e Strugës ka një spital të përgjithshëm. Përveç organizatave shëndetësore shtetërore, ka gjithashtu shumë klinika private.

Në fushën e arsimit, ka tetë shkolla fillore në Komunën e Ohrit, 13 në Strugë dhe një në Debërcë. Në rajon ka gjithashtu edhe shkolla të mesme, dhe universitete duke përfshirë Fakultetin e Hoteleri-Turizmit, Universitetin e Shkencave të Informacionit dhe Teknologjisë Shën Pal Apostulli, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës – IUST dhe PSI Instituti Hidrobiologjik i Ohrit. Në Strugë ka dy kopshte fëmijësh, dhe në rajonin e Ohrit kopshti i fëmijëve Jasna Risteska funksionon në pesë lokalitete.

Institucionet e sektorit kulturor përfshijnë Akademinë e Ohrit për Humanizmin, Institutin e Ohrit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut, Festivalin Veror të Ohrit, Mbrëmjet Poetike të Strugës, Bibliotekën Gligor Prlichev dhe të tjera.

3.3.3.7 Industria

Ndërrmarjet e prodhimit industrial i nënshtrohen lejeve mjedisore në Maqedoninë e Veriut. Procesi i miratimit administrohet nga rregulloret mjedisore dhe lidhet me procedurat e vlerësimit për ndikimin në mjedis.

Industria kryesore në rajonin e liqenit është ajo e ndërtimit (prodhimi i cimentos), si dhe e përpunimit të ushqimit (pularitë), shitje me shumicë dhe pakicë, dhe transport. Për procese më të vogla janë dhënë leje të shumta nga të tre komnat por është e vështirë të matet ndikimi i tyre në liqen.

3.3.4 Trashëgimia kulturore

Liqeni i Ohrit ka qenë ndër shekuj një zonë e rëndësishme e vendbanimeve njerëzore. Kjo pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Sektori për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (organi i administratës shtetërore kompetent për menaxhimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore).

Për më tepër, i gjithë Qyteti i Ohrit dhe Liqeni i Ohrit janë regjistruar në Listën e Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s. Komnat përreth janë vendi i ngjarjeve të ndryshme të rëndësishme bashkëkohore kulturore, duke përfshirë Verën në Ohër dhe Netët e Poezisë në Strugë.

Qyteti i Ohrit është një prej vendbanimeve më të vjetra në Europë, me gjetje arkeologjike që e kanë prejardhjen në Epokën e Bronzit. Pjesë e trashëgimisë kulturore janë manastiri sllav (Shën Panteleimon); më shumë se 800 ikona të gdhendura të stilit bizantin, të cilat e kanë prejardhjen në shekullin 11 dhe 14 të erës tonë; dhe kishat e Shën Sofies dhe Shën Gjonit Teolog në Kaneo, dëshmi të artit dhe arkitekturës bizantine. Në qendër të qytetit të Ohrit janë zbuluar përqëndrime të zonave arkeologjike, veçanërisht të basilikave të krishtera të antikitetit. Trashëgimia e ndërtimit të mureve në qytet mund të shihet edhe në qytete të tjera të Perandorisë Osmane të shekujve 18 dhe 19, ku hapësira e kufizuar për ndërtim bënte që rrjeti i rrugëve të ishte i ngushtë.

Integriteti dhe autenticiteti i kësaj Zone të Trashëgimisë Botërore kërcënohet nga mungesa e bashkërendimit të zhvillimit urbanistik, menaxhimi i papërshtatshëm i ujërave të ndotura dhe i mbetjeve, si dhe rritja e popullsisë.

Komunat përreth Liqenit të Ohrit përbëjnë një rajon të rëndësishëm të madhe historike dhe kulturore. Komuna e Ohrit është streha e një numri shumë të madh të siteve kulturore.

Një numër i rëndësishëm i vendbanimeve historike janë evidente në zonat arkeologjike nënujore. Në bazë të Institutit Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut - Ohër (2021) zonat e mëposhtme arkeologjike nënujore gjenden në afërsi të bregut të liqenit:

- Gjiri i Kockave, Plate Micov Grad", fshati Peshtan – pozicionuar në pjesën lindore të liqenit, në jug të Peshtanit përgjatë bregut jugor të Gadishullit Gradishtë në thellësinë 2.4 në 5m.- Muzeu i Ujit (Gjat. 20,798; Gjer. 40.9942)
- Gjiri i Prchot, lok. "Na Dol", f. Trpejca, rajoni i Ohrit- pozicionuar në jug-perëndim të fshatit të Trpejcës në Gjirin e Dolit, dhe në thellësinë 5-8m. Në fund të liqenit janë mbetjet e një vendbanimi palafit.
- Gjiri i Bombave, f. Peshtani – i pozicionuar në pjesën lindore të liqenit, përgjatë bregut verior të fshatit të Peshtanit, në të ashtëquajturin Gjiri i Bombave.
- Zona Buçila, në Shën Naum – përgjatë bregut jugor, në perëndim të manastirit të Shën Naumit, ndodhej një vendbanim palafit i cili është restauruar.
- Zona Vrbnik, afër Strugës – e pozicionuar midis Strugës dhe fshatit Kalishtë në skajin verior të Liqenit të Ohrit në thellësinë 2.5m, rreth 1200m në perëndim të rrjedhës së lumit Drini i Zi dhe 800 m në lindje të fshatit Kalishtë.
- Zona e Rrjedhës së Drinit, Strugë – lokaliteti shtrihet përgjatë brigjeve të Liqenit të Ohrit dhe brigjeve të Drinit të Zi ku të dy takohen në Strugë.

3.3.5 Turizmi

Spektori i turizmit përreth Liqenit të Ohrit punëson më shumë se 3,300 njerëz ndër 427 objekte hotelerie. Vizitorët shpenzojnë më shumë se 937,000 netë në qytet në vitin 2017 dhe 1,034,000 netë në vitin 2018. Në vitin 2019 u arrit piku përpara pandemisë me 1,618,312 netë gjatë një viti.

Pjesa më e madhe e objekteve akomoduese gjenden në Komunën e Ohrit (79%), pjesa tjetër (21%) gjenden në Komunën e Strugës. Këto objekte kanë një numër total prej 6,064 dhomash dhe 16,656 shtretërish.

Vitet e fundit, zhvillimi i formave të reja dhe alternative të turizmit po rritet, së bashku me numrin e ofertave turistike në liqen dhe përreth tij. Dy qendra zhytjeje funksionojnë aktualisht, dhe turizmi me automjetet për të gjithë terrenet (ATV) po bëhet mjaft i njohur, kryesisht në Parkun Kombëtar të Galiçicës, dhe interesi për lundrimin gjithashtu është në rritje. Kampi i sapokrijuar SCOUT në Strugë ofron përvoja lundrimi dhe ka shpallur se do fillojë të ofrojë kurse zhytjeje, duke kontribuar ndaj mundësive turistike në zonë.

Turizmi në rajon, përveç përfitimeve të tij ekonomike, shkakton gjithashtu ndikime negative dhe trysni në mjedis. Një nga aspektet negative të turizmit është prania e një numri të madh të vizitorëve në qytetin e vjetër, veçanërisht gjatë ngjarjeve tradicionale që tërheqin dhjetëra mijëra vizitorë.

Përdorimi i papërgjegjshëm i brigjeve të Liqenit të Ohrit përmes ndërtimit të parregulluar siç duhet, menaxhimit të papërshtatshëm të koncesioneve të plazhit dhe niveli i paqëndrueshëm i trafikut të varkave mundet gjithashtu të ketë ndikime negative për biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore.

3.3.6 Arsimi

Komunat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës kanë institucione arsimore shtetërore që ofrojnë arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Arsimi fillor dhe i mesëm janë të detyrueshëm në Maqedoninë e Veriut. Ka vetëm një shkollë private për arsimin e mesëm në këtë zonë, në komunën e Strugës.

Arsimi i lartë i ofruar në këtë rajon përqëndrohet kryesisht në shkencat humane, si dhe në turizëm. Me rritjen e infrastrukturës së tyre të hoteleri-turizmit, këto komuna kanë nevojë për fuqi punëtore të trajnuar dhe të kualifikuar mirë.

Këto komuna kanë një numër të përshtatshëm të shkollave fillore për të plotësuar nevojat e banorëve të tyre. Megjithatë, Komuna e Debërcës nuk ka asnjë institucion të arsimit të mesëm apo të lartë.

Në qytetin e Ohrit gjendet universiteti "St. Kliment Ohridski", Fakulteti i Hoteleri-Turizmit, si dhe Universiteti i Informatikës "St. Apostle Paulus". Fakulteti i Turizmit ofron programe në turizëm dhe menaxhim turistik, siguracione, menaxhim hoteli dhe restoranti, zbatimin e ligjit doganor, dhe gastronomi. Universiteti i Informatikës "St. Apostle Paulus" u krijua si institucion i arsimit të lartë në vitin 2009 me drejtim në TIK, dhe Menaxhim Biznesi në TIK. Gjuha Zyrtare në këtë institucion është gjuha angleze, me një program gjithëpërfshirës për studentët e huaj. Ai përbëhet nga fakultetet e mëposhtme:

1. Fakulteti i Komunikimeve në Rrjet dhe Sigurisë;
2. Fakulteti i Shkencave dhe Inxhinierisë Kompjuterike;
3. Fakulteti i Sistemeve të Informacionit, Medias Audio-Vizive dhe Digjitale, dhe Multimedias;
4. Fakulteti i Teorisë dhe Analizës së Informacionit;
5. Fakulteti i Inteligjencës së Automatizuar dhe Robotikës.

Këto fakultete ofrojnë kurse diplomimi dhe pas diplomimi për sfera të ndryshme të TIK-ut dhe kanë një kapacitet të përgjithshëm prej 375 studentësh. Ai ka lidhur marrëveshje të shumta bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare të ndryshme dhe mbështet gjithashtu edhe një program gjithëpërfshirës bursash me Kinën për shkëmbimin e studentëve

Instituti Kombëtar Dr. Nikola Nezlobinski është një tjetër institucion arsimor/shkencor që ka në përbërjen e tij Departamentin e Biologjisë, Arkeologjisë, Etnologjisë, Historisë, Historisë së Artit, Arsimit dhe Marketingut si dhe muzetë.

Instituti Hidrobiologjik i Ohrit është pjesë e Universitetit "St Kliment Ohridski" – Bitola.

3.4 Vlerat e Zonës

3.4.1 Deklaratat e përgjithshme

Vlerat e jashtëzakonshme natyrore të Liqenit të Ohrit janë deklaruar në dokumente të shumta të kohëve të fundit:

| Burimi | Deklarata |
|---|--|
| Kostoski et al. (2010): A freshwater biodiversity hotspot under pressure – assessing threats and identifying conservation needs for ancient Lake Ohrid. Biogeosciences: | <i>Liqeni i Ohrit, një zonë e rëndësishme e biodiversitetit europian, i ndodhur në kontekstin ndërkufitar të Ballkanit, është një shembull kryesor për një liqen me përmasat që lejojnë shtrirjen e ngushtë të taksonëve endemikë që i nënshtrohen rritjes së trysnisë antropogjene.</i> |
| GIZ (2015): Initial Characterization of Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra/Skadar. | <i>Liqeni i Ohrit është një ekosistem i lashtë, i izoluar nga kodra dhe male rrethuese që kanë bërë të mundur evolucionin e një koleksioni të veçantë bimësh dhe kafshësh të llojeve të reja, dhe mbijetesën e disa prej tyre në kushte të pandryshuara, në liqen. Këto përfshijnë lloje relikte, apo “fosile të gjalla”, dhe shumë lloje endemike, të gjetura vetëm në Liqenin e Ohrit. Për shembull, 10 nga 17 llojet e peshqëve janë endemikë. Për shkak të biodiversitetit dhe endemizmit të lartë, si dhe trashëgimisë kulturore të veçantë, Liqeni i Ohrit dhe zonat përreth nuk janë vetëm me rëndësi vendore por edhe ndërkombëtare.</i> |
| GIZ (2017): Shorezone Functionality, Ohrid Lake. | <i>Liqeni i Ohrit është një ndër liqenet e pakta botërore të lashta dhe shërben si një zonë e rëndësishme e biodiversitetit me vlera të larta natyrore në shkallë globale.</i> |
| MMJPH: Strategjia Kombëtare për Biodiversitet me Plan Veprimi 2018 – 2023 | <i>Liqeni i Ohrit spikat si një ndër qendrat më të mëdha të diversitetit dhe endemizmit të jovetëbrorëve ujorë.</i> |
| Dosja e Nominimit (2018): Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit / (Zgjerimi i Pasurisë ekzistuese të Përzier Botërore “Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Ohrit” (99ter) | <i>Rajoni i Liqenit të Ohrit, një pronë e përzierë e Trashëgimisë Botërore që mbulon 83,350 ha, u regjistrua për vlerat e tij natyrore në vitin 1979 dhe për vlerat kulturore një vit më vonë. Liqeni i Ohrit është një dukuri mahnitëse natyrore, që ofron vendqëndrime për lloje të ndryshme të ujërave të ëmbla endemike dhe relikte të florës dhe faunës që e kanë prejardhjen në periudhën terciare. Si një liqen i thellë dhe i lashtë me prejardhje tektonike, Liqeni i Ohrit ka ekzistuar vazhdimisht për afërsisht dy deri në tre milionë vjet. Ujërat e tij oligitrofike ruajnë 300 lloje bimësh dhe kafshësh unike për liqenin, duke përfshirë algat, krimbat e shtypur, kërmijtë, krustacët dhe 17 lloje peshqish endemikë duke përfshirë dy lloje koranësh, si dhe praninë e larmishme të shumë shpendëve.</i> |
| UNESCO (2020): Plani për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe | <i>Liqeni i Ohrit është një dukuri e spikatur natyrore dhe shërben si streha e llojeve të ndryshme të ujërave të ëmbla endemike dhe relikte të florës dhe faunës që e kanë prejardhjen në periudhën terciare. Liqeni i lashtë ka prejardhje tektonike, d.m.th. ky liqen ka ekzistuar vazhdimisht për 2 deri në 3 milionë vjet. Ujërat e tij</i> |

| Burimi | Deklarata |
|---|--|
| Kulturore të Rajonit të Ohrit me një Plan Veprimi | <i>oligotrofike mbrojnë 200 lloje bimësh dhe kafshësh unike për liqenin, duke përfshirë algat, krimbat e shtypur, kërmijtë, krustacët dhe 17 lloje endemike peshqish duke përfshirë dy lloje troftash, si dhe shumë shpendë.</i> |

3.4.2 Endemizmi

Endemizëm është gjendja ekologjike e një lloji apo nën-lloji, shpërndarja e të cilit është e kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike. E kundërta e endemizmit është shpërndarja kozmopolite (p.sh. ajo e Homo sapiens); në shtrirje globale.

Deklaratat në lidhje me numrin e llojeve të ndryshme endemike variojnë, për shembull:

Albrecht C. dhe Wilke T. (2009): Ancient Lake Ohrid: Biodiversity and evolution. Hydrobiologia 615: *Sipas një vlerësimi të florës dhe faunës së Liqenit të Ohrit konfirmohet se liqeni mbart një biodiversitet të paimagjinueshëm endemik. Pavarësisht faktit që disa grupe biotike janë të studiuara pak ose aspak, afërsisht 1,200 lloje autoktone njihen nga liqeni, përfshirë 586 kafshë, dhe të paktën 212 lloje janë endemike, përfshirë 182 kafshë. Ritmi i përshtatur i endemizmit është përlllogaritur në 36% për të gjithë taksonët dhe 34% për Mbretërinë e Kafshëve. Në lidhje me biodiversitetin endemik, Liqeni i Ohrit së bashku me këto 212 lloje të njohura endemike dhe me një sipërfaqe prej 358km², është ndoshta liqeni më i shumëllojshëm në botë, duke marrë parasysh edhe sipërfaqen mbi ujë.*

Levkov & William (2012): *Për Liqenin e Ohrit janë raportuar gjithsej 789 taksonë prej të cilëve 117 taksonë (14%) konsiderohen endemikë për liqenin.*

Cvetkoska et al. (2018): *Hulumtimet biologjike të disponueshme deri më tani përshkruajnë më shumë se 300 lloje eukariotike endemike në Liqenin e Ohrit.*

3.4.3 Fauna dhe Flora

Tabelat e mëposhtme paraqesin një vështrim të përgjithshëm mbi llojet e kafshëve përkatëse për ri-shpalljen e Liqenit të Ohrit zonë e mbrojtur, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, të zgjedhur në bazë të këtyre kriterëve:

- Të pranishëm në zona të mbrojtura dhe të kërcënuar në bazë të Listës së Kuqe të IUCN-it për Llojet e Kërcënuara, ose
- Të pranishëm në zonat e mbrojtura dhe të renditur në Listën e Kuqe të Maqedonisë të Veriut, ose
- Të pranishëm në zonat e mbrojtura dhe të renditur në Shtojcat e Direktivave të BE-së për Shpendët dhe Habitatet, ose
- Të pranishëm në zonat e mbrojtura dhe të renditur në Listën Nacionale për Llojet e Mbrojtura Rreptësisht, apo
- Të pranishëm në zonat e mbrojtura dhe të propozuara nga një ekspert

Llojet e vlerësuara si të Paktën Shqetësuese (LC) në Listën e Kuqe të IUCN-it janë zgjedhur nëse ato plotësojnë të paktën një ose më shumë nga kriteret e mësipërme.

Shkurtesat në tabelat në vijim: Lloje të mbrojtura në MV: MRR = Të Mbrojtura Rreptësisht; M = Mbrojtura. Llojet kryesore janë shënuar me ngjyrë jeshile të lehtë.

DRAFT

3.4.3.1 Peshqit

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|--------------------|--|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------|---------------------|---------------------------|
| CEPHALASPIDOMORPHI | <i>Eudontomyzon stankokaramani</i> | I cënueshëm (VU) | Global & Europë | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Alburnoides ohridanus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | | DH Shtojca II dhe V | |
| ACTINOPTERYGII | <i>Alosa fallax</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global | | | MRR |
| ACTINOPTERYGII | <i>Anguilla Anguilla</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global & Europë | | DH Shtojca II dhe V | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Barbus rebeli / Barbus meridionalis</i> | | | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Chondrostoma ohridanus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global & Europë | | | |
| ACTINOPTERYGII | <i>Cobitis ohridana</i> | I cënueshëm (VU) | Global | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Cyprinus carpio</i> | I cënueshëm (VU) | Global & Europë | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Gobio ohridanus</i> | Të Dhëna të Pamjaftueshme (DD) | | | | MRR |
| ACTINOPTERYGII | <i>Pelagus minutus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global & Europë | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Rutilus ohridanus</i> | Të Dhëna të Pamjaftueshme (DD) | | | | MRR |
| ACTINOPTERYGII | <i>Salmo aphelios</i> | Të Dhëna të Pamjaftueshme (DD) | | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Salmo balcanicus</i> | I cënueshëm (VU) | Global & Europë | | | MRR |
| ACTINOPTERYGII | <i>Salmo ohridanus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global & Europë | | | M |
| ACTINOPTERYGII | <i>Scardinius knezevici</i> | I cënueshëm (VU) | Global & Europë | | | M |

3.4.3.2 Karavidhet (Krustacët)

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|--------------|------------------------|------------------------|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| MALACOSTRACA | <i>Astacus astacus</i> | I cënueshëm (VU) | Global | | | M |

3.4.3.3 Zvarranikët

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|----------|-----------------------------|---|-----------------------------------|---|----------------------|---------------------------|
| REPTILIA | <i>Elaphe qatuorlineata</i> | | | | | |
| REPTILIA | <i>Emys orbicularis</i> | I cënueshëm (VU) | MV | I cënueshëm (VU) | DH Shtojca II dhe IV | M |
| REPTILIA | <i>Mauremys rivulata</i> | I cënueshëm (VU) | MV | I cënueshëm (VU) | | |
| REPTILIA | <i>Natrix natrix</i> | Të paktën shqetësues (LC) | MV | Të paktën shqetësues (LC) | | |
| REPTILIA | <i>Natrix tessellata</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | MV | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | | M |

3.4.3.4 Amfibët

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|----------|--------------------------|---------------------------|-----------------------------------|---|--------------------|---------------------------|
| AMPHIBIA | <i>Bombina variegata</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | Të paktën shqetësues (LC) | DH Shtojca II | M |
| AMPHIBIA | <i>Bufo bufo</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | Të paktën shqetësues (LC) | | |
| AMPHIBIA | <i>Bufo viridis</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | Të paktën shqetësues (LC) | DH Shtojca IV | |
| AMPHIBIA | <i>Hyla arborea</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | | M |

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|----------|------------------------------|---------------------------|-----------------------------------|---|--------------------|---------------------------|
| AMPHIBIA | <i>Pelophylax ridibundus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | Të paktën shqetësues (LC) | DH Shtojca IV | |
| AMPHIBIA | <i>Rana dalmatina</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | Gati i tanguar (Pothuaj i kërcënuar) (NT) | | M |
| AMPHIBIA | <i>Rana graeca</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | Gati i tanguar (Pothuaj i kërcënuar) (NT) | | M |
| AMPHIBIA | <i>Rana temporaria</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | | | |
| AMPHIBIA | <i>Triturus karelinii</i> | I Rrezikuar (EN) | MV | I Rrezikuar (EN) | DH Shtojca II | M |
| AMPHIBIA | <i>Triturus macedonicus</i> | I cënueshëm (VU) | MV | I cënueshëm (VU) | | M |

3.4.3.5 Shpendët

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|-------|---------------------------|---------------------------|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| AVES | <i>Alcedo atthis</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Anas acuta</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | M |
| AVES | <i>Anas crecca</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | | DSH Shtojca II | M |
| AVES | <i>Anas penelope</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |
| AVES | <i>Anas platyrhynchos</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | N |

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|-------|----------------------------------|---|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| AVES | <i>Anas querquedula</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | N |
| AVES | <i>Anas strepera</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |
| AVES | <i>Ardea alba (Egretta alba)</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Ardea purpurea</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Ardeola ralloides</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Aythya ferina</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | DSH Shtojca II | M |
| AVES | <i>Aythya fuligula</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | M |
| AVES | <i>Aythya nyroca</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Global | | DSH Shtojca I | M |
| AVES | <i>Botaurus stellaris</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Bucephala clangula</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Chlidonias niger</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Chlidonias hybridus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Ciconia ciconia</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Circus aeruginosus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Circus cyaneus</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Cygnus olor</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |
| AVES | <i>Egretta garzetta</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Fulica atra</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Europë | | DSH Shtojca II | M |
| AVES | <i>Gallinago gallinago</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Gallinula chloropus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|-------|------------------------------------|---|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| AVES | <i>Gavia arctica</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Gavia stellata</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Ixobrychus minutus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Larus cachinans</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Larus ridibundus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |
| AVES | <i>Marmaronetta angustirostris</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Melanitta fusca</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Mergus albellus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Mergus merganser</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Mergus serrator</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Netta rufina</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Numenius arquata</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Nycticorax nycticorax</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Phalacrocorax carbo</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | | |
| AVES | <i>Phalacrocorax pygmeus</i> | | | | DSH Shtojca I | MRR |
| AVES | <i>Podiceps cristatus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | | MRR |
| AVES | <i>Rallus aquaticus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |
| AVES | <i>Rissa tridactyla</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | | |
| AVES | <i>Spatula clypeata</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |
| AVES | <i>Sterna hirundo</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Global | | DSH Shtojca I | |
| AVES | <i>Tachybaptus ruficollis</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | | MRR |

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|-------|--------------------------|---------------------------|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| AVES | <i>Tadorna tadorna</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | | MRR |
| AVES | <i>Tringa erythropus</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Tringa nebularia</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë | | DSH Shtojca II | |
| AVES | <i>Vanellus vanellus</i> | I cënueshëm (VU) | Europë | | DSH Shtojca II | MRR |

3.4.3.6 Gjitarët

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|----------|--------------------|---|-----------------------------------|-----------------------|----------------------|---------------------------|
| MAMMALIA | <i>Lutra lutra</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Global | | DH Shtojca II dhe IV | MRR |

3.4.3.7 Midhjet (Bivalvia)

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|----------|--------------------------------|------------------------|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| BIVALVIA | <i>Dreissena blanci</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| BIVALVIA | <i>Microcondylaea bonellii</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | |
| BIVALVIA | <i>Pisidium edlaueri</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |

3.4.3.8 Kërmijtë (Gastropoda)

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|------------|---------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| GASTROPODA | <i>Acroloxus improvisus</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Acroloxus macedonicus</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ancylus lapicidus</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ancylus scalariformis</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ancylus tapirulus</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Gocea ohridana</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Gyraulus albidus</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Gyraulus crenophilus</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Gyraulus fontinalis</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Gyraulus trapezoides</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Lyhndia gjorgjevici</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Lyhndia hadzii</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Lyhndia karamani</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Lyhndia stankovici</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Micropyrgula stankovici</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Neofossarulus stankovici</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohridoauffenia depressa</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohrigocea ornata</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | |
| GASTROPODA | <i>Ohridoauffenia minuta</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|------------|------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| GASTROPODA | <i>Ohridohauffenia rotonda</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohridohauffenia sanctinaumi</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohridohoratia carinata</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohridohoratia polinskii</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | |
| GASTROPODA | <i>Ohrigocea karevi</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohrigocea miladinovorum</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohrigocea samuili</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Ohrigocea stankovici</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Planorbis macedonicus</i> | I Rrezikuar (EN) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Pseudohoratia brusinae</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Pseudohoratia lacustris</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Pseudohoratia ohridana</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Pyrgohydrobia jablanicensis</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Pyrgohydrobia sanctinaumi</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Stankovicia wagneri</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | |
| GASTROPODA | <i>Strugia ohridana</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Trachyochridia filocincta</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Valvata hirsutecostata</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Valvata relicta</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Xestopyrgula dybowski</i> | I cënueshëm (VU) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Zaunia kusceri</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |
| GASTROPODA | <i>Zaunia sanctizaumi</i> | I rrezikuar në mënyrë kritike (CE) | Global, Europë & Mesdhe | | | M |

3.4.3.9 Insektet

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i IUCN-it | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në RMV |
|---------|------------------------------------|---|---|-----------------------|--------------------|---------------------------|
| INSECTA | <i>Callimorpha quadripunctaria</i> | | | | DH Shtojca II | |
| INSECTA | <i>Coenagrion mercuriale</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Global | | DH Shtojca II | |
| INSECTA | <i>Cordulegaster heros</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Global & Europë Lista e Kuqe e Piliesave të Mesdheut | | DH Shtojca II | M |
| INSECTA | <i>Dytiscus latissimus</i> | I cënueshëm (VU) | Global | | | |
| INSECTA | <i>Lycaena dispar</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Global | | DH Shtojca II | MRR |
| INSECTA | <i>Brachytron pratense</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Lista e Kuqe e Piliesave të Mesdheut | | | |

3.4.3.10 Flora

Tabela e mëposhtme paraqet një vështrim të përgjithshëm të llojeve të bimëve për ri-shpalljen e Liqenit të Ohrit si një zonë e mbrojtur në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës së Maqedonisë së Veriut, të përzgjedhura sipas këtyre kriterëve:

- Të pranishëm në rajon dhe të kërcënuar në bazë të Listës së Kuqe të IUCN-it për Llojet e Rrezikuara, ose
- Të pranishëm në rajon dhe të renditur në Shtojcat e Direktivave të BE-së për Shpendët ose Habitatet, ose
- Të pranishëm në rajon dhe të renditur në Listën e Kuqe të Maqedonisë së Veriut, ose
- Të pranishëm në rajon dhe të renditur në Listën Nacionale të Llojeve të Mbrojtura (rreptësisht), ose
- Të pranishëm në rajon dhe të propozuar nga një ekspert

Llojet e vlerësuara si Të Paktën Shqetësuese (LC) në Listën e Kuqe të IUCN-it janë përzgjedhur nëse ato përmbushin gjithashtu të paktën një nga kriteret e mësipërme.

| Klasa | Emri shkencor | Lista e Kuqe e IUCN-it | Fushëveprimi gjeografik i zbatimit | Lista e Kuqe e RMV-së | Direktivat e BE-së | Llojet e mbrojtura në MV |
|---------------|---------------------------|--|------------------------------------|-------------------------------|--------------------|--------------------------|
| MAGNOLIOPSIDA | <i>Trapa natans</i> | Gati i Tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Europë | I rrezikuar | | |
| UMBELLIFERAE | <i>Angelica palustris</i> | Të dhëna të pamjaftueshme (DD) | MV | I rrezikuar në mënyrë kritike | DH Shtojca II | |
| NYMPHAEACEAE | <i>Nuphar lutea</i> | Të paktën shqetësues (LC) | Europë & Mesdhe | | | |
| SALVINIACEAE | <i>Salvinia natans</i> | Gati i tanguar (NT) (Pothuaj i kërcënuar) | Europë | I cënueshëm | | M |

DRAFT

3.5 Kërcënimet ndaj zonës

Tabela e mëposhtme ofron një vështrim të përgjithshëm të trysnive dhe kërcënimeve të ekosistemit të Liqenit të Ohrit:

| Trysnitë | Rëndësia | Kërcënimet |
|---|----------|---|
| Mungesa e menaxhimit të zonës së mbrojtur | E lartë | <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë që mund të shkaktojnë ndikime negative ndaj ekosistemit nuk kontrollohen; • Statusi i mjedisit nuk monitorohet; • Trysnitë nuk monitorohen; • Popullsia lokale dhe turistët nuk informohen mjaftueshëm për ekosistemin e liqenit |
| Turizmi | E lartë | <p>Liqeni i Ohrit është një nga destinacionet më të rëndësishme turistike në Maqedoni me afërsisht 300,000 vizitorë në vit. Kjo ka ndikime të shumta negative:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimet e paplanifikuara dhe të paligjshme të përmasave të ndryshme në vendndodhje të ndryshme që ndikojnë habitatet (veçanërisht Ligatinën Studençishko); • Përdorimi i varkave të llojeve dhe përmasave të ndryshme që shkaktojnë dallgë, ndotje akustike dhe shqetësime; • Ndotja nga nafta, benzina dhe kimikatet e tjera të varkave dhe mjeteve të lundrimit (p.sh. nga marina); • Shkarkimi i mbetjeve; • Ujërat e zeza nga vendbanimet e njerëzve; • Qarkullimi i numrave të mëdhenj të mjeteve private, dhe parkimi i pakontrolluar; • Shqetësimi i faunës dhe florës për shkak të notimit në plazhe; • Shqetësimi i faunës përmes sporteve ujore; • Pasojat negative në burimet e Shën Naumit dhe lokaliteteve të tjera. • Mungesa e njohurive për kapacitetin e transportit ekologjik |
| Peshkimi | E lartë | <ul style="list-style-type: none"> • Nivele të paqëndrueshme të peshkimit; • Peshkimi i paligjshëm; • Introdiktimi (futja) i llojeve jo-autoktone; • Mungesa e rregullores së peshkimit |
| Ujërat e zeza të zonës dhe ato urbane | E lartë | <p>Për shumë vite sistemi i trajtimit të ujërave të zeza ka qenë i pamjaftueshëm. Në vitin 2019, u bënë ndërhyrje serioze të cilat kishin për qëllim riparimin e tubacioneve të kolektorëve të ujërave të zeza, stacioneve të pompimit dhe impjantit të trajtimit të ujërave të zeza në Vranishtë, të cilat rezultuan në përmirësime të ndjeshme dhe reduktim të kësaj trysnie. Gjithësesi, mbeten kërcënimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara nga zonat përreth të cilat nuk janë të lidhura me sistemin |

| Trysni të | Rëndësia | Kërcënimet |
|--|----------|--|
| | | qendror të kanalizimeve duke shkaktuar eutrofikim dhe ndotje. |
| Minierat dhe industria | E mesme | <ul style="list-style-type: none"> Mbetjet e ngurta transportohen në liqen nga burime të ndryshme; Shkarkimi i ujërave të ndotura nga industria dhe minierat shkakton ndotje |
| Ndotja nga degëzimet e lumenjve | E lartë | <ul style="list-style-type: none"> Degët e lumenjve që ushqejnë Liqenin e Ohrit (lumenjtë Daljan, Velgoska, dhe Koselska në pjesën maqedonase dhe Çërrava, në Pogradec, dhe Vërdova në pjesën shqiptare) transportojnë lëndë ushqyese dhe ndotës të tjerë duke shkaktuar kështu një kërcënim ndaj Liqenit oligotrofik të Ohrit; Lumit Sateska iu dha drejtimi për në Liqenin e Ohrit në vitin 1962 për përdorimin e hidrocentralit dhe shkarkon sedimente në liqen. |
| Degradimi i habitateve përmes përdorimit të plazheve | E lartë | <p>Humbja e habitateve, degradimi dhe fragmentimi përmes veprimtarive të ndryshme të njeriut përgjatë brigjeve të Liqenit të Ohrit kanë pasojat e drejtpërdrejta në faunën dhe florën:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi; Zonat për kampingje; Përdorimi i plazheve për notim; Peshkimi; Parkimi i automjeteve; Shkarkimi i mbetjeve; Shndërrimi në tokë bujqësore |
| Bujqësia | E mesme | <ul style="list-style-type: none"> Bujqësia praktikohet në veri dhe jugperëndim të pellgut të Ohrit dhe shkakton transportimin e plehrave kimikë dhe pesticideve gjatë reshjeve në liqen (përzierje e burimeve) që shkaktojnë eutrofikim dhe ndotje të drejtpërdrejtë; Shqetësimi i faunës; Përdorimi i ujit nëntokësor për ujitje; Ndikimi i fosforit nga Liqeni i Prespës përmes lidhjeve nëntokësore hidraulike-karstike që shkaktojnë eutrofikim në Liqenin e Ohrit. |
| Menaxhimi i ujit | E mesme | <ul style="list-style-type: none"> Luhatjet e nivelit të ujit për shkak të menaxhimit të papërshtatshëm të digave hidroelektrike në Drinin e Zi. |
| Llojet jo-autoktone | E mesme | <p>Llojet jo-autoktone përbëjnë një kërcënim për bashkësitë e ekosistemit të liqenit të lashtë duke zëvendësuar llojet vendase:</p> <ul style="list-style-type: none"> Llojet e huaja të peqshve; Bimët invazive; Ndryshimet në bashkësitë e zooplanktoneve. |
| Marina | E lartë | <ul style="list-style-type: none"> Pasojat e panumërta kumulative negative në ekosistemin e kanalit Studençishte. |

3.5.1 Vështrim i përgjithshëm i kërcënimeve në bazë të klasifikimit të Natura 2000

Kërcënimet përkatëse ndaj Liqenit të Ohrit në bazë të Klasifikimit të Natura 2000 renditen më poshtë. Burimi për këtë klasifikim gjendet në portalin e referencave për raportimin në bazë të Nenit 17 të Direktivës për Habitatet (Lista e trysnive dhe kërcënimeve, përditësuar së fundmi: 07.05.2018):

https://cdr.eionet.europa.eu/help/habitats_art17

Legjenda:

| |
|------------------|
| Kërcënim i ulët |
| Kërcënim i mesëm |
| Kërcënim i lartë |

| | |
|--|---|
| A – Bujqësia | |
| A18 | Ujitja e tokës bujqësore |
| A20 | Aplikimi i plehrave kimikë sintetikë (mineralë) në tokën bujqësore |
| A21 | Përdorimi i kimikateve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi |
| D – Proceset e prodhimit të bujqësisë dhe zhvillimi i infrastrukturës përkatëse | |
| D02 | Hydro-energji (digat, telat, prurjet e lumit), duke përfshirë infrastrukturën |
| E – Zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve të transportit | |
| E01 | Rrugët, shtigjet, rrugët automobilistike dhe infrastruktura përkatëse (p.sh. urat, urat-rrugë (viaduktet), tunelet) |
| E02 | Vënia në funksion e korsive të anijeve dhe trageteve |
| E03 | Korsitë e anijeve, korsitë e trageteve dhe infrastruktura e ankorimeve (p.sh. argjinaturat, pastrimi i porteve) |
| F – Zhvillimi, ndërtimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe zonave të banimit, tregtare, industriale dhe rekreative | |
| F01 | Shndërrimi i përdorimeve të tjera të tokës për strehim, vendbanim ose zona rekreative (duke përjashtuar tharjen dhe modifikimin e vijës bregore) |
| F02 | Ndërtimi ose modifikimi (p.sh. i strehimit dhe vendbanimeve) në zonat ekzistuese urbane ose rekreative |
| F03 | Shndërrimi nga përdorime të tjera të tokës në zona tregtare/industriale (duke përjashtuar tharjen dhe modifikimin e vijës bregore, estuarin) |
| F05 | Krijimi ose zhvillimi i infrastrukturës sportive, turizmit dhe rekreacionit (jashtë zonave urbane dhe rekreative) |
| F06 | Zhvillimi dhe ruajtja e zonave të plazhit për turizmin dhe rekreacionin duke përfshirë mbushjen me rërë të plazheve dhe pastrimin e tij |
| F07 | Veprimtaritë sportive, turistike dhe rekreative |
| F08 | Modifikimi i vijës bregore, estuarit dhe kushteve bregore për zhvillim, përdorim dhe ruajtje të zonave të banimit, zonave tregtare, industriale dhe rekreative |
| F09 | Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve/mbeturinave nga objektet e banesave/rekreative |
| F10 | Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve/mbeturinave nga objektet tregtare dhe industriale |
| F11 | Ndotja e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor për shkak të rrjedhjeve nga mbetjet urbane |
| F12 | Shkarkimi i ujërave të zeza urbane (duke përjashtuar përmbytjet nga rreshjet e dendura dhe/ose rrjedhjet nga mbetjet urbane) që shkaktojnë ndotje në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore |
| F13 | Bimët, zonat e kontaminuara ose të braktisura industriale që shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore |

| | |
|--|---|
| F24 | Veprimtaritë e banorëve ose ato rekreative dhe objektet që shkaktojnë zhurma, ndriçim, nxehtësi ose forma të tjera ndotjeje |
| F26 | Tharja, mbjellja e tokës dhe shndërrimi i ligatinave, moçalishteve, kënetave, kallamishteve, etj. në vendbanime ose zona rekreative |
| F27 | Tharja, mbjellja tokës ose shndërrimi i ligatinave, moçalishteve, kënetave, etj. në zona industriale/tregtare |
| G – Nxjerrja dhe kultivimi i burimeve të gjalla biologjike (përveç atyre bujqësore dhe pyjore) | |
| G05 | Gjuetia e peshqve të ujërave të ëmbla dhe mbledhja e karkalecave (profesionale) |
| G06 | Gjuetia e peshqve të ujërave të ëmbla dhe mbledhja e karkalecave (rekreative) |
| G07 | Gjuetia |
| G08 | Menaxhimi i rezervave të peshkut dhe gjuetia |
| G10 | Vrasja e paligjshme |
| G12 | Kapja e paqëllimshme dhe vrasja aksidentale (për shkak të veprimtarive të peshkimit dhe gjuetisë) – rrjetat fantazëm |
| G24 | Introduktimi (futja) dhe përhapja e llojeve (duke përfshirë llojet e huaja dhe GMO-të (organizmat e modifikuar gjenetikisht)) në kulturën ujore të ujërave të ëmbla |
| G27 | Veprimtari të tjera në lidhje me nxjerrjen dhe kultivimin e burimeve të gjalla biologjike të preferuara më lart |
| I – Llojet e huaja dhe problematike | |
| I02 | Lloje të tjera të huaja invazive (përveç llojeve të rrezikuara në nivelin e BE-së) |
| L – Proceset natyrore (përfshirë i katastrofave dhe proceseve të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut ose ndryshimet klimatike) | |
| L01 | Proceset natyrore abiotike (p.sh. erozioni, përbaltja, tharja, zhytja, kripëzimi) |
| L03 | Grumbullimi i lëndës organike |
| M – Ngjarjet gjeologjike, katastrofat natyrore | |
| M03 | Tërmetet |
| N – Ndryshimet klimatike | |
| N01 | Ndryshimet e temperaturës (p.sh. rritja e temperaturave & ekstremeve) për shkak të ndryshimeve klimatike |

3.5.2 Vështrim i përgjithshëm: Trysnitë – Tiparet kryesore Natyrore – Masat e Ruajtjes

| Trysnitë dhe Kërcënimet | Shkaqet e trysnive dhe kërcënimeve | Llojet Kryesore që ndikohen nga kërcënimet dhe trysnitë | Masat përkatëse të ruajtjes | Rëndësia e ruajtjes |
|--|------------------------------------|---|--|---------------------|
| Përdorimi i varkave të madhësive të ndryshme që shkaktojnë dallgë, ndotje akustike dhe shqetësime | Turizmi Peshkimi | <ul style="list-style-type: none"> • Belushka (<i>Salmo ohridanus</i>) • Breshka e Kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) • Karabullaku i vogël (<i>Phalacrocorax pygmeus</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Zhytkryekuqja e madhe (<i>Netta rufina</i>) • Bajza (<i>Fulica atra</i>) • Zhytraku i madh (<i>Mergus merganser</i>) | <ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i ndikimeve negative dhe shqetësimeve nga varkat përmes zonimit • Përmirësimi i standardeve teknike të varkave • Kalimi në motorrët elektrikë • Kufijtë e shpejtësisë për varkat | E lartë |
| Ndotja nga nafta, benzina dhe kimikate të tjera të përdorura nga varkat dhe mjetet e lundrimit (p.sh. nga marina); | Turizmi Peshkimi | <ul style="list-style-type: none"> • Belushka (<i>Salmo ohridanus</i>) • Bretkosa e drurëve (<i>Hyla arborea</i>) • Breshka e Kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Karabullaku i vogël (<i>Phalacrocorax pygmeus</i>) • Zhytkryekuqja e madhe (<i>Netta rufina</i>) • Bajza (<i>Fulica atra</i>) • Lundërza (<i>Lutra lutra</i>) • <i>Pisidium edlaueri</i> | <ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i ndikimit negativ nga varkat përmes zonimit • Përmirësimi i standardeve teknike të varkave dhe kalimi në motorrët elektrikë • Minimizimi i ndotjes nga ujërat e zeza | I lartë |
| Peshkimi i paqëndrueshëm dhe i paligjshëm | Peshkimi | <ul style="list-style-type: none"> • Belushka (<i>Salmo ohridanus</i>) | <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e peshkimit që ndihmojnë për të mbrojtur llojet • Krijimi i një koncesioni në bazë të kriterëve të ruajtjes | E lartë |

| Trysni të dhe Kërcënime | Shkaqet e trysnive dhe kërcënimeve | Llojet Kryesore që ndikohen nga kërcënime dhe trysnitë | Masat përkatëse të ruajtjes | Rëndësia e ruajtjes |
|--|------------------------------------|--|---|---------------------|
| Shqetësimi i zonave të shumimit nga ndikimi i njeriut | Ndikimi i njeriut Turizmi | <ul style="list-style-type: none"> • Belushka (<i>Salmo ohridanus</i>) | <ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i shqetësimeve në zonat e shumimit përmes zonave të mbrojtjes | E lartë |
| Ndërtimet e paplanifikuara dhe të paligjshme të madhësive të ndryshme në vendndodhje të ndryshme | Turizmi Urbanizimi | <ul style="list-style-type: none"> • Belushka (<i>Salmo ohridanus</i>) • Breshka e kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) • Pilivesa <i>Brachytron pratense</i> • <i>Pisidium edlaueri</i> • <i>Angelica palustris</i> • Brezat e kallamishteve | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i zonave të mbrojtjes në zonat e shumimit • Regullorja e ndërtimit në breg • Mbrojtja e habitateve të vlefshme dhe të ndjeshme • Minimizimi i ndikimit të mjedisit të liqenit nga marina • Zonimi, dhe masat e mbrojtjes në zonë | E lartë |
| Shkarkimi i mbetjeve | Urbanizimi Bujqësia Turizmi | <ul style="list-style-type: none"> • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • <i>Gocea ohridana</i> • Brezat e kallamishteve | <ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i ndotjes së ujit • Rregullorja për ndërtimet në breg • Krijimi i një subjekti menaxhues aktiv përgjegjës për veprimtaritë rregullatore | E lartë |
| Ujërat e zeza të zonës dhe ato urbane (që shkaktojnë eutrofikim dhe ndotje) | Urbanizimi Turizmi | <ul style="list-style-type: none"> • Breshka e Kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Karabullaku i vogël (<i>Phalacrocorax pygmeus</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Zhytkryekuqja e madhe (<i>Netta rufina</i>) • Bajza (<i>Fulica atra</i>) • <i>Pisidium edlaueri</i> • <i>Gocea ohridana</i> | <ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i eutrofikimit për shkak të ujërave të zeza dhe prurjeve nga degëzimet e lumenjve • Rritja e cilësisë së ujit përmes impjanteve moderne të trajtimit të ujërave të zeza urbane dhe industriale • Menaxhimi i qëndrueshëm i pellgut ujëmbledhës për të reduktuar eutrofikimin e liqenit • Përmirësimi i cilësisë së ujit | E lartë |

| Trysnitë dhe Kërcënimet | Shkaqet e trysnive dhe kërcënimeve | Llojet Kryesore që ndikohen nga kërcënimet dhe trysnitë | Masat përkatëse të ruajtjes | Rëndësia e ruajtjes |
|--|--------------------------------------|--|--|---------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Angelica palustris</i> | <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i cilësisë së ujit | |
| Shqetësimi i faunës dhe i habitateve për shkak të notimit në plazhe dhe sporteve ujore | Turizmi | <ul style="list-style-type: none"> • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Karabullaku i vogël (<i>Phalacrocorax pygmeus</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Zhytkryekuqja e madhe (<i>Netta rufina</i>) • Bajza (<i>Fulica atra</i>) • <i>Angelica palustris</i> • Brezat e kallamishteve | <ul style="list-style-type: none"> • Zonat e mbrojtjes në liqen • Zhvillimi dhe zbatimi i programeve edukative për ruajtjen e llojeve dhe habitateve të tyre • Edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit | E lartë |
| Ndotja nga degët e lumenjve (kërcënimi për Liqenin oligotrofik të Ohrit) | Ujërat e zeza | <ul style="list-style-type: none"> • Breshka e Kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) • <i>Pisidium edlaueri</i> • <i>Gocea ohridana</i> | <ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i procesit të eutrofikimit për shkak të ujërave të zeza dhe degëve të lumenjve | E lartë |
| Degradimi i habitateve, tharja dhe shkatërrimi (djegia dhe prerja) | Bujqësia Ujërat e zeza Turizmi | <ul style="list-style-type: none"> • Bretkosa e drurëve (<i>Hyla arborea</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) • Zhytkryekuqja e madhe (<i>Netta rufina</i>) • Bajza (<i>Fulica atra</i>) • Pilivesa <i>Brachytron pratense</i> • Lundërza (<i>Lutra lutra</i>) • <i>Angelica palustris</i> • Brezat e kallamishteve | <ul style="list-style-type: none"> • Zonimi dhe mbrojtja e rreptë (strikte) e zonave të mbrojtura • Mirëmbajtja e ligatinave • Monitorimi i popullatave të llojeve kryesore • Reduktimi i ndërhyrjeve të njeriut në habitatet e llojeve kryesore • Mbrojtja dhe restaurimi i habitateve të vlefshme dhe të ndjeshme | E lartë |
| Gjuetia dhe grackat | Gjuetia dhe peshkimi | <ul style="list-style-type: none"> • Breshka e kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) • Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një subjekti menaxhues aktiv përgjegjës për veprimtaritë rregullatore | E mesme |

| Trysni të dhe Kërcënimet | Shkaqet e trysnive dhe kërcënimeve | Llojet Kryesore që ndikohen nga kërcënimet dhe trysni të | Masat përkatëse të ruajtjes | Rëndësia e ruajtjes |
|--|---|--|---|---------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zhytraku i madh (<i>Mergus merganser</i>) Lundërza (<i>Lutra lutra</i>) | <ul style="list-style-type: none"> Parandalimi i mortalitetit dhe shqetësimit të shkaktuar nga gjuetia, peshkimi, dhe veprimtari të tjera të njeriut Krijimi i vendqëndrimeve për shpendët Zonat e mbrojtura në liqen Moratoriumi i rrjetave të peshkimit në habitatet natyrore të llojeve kryesore | |
| Luhatjet e nivelit të ujit për shkak të menaxhimit të papërshtatshëm të digave (pendëve) hidroelektrike mbi Drinin e Zi | Përdorimi i papërshtatshëm i instalimeve hidroelektrike | <ul style="list-style-type: none"> Breshka e Kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) Pilivesa <i>Brachytron pratense</i> Kryekuqja e mjeme (<i>Aythya ferina</i>) Brezat e kallamishteve | <ul style="list-style-type: none"> Zona/sipërfaqja e menaxhimit Përputhshmëria dhe zbatimi i ligjeve Zonimi dhe mbrojtja e rreptë (strikte) | E mesme |
| Llojet e huaja invazive përbëjnë një kërcënim ndaj bashkësive të ekosistemit të liqenit të lashtë duke zëvendësuar llojet negative | Kultura ujore | <ul style="list-style-type: none"> Breshka e kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) Kryekuqja e vogël (<i>Aythya nyroca</i>) | <ul style="list-style-type: none"> Monitorimi i popullatave Konrolli i konkurrencës nga llojet ekzotike të breshkave | E mesme |
| Shndërrimi në tokë bujqësore | Bujqësia | <ul style="list-style-type: none"> Breshka e kënetave (<i>Emys orbicularis</i>) Brezi i kallamishteve Pilivesa <i>Brachytron pratense</i> <i>Pisidium edlaueri</i> <i>Gocea ohridana</i> <i>Angelica palustris</i> | <ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e habitateve të vlefshme dhe të ndjeshme Minimizimi i eutrofikimit për shkak të ujërave të zeza dhe prurjeve nga degët e lumenjve Restaurimi i habitateve dhe proceseve natyrore | E ulët |

| Trysnitë dhe Kërcënimet | Shkaqet e trysnive dhe kërcënimeve | Llojet Kryesore që ndikohen nga kërcënimet dhe trysnitë | Masat përkatëse të ruajtjes | Rëndësia e ruajtjes |
|-------------------------|------------------------------------|---|---|---------------------|
| | | | <ul style="list-style-type: none"> • Zonimi dhe masat e mbrojtjes në zonë • Monitorimi i habitateve | |

DRAFT

3.6 Efektshmëria dhe efikasiteti i menaxhimit dhe kapacitetet menaxhuese

Aktualisht nuk është relevante pasi zona nuk është menaxhuar ende.

DRAFT

4 Strategjia

4.1 Vizioni për Zonën e Mbrojtur

Sigurimi i mbrojtjes dhe ruajtjes afatgjatë të Monumentit të Natyrës – Liqeni i Ohrit dhe bregu i tij për brezat e ardhshëm si një zonë e vlerave të jashtëzakonshme natyrore dhe një zonë e rëndësishme e biodiversitetit, me llojet dhe habitatet e rëndësishme kombëtare dhe evropiane; zona e mbrojtur ofron një gamë të gjerë të shërbimeve të ekosistemit dhe menaxhohet në një mënyrë që balancon mbrojtjen e natyrës me nevojat e popullsisë lokale, për të arritur moton e saj: ‘Për natyrën dhe njerëzit’.

4.2 Qëllimet dhe Objektivat e Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur

Qëllimet kryesore të mbrojtjes janë:

- Vlerat e jashtëzakonshme natyrore të Liqenit të Ohrit Monument i Natyrës valorizohen, mbrohen, ruhen dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Proceset natyrore dhe funksionet ekologjike ndodhin të papenguara
- Statusi i favorshëm i ruajtjes së habitateve dhe llojeve ruhet duke respektuar legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e natyrës, dhe regjimet e zonimit dhe mbrojtjes së ZM-së.
- Burimet natyrore përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e natyrës, peshkatarinë dhe bujqësinë. Koncepti i shërbimeve të ekosistemit është zhvilluar për Liqenin e Ohrit dhe siguron përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve të ekosistemit, i cili krijon mundësitë për zhvillimin ekonomik lokal.
- Mbrojtja, valorizimi dhe promovimi i vlerave kulturore të zonës së mbrojtur çojnë në rritjen e interesit të vizitorëve.
- Vlerat natyrore të rëndësishme kombëtare, evropiane dhe globale mbrohen dhe promovohen ndaj komuniteteve lokale dhe vizitorëve.
- Inkurajohet dhe mbështetet përfshirja lokale në ZM, e cila do të kontribuojë në forcimin dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm lokal.
- Infrastrukturë e efektshme për vizitorët, informacion i saktë i siguruar rregullisht ndaj programit edukativ publik.
- Administratë e motivuar, efikase dhe profesionale e ZM-së.

4.3 Kufijtë dhe Zonimi i Propozuar për Zonën e Mbrojtur

4.3.1 Kufijtë e Jashtëm të Propozuar për Zonën e Mbrojtur

Kufijtë e jashtëm të zonës së mbrojtur janë të njëjtë me parcelën e kadastrës 1/1, Kadastra e Komunës Ohridsko Ezero, dokumenti i pronësisë numër 1. Parcela është e regjistruar në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka një sipërfaqe prej 247.9 km², me përdorimin e regjistruar të tokës “liqen natyror”. Parcela kadastrale nuk ndjek ekzaktësisht vijën bregore, dhe niveli i ujit të liqenit luhet gjatë të gjithë vitit.

Në bregun perëndimor kufiri nis në kufirin shtetëror (41°05'11.0"N - 20°37'58.3"E), më tej kalon përmes pikave të mëposhtme:

- bregu pranë Radoshtës

- bregu në Kampin Livadishta
- manastiri i Kalishtës dhe zona e rëndësishme e biodiversitetit
- Kalishta
- brezat me kallamishte të Kalishtës
- Struga
- rrjedha e Lumit Sateska
- kufiri i Komunës së Debërcës
- kufiri i Komunës së Ohrit
- brezat me kallamishte në Podmolje (zonë e rëndësishme e biodiversitetit)
- bregu në rezortin Andon Dukov
- bregu në Spitalin Shën Erasmo
- bregu në rrjedhën e Lumit Daljan
- bregu në Ohër
- brezi me kallamishte në Mazija (zonë e rëndësishme e biodiversitetit)
- rrjedha e kanalit Studençishko
- ligatina Studençishko (zonë e rëndësishme e biodiversitetit)
- bregu në Goricë
- bregu në Shën Stefan
- kufiri me Parkun Kombëtar të Galiçicës 41°03'53.1"N 20°48'04.8"E
- bregu në Dolno Kojnsko
- Peshtani
- zona e Gradishtës
- zona e rëndësishme e biodiversitetit Veli Dab
- zona e rëndësishme e biodiversitetit Velja Pes
- bregu në Trpejca
- bregu në Manastirin e Shën Zaumit (zonë e rëndësishme e biodiversitetit)
- bregu në Ljubanishtë
- bregu në burimet e Shën Naumit (zonë e rëndësishme e biodiversitetit)
- bregu në manastirin e Shën Naumit
- bregu në kufirin shtetëror (40°54'41.7"N - 20°43'54.8"E)
- Nga këtu kufiri i ZM-së ndjek kufirin shtetëror përmes pjesës së pasme të liqenit për të arritur sërish tek pika e fillimit

Në kreun e ardhshëm paraqitet harta me kufijtë dhe zonat.

4.3.2 Zonimi i Propozuar i Zonës së Mbrojtur

Në këtë zonim të propozuar, Liqeni i Ohrit ndahet në 57 segmente në tre zona: zona e menaxhimit aktiv, zona e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zona e mbrojtjes së rreptë.

Zona e Menaxhimit Aktiv përbëhet nga katër segmente që mbulojnë 60% të liqenit, me një sipërfaqe totale prej 14,938 hektarësh. Këto segmente ndodhen përreth Ezerski lozja – Daljan, vijës bregore maqedonase - shqiptare dhe kufirit përmes liqenit, zonës së bregut lindor dhe zonës së Kalishtë-Strugës.

Zona e Mbrojtjes së Rreptë përbëhet nga 41 segmente që mbulojnë 12% të liqenit. Segmentet janë kryesisht relativisht të vegjël dhe përreth vijës së bregut të liqenit. Segmenti më i madh

është 1,059 hektarë dhe gjendet pranë Podmoljes. Segmente të tjera të mëdha të kësaj zone gjenden në Çokolsko (565 ha) dhe Kalishtë (360 ha).


Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm ka 12 segmente që mbulojnë 28% të sipërfaqes së liqenit. Segmenti i saj më i madh (6,708 ha) shtrihet pranë Kalishtës deri në Strugë dhe Ohër dhe përmes mesit të liqenit përgjatë të gjithë udhës për në Shën Naum. Të gjithë segmentet e tjera në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm janë relativisht të vegjël dhe gjenden përgjatë bregut të liqenit. Segmenti më i vogël është 0.97 hektarë.

Ka gjithashtu një rrip mbrojtës prej 166 hektarësh i cili zë një rrip prej 50 m gjerësi përreth liqenit. Në përfundim, ai fillon në kufirin maqedonas-shqiptar dhe ndjek bregun për në pikën e anës lindore ku bregu takohet me kufirin e Parkut Kombëtar të Galiçicës pranë Konjskos.

| Zona | ID | Emri i Zonës | Hektarë |
|----------------------------|----|--------------------------|------------|
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 1 | Stara Karaula | 753.37 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 2 | Livadishte 1 | 10,350.97 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 3 | Livadishte 2 | 13,646.64 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 4 | Izgrev 1 | 65.42 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 5 | Izgrev 2 | 85.99 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 6 | Kalishta 1 | 36.30 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 7 | Kalishta 2 | 36,058.72 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 8 | Rrethi i Parë i Strugës | 89.32 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 9 | Rrethi i Dytë i Strugës | 534.01 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 10 | Rrethi i Tretë i Strugës | 192.12 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 11 | Zona Podmoje | 105,974.52 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 12 | Zona Shën Erazmo | 12,660.01 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 13 | Zona e Lumit Daljan | 2,604.57 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 14 | Mazija | 204.79 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 15 | Studencišta | 1,462.37 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 16 | Shën Stefan 1 | 102.41 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 17 | Shën Stefan 2 | 156.58 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 18 | Shën Stefan 3 | 240.12 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 19 | Konjsko 1 | 198.26 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 20 | Konjsko 2 | 186.00 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 21 | Konjsko 3 | 111.41 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 22 | Konjsko 4 | 79.57 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 23 | Lagadin 1 | 144.27 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 24 | Lagadin 2 | 86.49 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 25 | Lagadin 3 | 255.99 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 26 | Lagadin 4 | 103.83 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 27 | Eleshec 1 | 141.34 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 28 | Eleshec 2 | 180.47 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 29 | Eleshec 3 | 214.41 |
| Zona e Mbrojtjes së Rreptë | 30 | Eleshec 4 | 256.91 |

Plani i Menaxhimit për Liqenin e Ohrit Monument i Natyrës

| Zona | ID | Emri i Zonës | Hektarë |
|----------------------------------|----|-----------------------------------|------------|
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 31 | Eleshec 5 | 188.36 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 32 | Peshtani 1 | 127.68 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 33 | Peshtani 2 | 130.27 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 34 | Peshtani 3 | 238.12 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 35 | Desaret | 16,339.92 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 36 | Çokolsko | 56,574.88 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 37 | Shën Zaum Veri | 2,705.03 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 38 | Shën Zaum Jug | 19,164.50 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 39 | Ljubanishta 1 | 5,745.79 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 40 | Ljubanishta 1 | 4,901.85 |
| Zona e Mbrotjes së Rreptë | 41 | Shën Naum | 1,969.42 |
| Zona e Menaxhimit Aktiv | 1 | Vija bregore maqedonase-shqiptare | 890,832.39 |
| Zona e Menaxhimit Aktiv | 2 | Zona Kalishtë-Strugë | 17,104.70 |
| Zona e Menaxhimit Aktiv | 3 | Ezerski Lozja – Daljan | 98,760.69 |
| Zona e Menaxhimit Aktiv | 4 | Zona e Bregut Lindor | 487,763.08 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 1 | Kampi Radozhda Treska | 3,499.89 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 2 | Radozhda 1 | 653.39 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 3 | Radozhda 2 | 99.53 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 4 | Kampi Livadishte | 998.62 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 5 | Elen Kamen | 153.68 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 6 | Korridori kryesor | 671,059.98 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 7 | Plazhi i Debërcës | 663.35 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 8 | Vija bregore Gorica-Desaret | 6,769.68 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 9 | Eleshec Jug | 97.27 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 10 | Vija bregore Lagadin – Desaret | 2,663.80 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 11 | Trpejca | 1,694.66 |
| Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm | 12 | Plazhi Ljubanishta | 2,068.30 |



Për të siguruar dhe promovuar mbrojtjen e vlerave natyrore të liqenit, katër zona janë hartuar: zona e mbrojtjes së rreptë, menaxhimi aktiv, zhvillimi i qëndrueshëm dhe rripi mbrojtës prej 50m përreth kufijve të liqenit. Një përshkrim narrativ i kufijve dhe zonave ofrohet në kreun 4.3.

Lista e kufizimeve të veprimtarive për secilën zonë:

4.3.3 Veprimtaritë e Lejuara dhe të Kufizuara

| Veprimtaritë | Zona e Mbrojtjes së rreptë | Zona e Menaxhimit aktiv | Zona e zhvillimit të qëndrueshëm | Zona e jashtme, rripi mbrojtës |
|---|----------------------------|-------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
| Veprimtaritë e hulumtimit shkencor | PO | PO | PO | PO |
| Veprimtaritë mjedisore/të natyrës së egër nga personat e autorizuar | PO | PO | PO | PO |
| Vrojtimi i shpendëve dhe kafshëve të tjera të natyrës së egër; në zonën e mbrojtjes së rreptë (strikte) vetëm me roje pylli ose udhërrëfyes të trajnuar dhe të certifikuar | PO | PO | PO | PO |
| Veprimtaritë edukative në zonat e rregulluara posaçërisht për atë qëllim vetëm me roje pylli ose udhërrëfyes të trajnuar dhe të certifikuar | PO | PO | PO | PO |
| Manipulimi i llojeve dhe habitateve nga persona të autorizuar në mënyrë që të përmirësohet statusi i tyre i ruajtjes, me miratimin nga MMJPF | PO | PO | PO | PO |
| Notimi dhe zhytja në zonë | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – lundrimi | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – “kajce” me motorrë elektrikë (kalimi deri në fund të vitit 2026) | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – katamarranët me kapacitet maksimal të pasagjerëve prej 12 personash vetëm me motorrë elektrikë (kalimi deri në fund të vitit 2026), Kufiri i shpejtësisë për t’u përcaktuar | JO | PO | PO | N/A |
| Varkat – varkat turistike për pasagjerët (përfshirë: varkat elektrike për pasagjerët mund të futen në zonën e menaxhimit aktiv me lejen nga subjekti i menaxhimit) | JO | JO | PO | N/A |
| Varkat – varka me motorrë me kufij shpejtësie prej 15 nje | JO | JO | PO | N/A |
| Motorrët e ujit dhe pajisjet e tyre | JO | JO | JO | N/A |
| Heqja e kallamishteve (përveç rasteve të lejeve paraprake nga MMJPH) | JO | JO | JO | JO |
| Shtimi i veprimtarive ndërgjegjësuese | | | PO | PO |
| Peshkimi rekreativ | JO | PO | PO | N/A |
| Peshkimi për qëllime kryesisht ekonomike në pajtim me rregulloret (koncesioni) | JO | PO | PO | N/A |
| Gjuetia | JO | JO | JO | JO |
| Mbledhja e bimëve ose kafshëve (përveç peshkut) | JO | JO | JO | PO |
| Ndezja e zjarreve në terrene të hapura | JO | JO | JO | PO |
| Bujqësia dhe kopshtaria tradicionale | N/A | N/A | N/A | PO |
| Kullotja e bagëtive | N/A | N/A | N/A | PO |
| Ndërtimi duke përdorur beton, gurë, metale ose dru | JO | JO | JO | PO |
| Degradimi ose shkatërrimi i habitateve natyrore | JO | JO | JO | JO |
| Rrjedhja e ujërave të zeza të patrajtuara nga zonat e banuara | JO | JO | JO | JO |
| Introduktimi (futja) i llojeve të bimëve dhe kafshëve jo-autoktone | JO | JO | JO | JO |
| Djegia e bimësisë natyrore | JO | JO | JO | JO |
| Futja e lëndëve të dëmshme që mund të shkaktojnë ndryshime kimike, fizike, biologjike, mikrobiologjike dhe të tjera në ujë ose në natyrën e egër | JO | JO | JO | JO |
| Nxjerrja e rërës ose e zhavorrit | JO | JO | JO | JO |

| Veprimtaritë | Zona e Mbrojtjes së rreptë | Zona e Menaxhimit aktiv | Zona e zhvillimit të qëndrueshëm | Zona e jashtme, rripi mbrojtës |
|--------------------------------|----------------------------|-------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
| Shkarkimi i mbetjeve të ngurta | JO | JO | JO | JO |

4.3.4 Kategorizimi i Zonës me Justifikimin

Në Studimin për Valorizimin shtjellohet një justifikim i hollësishëm për rishpalljen e Liqenit të Ohrit si një zona e mbrojtur në Kategorinë III të IUCN-së – Monument i Natyrës. Aty tregohet se Liqeni i Ohrit përmbush kriteret për t'u njohur si zonë e mbrojtur sepse përmban vlera kulturore, vlera të jashtëzakonshme dhe të kërcënuara natyrore, siguron shërbime të rëndësishme të ekosistemit, dhe njihet në bazë të përcaktimeve të shumta ndërkombëtare.

Pasi janë vlerësuar kriteret e IUCN-it për përcaktimin e kategorisë më të përshtatshme për zonën e mbrojtur, autorët dolën në përfundimin se Liqeni i Ohrit duhet të kategorizohet sipas kategorisë II, III ose VI, duke marrë parasysh shkallën e modifikimit mjedisor.

Vlerësimi i objektivave kryesore të IUCN-it për ruajtjen tregon se Liqeni i Ohrit është një tipar i veçantë natyror, i formuar nga procese gjeologjike glaciale, të cilat kanë nxjerrë në dritë një monument natyror me vlera të larta për vizitorët, gjë që tregon se Kategoria III – Monument i Natyrës është e përshtatshme.

Një vlerësim i hollësishëm në pajtim me objektivat për ruajtjen të IUCN-it si dhe tiparet dalluese për Kategoritë II, III, VI çojnë në përfundimin se **Kategoria III – Monument i Natyrës** është kategoria më e përshtatshme e mbrojtjes, sepse objekti i kësaj kategorie është

- të mbrojtë tiparet e veçanta të jashtëzakonshme natyrore dhe biodiversitetin dhe habitatet përkatëse
- të mbrojtë sitet e veçanta natyrore me vlera shpirtërore dhe/ose kulturore në rastet ku ato kanë edhe vlera të biodiversitetit

dhe sepse

- fokusi i mbrojtjes në rastin e Liqenit të Ohrit është një tipar i dallueshëm natyror me ekologjinë përkatëse
- Liqeni i Ohrit është një tipar gjeologjik natyror.

4.4 Programet e Menaxhimit

Në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Legjislacionin për përmbajtjen e planeve të menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe programeve vjetore për mbrojtjen e natyrës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 26/2012), një plan menaxhimi për zonën e mbrojtur përbëhet nga shtatë programe:

- Programi 1 – Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore
- Programi 2 – Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
- Programi 3 – Menaxhimi i trashëgimisë kulturore
- Programi 4 – Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe rekreacionit
- Programi 5 – Zhvillimi lokal
- Programi 6 - Informimi, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe edukimi
- Programi 7 – Menaxhimi, administrimi dhe financimi

Programet janë të harmonizuara me vizionin dhe qëllimet kryesore të zonës së mbrojtur. Secili program organizohet në nën-programe me veprimtaritë përkatëse.

4.4.1 Programi 1 – Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore

Në vitin 1977 Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Liqeneve të Ohrit, Prespës dhe Dojranit ("Gazeta Zyrtare e RSM" nr. 45/77) duke shpallur Liqenin e Ohrit një zonë të mbrojtur në kategorinë Monument i Natyrës.

Në vitin 1979, rajoni i Ohrit u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Botërore për shkak të vlerave të tij natyrore, në bazë të kriterit (iii), d.m.th tani kriteri (vii) – Përmban dukuri të mahnitshme natyrore ose zona të bukuri së jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësisë estetike.

Liqeni i Ohrit është një ndër qendrat më të rëndësishme të biodiversitetit në Evropë me më shumë se 1,200 lloje. Për shkencën rëndësi të veçantë përbëjnë më shumë se 200 lloje endemike, disa prej të cilave pothuajse të pandryshuara që prej periudhës Terciare, të tilla si sfungjerët endemikë, llojet relikte të kërmijve, korani i Ohrit dhe belushka.

Liqeni i Ohrit njihet në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare si një zonë e rëndësishme e biodiversitetit, kryesisht për shkak të pranisë së llojeve të rëndësishme kombëtare dhe evropiane, dhe liqeni dhe vija e tij bregore janë të përfshira në Rezervatin Natyror të Biosferës Ohër – Prespë të UNESCO-s (2014). Ai gjithashtu është përfshirë në Rrejtin Kombëtar Emerald të Zonave të Ruajtjes së Veçantë (ASCI), të përcaktuara për të ruajtur habitatet natyrore në pajtim me Konventën e Bernës, e cila është ratifikuar nga Maqedonia e Veriut. Hulumimet fillestare tregojnë se Liqeni i Ohrit është një zonë e mundshme e ardhshme e rrjetit Natura 2000.

Liqeni i Ohrit së bashku me Ligatinën Studençishko u përfshi në Listën e Konventës së Ramsarit në maj të vitit 2021 me propozim të MMJPH dhe ka fituar rëndësi ndërkombëtare dhe status të mbrojtjes në bazë të Konventës së Ramsarit. Për shkak të trashëgimisë së jashtëzakonshme natyrore të Liqenit të Ohrit MN, me rëndësi të madhe janë monitorimi dhe mbrojtja e tij.

Programi lidhet drejtpërdrejt me vizionin për ZM, d.m.th sigurimi i mbrojtjes dhe ruajtjes afatgjatë të Liqenit të Ohrit dhe zonat e tij përreth për brezat e ardhshëm si një zonë e vlerave të jashtëzakonshme dhe një zonë e rëndësishme për biodiversitetin me lloje dhe habitate të rëndësishme kryesore të rëndësisë kombëtare dhe evropiane.

Programi lidhet me qëllimin se vlerat e jashtëzakonshme natyrore të Liqenit të Ohit MN valorizohen, mbrohen, ruhen dhe monitorohen. Proceset natyrore dhe funksionet ekologjike të zonës së mbrojtur kryhen të pandërprera, dhe statusi i favorshëm i ruajtjes së habitateve dhe llojeve mirëmbahet duke respektuar legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e natyrës, dhe zonimin dhe regjimin e mbrojtjes së ZM-së. Qëllimi i programit është të sigurojë mbrojtjen integrale të trashëgimisë natyrore të Liqenit të Ohrit përmes zbatimit të nën-programeve (të parashtruara në vijim), për mbrojtjen dhe monitorimin e habitateve dhe llojeve të përzgjedhura prioritare dhe zonës nën-mesdhetare kontinentale të liqenit (rajoni i Ohrit); identifikimin e habitateve dhe llojeve të rëndësishme evropiane për qëllime të përcaktimit të Liqenit të Ohrit MN zona e Natura 2000 në bazë të Direktivave të BE-së për Habitatet dhe Shpendët; promovimin e zgjidhjeve të mbështetura tek natyra; monitorimin e zonave të rëndësishme të biodiversitetit të identifikuar në planin për menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit; identifikimin dhe monitorimin e llojeve të huaja invazive në liqen dhe zonat përgjatë bregut; monitorimin e ujërave të ndotur dhe menaxhimin

e qëndrueshëm të mbetjeve; rintroduktimin (rifutjen) e llojeve kryesore; monitorimin e llojeve dhe habitateve të ndjeshme ndaj klimës dhe zbatimin e masave për përshtatjen e tyre ndaj klimës, si dhe restaurimin e habitateve të rëndësishme.

Rezultatet e këtyre veprimtarive do të kontribuojnë ndaj vazhdimësisë së pandërprerë të proceseve natyrore dhe funksioneve ekologjike brenda zonës së mbrojtur dhe mirëmbajnë statusin e favorshëm të ruajtjes së habitateve dhe llojeve.

Programi është i strukturuar në katër nën-programe:

1. Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore
2. Monitorimi i trashëgimisë natyrore
3. Monitorimi i cilësisë së mjedisit
4. Restaurimi i habitateve të rëndësishme

Për secilin prej këtyre nën-programeve, janë hartuar një sërë masash dhe veprimtarish në Planin Operativ Pesë-Vjeçar për zbatimin e Planit të Menaxhimit për Liqenin e Ohrit MN, për të arritur objektivat kryesore dhe të veçanta të tyre.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Ujërat, Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë, Ligji për Menaxhimin e Trashëgimisë Botrore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit, Ligji për ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore zbatohen në kryerjen e veprimtarive nga ky program.

Veprimtaritë e këtij programi janë në pajtim me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Plan Veprimi (2017-2027), Strategjinë Kombëtare për Biodiversitetin me Plan Veprimi (2018-2023), Planin Shtetëror Territorial (2004), Raportin e Gjashtë të Konventës për Diversitet Biologjik (KDB), Konventën për Trashëgiminë Botërore - UNESCO, Konventat e Bernës, Ramsarit, Bonit (CITES, etj.), si dhe Direktivat e BE-së për Shpendët dhe Habitatet.

Në realizimin e programit për mbrojtjen dhe monitorimin, organi i menaxhimit të Liqenit të Ohrit MN do të bashkëpunojë me Institucionin Publik të PK të Galiçicës dhe entitete të tjera menaxhuese maqedonase për zonat e mbrojtura, Komunitat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës, Komisionit Kombëtar të UNESCO-s, dhe Institutit Hidrobiologjik të Ohrit, i cili vazhdimisht monitoron biodiversitetin e liqenit dhe bregun e tij dhe komunikon me institucionet shtetërore në Shqipëri brenda kontekstit të veprimtarive dhe projekteve të rregullta për ruajtjen e natyrës.

Për shkak të rëndësisë së këtij programi, entiteti i menaxhimit paraqet raportet ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për veprimtaritë e përfunduara dhe të planifikuara në pajtim me planin e menaxhimit dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës.

Entiteti i menaxhimit të zonës së mbrojtur bashkëpunon me institucionet profesionale brenda vendit dhe institucionet ndërkombëtare dhe organizatat për mbrojtjen e natyrës për monitorimin e habitateve dhe llojeve të rëndësishme; identifikimi i llojeve të rëndësishme kombëtare dhe të BE-së; ri-introduktimi (rifutja) e llojeve kryesore; identifikimi dhe monitorimi i llojeve invazive; identifikimi dhe monitorimi i llojeve dhe habitateve të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike.

4.4.2 Programi 2 – Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Programi 2 – Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore do të kontribuojë në përmbushjen e vizionit për Liqenin e Ohrit MN në sigurimin e shërbimeve të ekosistemit ndëkohë që balancohet mbrojtja dhe ruajtja afatgjatë e natyrës me nevojat e njerëzve lokalë.

Kjo do të pasqyrohet në moton për Liqenin e Ohrit MN, për shembull ‘për natyrën dhe njerëzit’. Një ekspert komunikimi duhet të angazhohet për të propozuar një moto të përshtatshme, në bashkërendim me aktorët e tjerë.

Ky program lidhet me qëllimin kryesor që burimet natyrore përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e natyrës, peshkatarinë dhe bujqësinë. Koncepti i shërbimeve të ekosistemit është zhvilluar për Liqenin e Ohrit dhe siguron përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve të ekosistemit, i cili krijon mundësitë për zhvillimin ekonomik lokal.

Programi është i strukturuar në bazë të tre nën-programeve:

1. Mbështetje për praktikën e peshkatarisë së qëndrueshme
2. Inkurajimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore
3. Pagesat për shërbimet e ekosistemit

Objektivat e veçanta janë parashtruar për secilin nga këto nën-programe, duke përfshirë masat dhe veprimtaritë e paraqitura në mënyrë të hollësishme në Planin Operativ Pesë-Vjeçar për zbatimin e Planit të Menaxhimit për Liqenin e Ohrit MN.

Programi pasqyron zbatimin e dispozitave të veçanta të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Ujërat, Ligji për Peshkatarin dhe Akuakulturën, Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural përmes përdorimit optimal të burimeve natyrore në pajtim me parimet e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit.

Veprimtaritë e këtij programi janë të harmonizuara me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Plan Veprimi (2017-2027), Strategjinë Kombëtare për Biodiversitetin me Plan Veprimi (2018-2023) dhe Raportin e Gjashtë të Konventës për Diversitetin Biologjik (KDB).

4.4.3 Programi 3 – Menaxhimi i trashëgimisë natyrore

Në vitin 1979 rajoni i Ohrit u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Botërore për shkak të vlerave të tij natyrore, në bazë të kriterit (iii), tani kriteri (vii): Ai përmban dukuri të mahnitshme natyrore ose zona të bukurive të jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësisë estetike.

Në vitin 1980, në bazë të rekomandimit të IUCN-it (në atë kohë Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës), nomimi u zgjerua duke plotësuar kriteret për vlerat kulturore (i), (iii) dhe (iv) dhe zona u regjistrua nën emrin "Rajoni i Ohrit me aspektet e tij kulturore dhe historike dhe mjedisin e tij natyror."

Kriteri (i) – Të mirat kulturore që janë kryevepër e shpirtit krijues të njeriut: Qyteti i Ohrit është një prej vendbanimeve më të vjetra në Europë. Ka site arkeologjike të ruajtura mirë që e kanë prejardhjen në Epokën e Bronzit deri në Periudhën Mesjetare, arkitektura fetare nga shekujt VII deri në shekullin XIX, si dhe arkitektura autentike urbane nga shekujt XVIII-XIX. Këto objekte dhe gërmadha kanë vlera arkitekturore, kulturore dhe artistike. Përqëndrimi i siteve

arkeologjike dhe strukturave urbane në qendrën e vjetër urbane të Ohrit, përgjatë brigjeve të Liqenit të Ohrit dhe në afërsi të menjëhershme e bën këtë rajon me të vërtetë unik.

Kriteri (iii) – Të ketë një dëshmi unike ose të paktën të jashtëzakonshme për traditën kulturore të një qytetërimi të veçantë ekzistues ose të zhdukur: Ky Sit i Trashëgimisë Botërore është dëshmi e artit bizantin të ekspozuar në më shumë se 2, 500 m² afreske dhe më shumë se 800 ikona. Kishat e Shën Sofies (shekulli i 11-të), Shën Mari Perivleptos (shekulli 13-të) dhe Shën Gjonit Teolog në Kaneo (shekulli i 14-të) përbëjnë një nivel të lartë të arritjeve artistike në afresket dhe përshkrimet e tyre teologjike. Vlerat estetike të arkitekturës fetare, afreskeve dhe ikonave kanë kontribuar në rajon në mënyrë që ai të bëhet një qendër e rëndësishme fetare dhe kulturore përgjatë shekujve.

Kriteri (iv) – Të jetë një shembull i shkëlqyer i ndërtimit, ansambël arkitekturor dhe teknologjik ose peizazh i cili pasqyron epokat e rëndësishme të historisë së njeriut: Qyteti i Ohrit ka manastrin më të vjetër sllav dhe universitetin e parë sllav në Ballkan, i cili kontribuoi në zhvillimin dhe kulturën e botës së Vjetër Sllave.

Thelbi i qytetit të vjetër të Ohrit (emri i vjetër i të cilit është Lychnidon) përfshin një forum, ndërtesa publike, rezidenciale dhe fetare, paraqitja e të cilave është në harmoni me vijën bregore dhe terrenin përreth.

Ati i Hershëm Kristian nga shekulli IV deri në shekullin VI përfaqësohet nga basilika të gjera me dysheme me mozaikë, dhe arti bizantin (shekujt IX-XIV) nga ndërtesa fetare të ruajtura mirë të dekoruara larmishëm nga afreske, ikona dhe mobilje kishtare. Arkitektura e qytetit të vjetër ruan shembujt e variantit lokal për shtëpitë qytetare orientale tipike të shekullit XVIII-XIX që u zhvilluan aty. Hapësira e kufizuar çoi në formimin e rrugëve shumë të ngushta.

Në bazë të propozimit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Kulturës, emri i ri i kësaj të mire u propozua – Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Ohrit, e cila u pranua në seancën e 30-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore (2006, Vilnius, Lituani).

Programi 3 – Menaxhimi i trashëgimisë kulturore lidhet drejtpërdrejt me vizionin për zonën e mbrojtur, d.m.th. mbrojtjen dhe ruajtjen afatgjatë të liqenit, duke marrë parasysh trashëgiminë kulturore për brezat e ardhshëm. Programi lidhet drejtpërdrejt me qëllimin kryesor: 'Mbrojtja, valorizimi dhe promovimi i vlerave kulturore çon në rritjen e interesit të vizitorëve për zonën e mbrojtur'. Qëllimi i programit është të mbrojë, menaxhojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore të Liqenit të Ohrit MN dhe të implementojë objektivat e Ligjit për Menaxhimin me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në rajonin e Ohrit, d.m.t. të krijojë kushtet për mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, dhe transmetimin e vlerave të tij të jashtëzakonshme ndaj brezave të ardhshëm si pjesë e trashëgimisë së përbashkët.

Programi i menaxhimit të trashëgimisë kulturore përmban tre nën-programe:

1. Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
2. Menaxhimin e trashëgimisë kulturore
3. Promovimin e trashëgimisë kulturore

Objektivat e veçanta janë parashtruar për secilin nga këto nën-programe, së bashku me masat dhe veprimtaritë që gjenden në Planin Operativ Pesë-Vjeçar për Zbatimin e Planit të Menaxhimit të Liqenit të Ohrit MN.

Për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të rajonit të Ohrit, dhe për rrjedhojë brenda kufijve të Liqenit të Ohrit si një monument natyror, ky program zbaton dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Ligjit për Muzeun, Ligjit për Menaxhimin e Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore në rajonin e Ohrit, Ligjin për Ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Neni 66 paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës deklaron se monumentet e kulturës brenda zonave të mbrojtura gëzojnë mbrojtjen e përshtatshme për statusin e tyre në pajtim me ligjin.

Programi për trashëgiminë kulturore përmban masat dhe veprimtaritë e duhura nga Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Kulturës në Republikën e Maqedonisë në periudhën 2018-2022.

4.4.4 Programi 4 – Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe rekreacionit

Qëllimi i këtij programi është turizmit i qëndrueshëm për të krijuar një formë të barazpeshës ndërmjet aspekteve mjedisore, ekonomike dhe socio-kulturore. Ideja e këtij lloji të turizmit është të krijojë kushtet për vlerat natyrore dhe kulturore që të transmetohen tek brezat e ardhshëm pa ndikuar negativisht tek të ardhurat, punësimi dhe zhvillimi i komunitetit.

Turizmi është një mundësi e hapur për pjesëmarrjen e aktorëve të përfshirë që kanë interesa të përbashkëta dhe marrëdhënie ndërvepruese. Turizmi në rajonin e Ohrit është një veprimtari e interesit të veçantë. Kjo qasje nënkupton se angazhimi i përgjithshëm integruet në krijimin e zhvillimit turistik dhe organizimin e hapësirave turistike brenda rajonit të Ohrit do të bazohen në zgjidhjet e miratuara territoriale në zonat të cilat lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e turizmit. Një pikë e rëndësishme e fillimit është përfaqësimi i pamjaftueshëm i potencialeve turistike në tregun turistik, por gjithashtu vëzhgimi i parimeve ekologjike.

Ndjekja më e madhe në rajonin e Ohrit është realizuar nga turistët të cilët vijnë nga vende të Gadishullit të Ballkanit. Standardet dhe kriteret e rrepta në BE duhet të mundësojnë zhvillimin e strukturës së ofertës turistike të rajonit, për të ofruar mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit: pranë liqenit, në mal, qytet, manastir, për arsye shëndetësore, eko-turizëm, peshkim, turizëm rural, kalimtar dhe shumë lloje të tjera. Kushtet natyrore mundësojnë veprimtari në tokë, ujë dhe ajër në mënyrë që dimensionin territorial për rekreacionin të jetë mjaft i madh, duke marrë parasysh faktin se rajoni i Ohrit përfshihet në Listën e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore.

Megjithatë, si të gjithë format e tjera të zhvillimit, turizmi mund të ketë ndikime të dëmshme, veçanërisht në të mirat natyrore. Për këtë arsye, ky program ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për shembull ndërmjet udhërrëfyesve turistikë që ndikimet e mundshme duhet të reduktojnë trysnitë ndaj vlerave natyrore dhe kulturore të vizitave turistike.

Programi për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe rekreacionit përmban tre nën-programe:

1. Vlerësimin dhe mbështetjen për zhvillimin e eko-turizmit në Liqenin e Ohrit MN dhe zonat përreth tij

2. Zhvillimin e infrastrukturës së turizmit të qëndrueshëm dhe vendosjes së markës
3. Monitorimin e vizitorëve dhe sistemin e menaxhimit për Liqenin e Ohrit MN dhe zonat përreth tij

Për secilin nga këto nën-programe, janë hartuar një sërë masash dhe veprimtarish në Planin Operativ Pesë-Vjeçar, për të arritur objektivat kryesore dhe të veçanta.

Programi është i harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Biodiversitet me Plan Veprimi, Strategjinë Kombëtare për Natyrën, Strategjinë Kombëtare për Turizmin, Planin Territorial të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

4.4.5 Programi 5 – Zhvillimi lokal

Programi për zhvillimin e Liqenit të Ohrit MN lidhet me vizionin për zonën, d.m.th. vlerat e liqenit njihen nga banorët lokalë dhe vizitorët të cilët mbështesin dhe gëzojnë një gamë të gjerë të veprimtarive të cilat janë në harmoni me mjedisin natyror. Ky program do të mbështesë veprimtari të tilla në pajtim me zonimin e ZM-së.

Gjithashtu, programi do të inkurajojë banorët lokalë të angazhohen ndaj objektivave të ZM-së, të cilat në këmbim duhet të kontribuojnë ndaj zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Organi menaxhues i zonës së mbrojtur duhet gjithashtu të mbështesë në mënyrë aktive ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të qëndrueshme nga ana mjedisore (NVM-të) të cilat kontribuojnë ndaj ruajtjes së zonës.

Pjesëmarrja aktive e komuniteteve lokale në vendimmarrjen dhe menaxhimin në lidhje me zonën e mbrojtur do të inkurajohet përmes një këshilli të aktorëve të përfshirë.

Programi i zhvillimit lokal përmban dy nën-programe:

1. Pjesëmarrja e komuniteteve lokale në menaxhimin e Liqenit të Ohrit MN
2. Rritja e përfitimeve ekonomike për komunitetin lokal

Komunitetet lokale kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në mbrojtjen e mjedisit dhe përfshirja e tyre e drejtpërdrejtë në proces është e rëndësishme për ruajtjen e burimeve natyrore.

4.4.6 Programi 6 - Informimi, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe edukimi.

Programi për informimin, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe edukimin lidhet drejtpërdrejt me vizionin për një Monument të Natyrës, në bazë të të cilit ruhet biodiversiteti dhe vazhdon të jetë një element qendror i zonës së mbrojtur.

Ky program ka për qëllim të mundësojë ndarjen transparente të informacionit, të sigurojë një platformë edukative për arritjen e përvojave pozitive me natyrën, si dhe një bazë proaktive shkencore për sjelljen e përgjegjshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik të mbrojtjes së natyrës dhe vlerave universale të zonës të tilla si UNESCO dhe Ramsar. Informimi i vazhdueshëm i grupeve të synuara, veçanërisht i komunitetit lokal, shkollave, zonave fqinje të mbrojtura, vizitorëve, do të kontribuojë ndaj rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe edukimit të qetë mjedisor, i cili do të ndihmojë në përmbushjen e vizionit të ZM-së.

Tërheqja e vizitorëve ndaj ZM-ve krijon mundësinë për ta që të mësojnë më shumë përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me natyrën, veçanërisht për ndërlidhjen ndërmjet njeriut, d.m.th.

sistemeve sociale dhe sistemeve natyrore. Duke rritur ndërgjegjësimin e natyrës dhe mjedisit në përgjithësi, pritet që sjellja njerëzore të pajtohet me proceset në sistemet natyrore dhe kufizimet që rrjedhin prej saj. Kjo do të rrisë mbështetjen dhe pjesëmarrjen e banorëve dhe publikut të gjerë në zgjidhjen e problemeve të ZM-së.

Programi për Informimin, Rritjen e Ndërgjegjësimin dhe Edukimin përmban tre nën-programe:

1. Krijimin e një sistemi të besueshëm për informacion të besueshëm dhe të saktë për publikun
2. Marrëdhëniet me publikun dhe forcimin e ndërgjegjësimin publik për Liqenin e Ohrit MN
3. Infrastrukturën për informimin dhe edukimin e turistëve dhe banorëve

Programi ka për qëllim të informojë njerëzit për natyrën dhe biodiversitetin dhe të ndryshojë perceptimet e tyre për vlerat e natyrës.

Veprimtari dhe mjete të veçanta do të zhvillohen për të arritur qëllimet e përcaktuara për programin, të cilat përfshijnë përmirësimin e kapacitetit të entitetit menaxhues të ZM-së në lidhje me informimin dhe edukimin.

4.4.7 Programi 7 – Menaxhimi, administrimi dhe financimi

Programi është baza për zbatimin efektiv të vizionit, qëllimeve dhe veprimtarive në të cilat bazohet menaxhimi i ardhshëm i Liqenit të Ohrit MN. Plani i menaxhimit do të zbatohet përmes veprimtarive të ndërmarra nga entiteti i menaxhimit të zonës së mbrojtur.

Një ndërmarrje e re publike (NP) do të krijohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të menaxhuar Liqenin e Ohrit MN. Menaxhimi do të krijohet dhe mirëmbahet në bashkëpunim me institucione të tjera të tilla si Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Inspektorati Shtetëror për Mjedisin. Ngritja e kapaciteteve të stafit do të mundësojë NP të menaxhojë zonën e mbrojtur në mënyrë të efektshme dhe efikase.

Në atë drejtim, do të jetë i nevojshëm një forcim institucional i NP, veçanërisht krijimi i një strukture të re organizative dhe të personelit, rritje të kualifikimeve të stafit, punësimeve të reja, prokurimit të pajisjeve të përshtatshme. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së nevojshme janë të rëndësishme të madhe për arritjen e vizionit dhe qëllimeve të përcaktuara në planin e menaxhimit.

Menaxhimi i Liqenit të Ohrit MN nga NP e sapo krijuar do të kërkojë emërimin e stafit të specializuar në biologji, mjedis, GIS, gjeografi, hidrologji, turizëm dhe disiplina të tjera.

NP e re do të ketë nevoja për kapacitet të mjaftueshëm për të rritur fondet e kërkuara nga donatorët e huaj dhe të gjenerojë të ardhura nga shërbimet e ekosistemit. Ajo do të ketë nevojë për menaxhimin financiar dhe ekspertizën e kontabilitetit për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme ZM-në.

Një plan financimi është zhvilluar për të mbështetur zbatimin e planit të menaxhimit, që i përgjigjet nevojave në lidhje me kostot direkte (pagat, pajisjet, automjetet dhe flota detare dhe mirëmbajtja e vazhdueshme, kostot e qendrës së informacionit, kostot administrative dhe të mjeteve të tjera, uniformave, pajisjeve, etj.)

Kompensimet gjenerojnë të ardhura për zonën e mbrojtur. Këto përfshijnë kompensime për hyrje, kompensime për përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, vizita në objekte të veçanta, taksa turistike për ata që qëndrojnë në zonën e mbrojtur dhe kompensime për kryerjen e veprimtarive të caktuara në ZM. Burime të tjera të të ardhurave përfshijnë donacionet, grantet, etj, sapo koncepti të zhvillohet dhe zbatohet, kompensime për shërbimet e ekosistemit.

Programi për menaxhimin, administrimin dhe financimin përmban katër nën-programe:

1. Forcimin institucional të Liqenit të Ohrit MN
2. Kuadrin ligjor dhe të planifikimit për menaxhimin
3. Menaxhimin efikas dhe të efektshëm të Liqenit të Ohrit MN
4. Financimin

NP do të marrë vendime në pajtim me përfundimet e Bordit të Drejtorëve, të mbështetur nga dy organe këshillimore: Këshilli i Palëve të Përfshira dhe Këshilli Shkencor, me të cilin ai është në komunikim të vazhdueshëm. Mjeti i Gjurmimit të Efektshmërisë së Menaxhimit do të përdoret për të vlerësuar efikasitetin dhe efektshmërinë në qeverisje, komunikimin me palët e përfshira dhe identifikimin e pikave të dobëta dhe kërcënimeve.

4.4.8 Vështrim i Përgjithshëm i Programeve të Menaxhimit dhe Objektivave të Tyre

Programet harmonizohen me vizionin dhe qëllimet kryesore të zonës së mbrojtur. Secili program zhvillohet me veprimtaritë.

4.4.8.1 Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore

| Qëllimi kryesor | Programi | Nën-programi | Qëllimi i veçantë |
|--|---|---|---|
| <p>Vlerat e jashtëzakonshme natyrore të Liqenit të Ohrit Monument i Natyrës vlerësohen, ruhen dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Proceset natyrore dhe funksionet ekologjike të zonës së mbrojtur ndodhin të pandërprera</p> <p>Statusi i favorshëm i ruajtjes së habitateve dhe llojeve mirëmbahet përmes respektimit të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e natyrës, dhe zonimin e ZM-së si dhe regjimin e mbrojtjes</p> | <p>Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore</p> | <p>Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore të Liqenit të Ohrit</p> | <p>Sigurimi i mbrojtjes dhe ruajtjes afatgjatë të vlerave natyrore</p> <p>Mbrojtja dhe ruajtja e bimëve të egra dhe llojeve të kafshëve të rëndësisë kombëtare dhe evropiane</p> <p>Mbrojtja dhe ruajtja e habitateve të rëndësisë kombëtare dhe evropiane</p> <p>Përcaktimi i Liqenit të Ohrit si një sit i Natyra 2000 në pajtim me Direktivat e BE-së së Shpendëve dhe Habiteteve</p> <p>Ri-introduktimi (rifutja) e shpendëve kryesore</p> <p>Identifikimi dhe menaxhimi i llojeve invazive në Liqenin e Ohrit dhe zonat e bregut të tij</p> <p>Mbrojtje dhe ruajtje afatgjatë e zonës nën-mesdhetare kontinentale të liqenit (zona e Ohrit)</p> <p>Promovimi i zgjidhjeve të mbështetura tek natyra</p> <p>Plani i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për ruajtjen e biodiversitetit</p> |
| | | <p>Monitorimi i trashëgimisë natyrore</p> | <p>Monitorimi i kushteve të popullatave të llojeve të zgjedhura kryesore të bimëve dhe kafshëve të rëndësisë kombëtare dhe evropiane</p> |

| Qëllimi kryesor | Programi | Nën-programi | Qëllimi i veçantë |
|-----------------|----------|---|---|
| | | | <p>Monitorimi i habitateve të rëndësishme kombëtare dhe evropiane (brezi i kallamishteve, bimësia ripariante etj.)</p> <p>Monitorimi i zonave të rëndësishme të biodiversitetit të identifikuar në Planin për menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit (2020-2029)</p> <p>Monitorimi i llojeve invazive në Liqenin e Ohrit dhe të zonës së tij bregore</p> <p>Monitorimi i llojeve dhe habitateve të ndjeshme ndaj klimës</p> <p>Funksionaliteti i Zonës Bregore duke përfshirë plazhet</p> |
| | | Monitorimi i peizazhit | Monitorimi i kushteve të zonës liqenore nën-mesdhetare kontinentale (zona e Ohrit) |
| | | Cilësia e Mjedisit | <p>Minimizimi i shkarkimit të ujërave të përdorura të patrajtuara në liqen</p> <p>Parandalimi i ndotjes së liqenit me mbetje vajrash dhe kimikatesh nga mjetet lundruese</p> <p>Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve</p> <p>Monitorimi i cilësisë së mjedisit</p> |
| | | Restaurimi i habitateve dhe ekosistemeve të rëndësishme | <p>Restaurimi i llojeve të rrezikuara të habitateve</p> <p>Përmirësimi i statusit të habitateve të rrezikuara</p> <p>Restaurimi i ekosistemeve të ligatinave</p> <p>Restaurimi i siteve me bimësi makrofite</p> <p>Restaurimi i zonave të rëndësishme për biodiversitetin</p> |

| Qëllimi kryesor | Programi | Nën-programi | Qëllimi i veçantë |
|-----------------|----------|--------------|--|
| | | | Zbatimi i masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për llojet dhe habitatet e ndjeshme |

4.4.8.2 Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Në zbatim të programit, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Peshkatarinë dhe Akuakulturën dhe Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural zbatohen përmes përdorimit optimal të burimeve natyrore në pajtim me parimet e natyrës dhe mjedisit.

Veprimtaritë e këtij programi harmonizohen me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Plan Veprimi (2017-2027), Strategjinë Kombëtare për Biodiversitet me Plan Veprimi (2018-2023) dhe Raportin e Gjashtë Kombëtar ndaj Konventës për Diversitetin Biologjik (KDB).

| Qëllimi kryesor | Programi | Nën-programi | Qëllimi i veçantë |
